

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

FUSHA: SHKENCAT SHOQËRORE

TIRANË, 2010

AUTOR:

QYTETARI
AIDA SERJANAJ
ROLAND GEGPRIFTI
ASTRIT DAUTAJ

HISTORI:

LILJANA GUGE
MAMICA THANATI
INES TODHE
EVIS MESTANI

GJEOGRAFI

MAJLINDA ZIU
AFËRDITA MËHILLI
EVIS MESTANI

EKONOMI:

MERITA SHULA
BASHKIM PEÇI

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR

(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

**LËNDA: QYTETARIA
PËR KLASËN E 10^{-të} - 11^{-të}**

TIRANË, 2010

PËRMBAJTJA

1.Rëndësia e lëndës “Qytetaria” në kurrikulën e re

1.1.Synimet e kurrikulës së re

1.2.Klasifikimi i objektivave

2.Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës

3.Vlerësimi i nxënësit

1. RËNDËSIA E LËNDËS “QYTETARIA” NË KURRIKULËN E RE

1.1 Synimet e kurrikulës së re

Synimet e kurrikulës së re dhe ndryshimet që kanë ndodhur

Lënda e qytetarisë synon:

- t’u japë nxënësve njohuritë dhe t’u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre.
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes së përgjegjshme qytetare të nxënësve dhe të rrisë përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen demokratike të problemeve të komunitetit.
- të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave, parimeve demokratike dhe rregullave e ligjeve të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Lënda e qytetarisë përfshihet në fushën e shkencave shoqërore, së bashku me lëndën e Historisë, të Gjeografisë dhe të Ekonomisë.

Cila është përmbajtja e fushës së shkencave shoqërore?

Fusha e shkencave shoqërore është një studim i integruar i shkencave shoqërore dhe humane dhe përfshin një studim sistematik dhe të integruar të disiplinave të tilla si ekonomia, historia, gjeografia, edukimi qytetar, sociologjia, antropologjia, psikologjia si dhe elementë të shkencave humane. Qëllimi i shkencave shoqërore si fushë është t’i pajisë nxënësit me njohuri, aftësi dhe qëndrime që atyre u nevojiten për të qenë qytetarë aktivë, të informuar, të përgjegjshëm dhe anëtarë të komuniteteve të tyre. Mësimdhënia e shkencave shoqërore duhet të përfshijë lidhjet ndërlëndore midis këtyre fushave. Përveç kësaj, këto standarde përcaktojnë një sërë

aftësish që janë pjesë integrale e këtyre nënfushave.

Standardet e fushës së shkencave shoqërore

Shkencat shoqërore përbëjnë një studim të integruar që synon të nxisë dhe të zhvillojë aftësitë qytetare. Ato sigurojnë një studim të **bashkërenduar, sistematik** të lëndëve të tilla, si **qytetaria, historia, gjeografia, ekonomia, shkencat politike, filozofia** etj., duke integruar dhe përmbajtjen e duhur nga shkencat humane, natyrore dhe matematika.

Qëllimi kryesor i shkencave shoqërore është të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë e tyre për të marrë vendime të arsyeshme dhe të mirinformuara për të mirën e përbashkët, si qytetarë të një shoqërie shumëkulturëshe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

1. Shkencat shoqërore kanë si qëllim kryesor të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike.

2. Shkencat shoqërore integrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime ndërmjet lëndëve të ndryshme. Shkalla dhe format e integrimit ndryshojnë në varësi të niveleve moshore, të tematikave ose të çështjeve të ndryshme.

3. Shkencat shoqërore ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë njohuri dhe qëndrime përmes lëndëve të ndryshme, të cilat ofrojnë mënyra dhe këndvështrime të ndryshme të trajtimit të realitetit.

4. Shkencat shoqërore reflektojnë ndryshimet e njohurive, duke lëvruar metoda të reja integruese për të zgjidhur çështjet themelore të shoqërisë njerëzore.

Standardet e fushës së shkencave shoqërore të hartuara në këtë kontekst, përshkruajnë fushat ose linjat kryesore dhe arritjet e pritshme të nxënësve në këto fusha. Ato shërbejnë, ndër të tjera, si udhëzues për:

- Zhvillimin e përmbajtjes së disiplinave lëndore.
- Përcaktimin e arritjeve të të gjithë nxënësve në fushën e njohurive, aftësive, qëndrimeve në fund të një cikli shkollimi.
- Për vlerësimin e arritjeve të nxënësve etj.

Ato shërbejnë si kritere për të marrë vendime në fushën e kurrikulës së lëndëve shoqërore dhe për të përzgjedhur jo vetëm çështje të ndryshme për t'u trajtuar në klasë, por edhe për të përzgjedhur mënyrën më të mirë të trajtimit të tyre.

Organizimi i standardeve

Standardet e shkencave shoqërore në këtë dokument janë organizuar në dhjetë linja, të cilat përmbajnë edhe arritjet e pritura nga nxënësit në secilën prej tyre në fund të klasës së 12.

Linjat janë ndërlëndore dhe si të tilla ato lidhen dhe priten natyrshëm me njëra-tjetrën.

Linjat kryesore të standardeve të shkencave shoqërore janë:

- Standardi 1. Kultura
- Standardi 2. Koha, vazhdimësia, ndryshimi
- Standardi 3. Njerëz, vende dhe mjedise
- Standardi 4. Zhvillimi individual dhe identiteti
- Standardi 5. Individë, grupe, institucione
- Standardi 6. Pushteti dhe autoriteti
- Standardi 7. Prodhimi, shpërndarja, konsumi
- Standardi 8. Shkenca, teknologjia, shoqëria
- Standardi 9. Lidhjet globale
- Standardi 10. Ideale dhe praktika të qytetarisë

Standardet e lëndës Qytetaria në kuadrin e standardeve të lëndëve shoqërore

Bashkëjetesa e përgjegjshme dhe aktive qytetare kërkon njerëz me njohuri dhe aftësi intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre.

Ajo kërkon aftësi të pjesëmarrjes së përgjegjshme qytetare të çdo individi dhe rritjen e përfshirjes së tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen demokratike të problemeve të komunitetit.

Ruajtja, zhvillimi dhe konsolidimi i demokracisë kërkon zhvillimin e përkushtimit qytetar në respektimin e vlerave, të parimeve demokratike dhe rregullave e ligjeve të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

A	Emri i linjës	Zhvillimi i përgjegjësiave dhe aftësive personale dhe shoqërore
8.1. 12.A	Standardi i linjës	Nxënës/i-ja zhvillon besimin te vetja dhe përgjegjësinë dhe aftësitë e tij/saj personale dhe shoqërore jo vetëm për zhvillimin e tij/saj tërësor intelektual, shpirtëror, emocional, shoqëror etj., por edhe për të vepruar me siguri e vetëbesim për të mirën e tij dhe të shoqërisë.
	Objektivat e linjës	Nxënës/i-ja: • të shprehë dhe të shpjegojë me shkrim dhe me gojë idetë dhe pikëpamjet e veta për çështje që ndikojnë në jetën e tij/saj dhe të shoqërisë; • të pranojë vlerën e tij/saj si individ, duke dalluar aspektet pozitive për veten dhe arritjet vetjake, duke kërkuar gabimet dhe duke plotësuar dhe korrigjuar objektivat personale; • të mbledhë informacion, të kërkojë ndihmë, të bëjë zgjedhje të përgjegjshme dhe ndërmerr veprime konkrete për arritjen e objektivave personale e shoqërore; • të shpjegojë ndryshimin e emocioneve të njeriut në kohë dhe në hapësirë dhe mënyrën e trajtimit pozitiv të ndjenjave në raport me veten, me familjen dhe me të tjerët; • të përshkruajë llojet e ndryshme të punëve që kryhen aktualisht në shoqëri dhe tregon mënyrën e zhvillimit të aftësive vetjake për zhvillimin e karrierës së tij/saj të mundshme në të ardhmen.
B	Emri i linjës	Qytetaria aktive
8.1. 12.B	Standardi i linjës	Qytetari i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për fatet e bashkësisë ku jeton dhe më gjerë, është i pajisur jo vetëm me njohuritë dhe konceptet e domosdoshme për të ndikuar në mirëqenien e vetes dhe të bashkësisë, por edhe me aftësitë intelektuale dhe pjesëmarrëse që e rrisin cilësinë e rolit të tij në bashkësi.

	Objektivat e linjës	Nxënës/i-ja: • të bëjë kërkime të pavarura, të diskutojë dhe të debatojë për çështje, probleme dhe ngjarje të rëndësishme për vete dhe shoqërinë; • të shpjegojë rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të ligjit dhe të rregullave në fusha të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore dhe mënyrën e pjesëmarrjes në procesin e bërjes dhe të ndryshimit të ligjeve; • të shpjegojë pasojat e sjelljeve të dhunshme e diskriminuese të individëve dhe shoqëria; • të përshkruajë dhe të shpjegojë llojet e ndryshme të përgjegjësisë, të të drejtave dhe detyrimeve të individit në shtëpi, shkollë, shoqëri dhe si këto shpeshherë hyjnë në konflikt me njëra-tjetrën; • të reflektojë për vlerat shoqërore, morale, shpirtërore dhe kulturore vetjake dhe të të tjerëve; • të zgjidhë konfliktet duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendim dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra; • të shpjegojë thelbin dhe natyrën e demokracisë dhe institucionet që e mbështesin atë në nivel vendor dhe qendror; • të përshkruajë rolin e grupeve të ndryshme vullnetare dhe atyre të presionit në mbarëvajtjen e demokracisë; • të vlerësojë grupet dhe identitetet e ndryshme etnike, kulturore, fetare etj., në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë; • të shpjegojë mbledhjet dhe mënyrat e ndryshme të shpërndarjes së burimeve dhe ndikimin që zgjedhjet ekonomike kanë te individët, bashkësitë dhe te zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit; • të zbulojë dhe të shqyrtojë mënyrën sesi media e përpunon dhe e paraqet informacionin.
C	Emri i linjës	Sjellja e shëndetshme dhe e sigurt shoqërore
8.1.12.C	Standardi i linjës	

	Objektivat e linjës	Nxënës/i-ja: • të përshkruajë, duke u mbështetur në të dhënat e shkencave të tjera, sjelljet e shëndetshme në fushat kryesore të jetës dhe të veprimtarisë njerëzore dhe përfitimet e gjithanshme për veten dhe shoqërinë, për të bërë zgjedhjet e duhura shoqërore, morale e ligjore; • të përshkruajë ndryshimet kryesore psikologjike, intelektuale dhe shoqërore që shoqërojnë fëmijërinë; • të përshkruajë disa prej substancave të paligjshme që përdoren sot nga njerëzit dhe pasojat e tyre negative për individin dhe shoqërinë; • të dallojë dhe të përshkruajë rreziqet e ndryshme që ndeshen në mjedise e në fusha të caktuara të veprimtarisë njerëzore (si shtëpia, rruga, shkolla, vendi i punës etj.), merr vendime të drejta për t'i parandaluar ose për t'i shmangur ato; • të dallojë trysninë e mjediseve të ndryshme për të vepruar në mënyrë të rrezikshme ose të paligjshme dhe kërkon ndihmë për t'i rezistuar kësaj trysnie; • të marrë pjesë në hartimin e rregullave të ndryshme në shkollë, bashkësi ose në vende të tjera për të rritur sigurinë dhe shëndetin.
D	Emri i linjës	Ne dhe të tjerët e ndryshëm
8.1.12.D	Stan dardi i linjës	Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, në misionin e qytetarisë është edhe edukimi dhe konsolidimi i përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuara si universale në shoqëri, si: • bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale për vete dhe për të tjerët; • përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore; • respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; • pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme; • përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjykimeve dhe çdo forme të diskriminimit; • përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

	Objektivat e linjës	Nxënës/i,-ja: • të shpjegojë ndikimin e veprimeve të tij/saj tek të tjerët; • të vlerësojë qëndrimet e tij/saj stereotip ndaj të tjerëve; • të shprehë gjykimin e tij për gjendjen e drejtësisë ose të barazisë në shkollë, në bashkësi e më gjerë; • të shpjegojë që ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet njerëzve lidhen me faktorë kulturorë, etnikë, gjinorë, racorë, fetarë dhe aftësish; • të shqyrtojë jetën e njerëzve, grupeve dhe të popujve që jetojnë në vende të ndryshme dhe me vlera e zakone të ndryshme; • të përshkruajë dhe të shpjegojë larminë e madhe të marrëdhënieve njerëzore, si: marrëdhëniet shoqërore, familjare etj; • të shpjegojë thelbin dhe pasojat e sjelljeve diskriminuese për individët dhe grupet dhe të shprehë qëndrimin e tij për këto sjellje.
--	---------------------	---

Qytetaria

Lënda Qytetaria bazohet te standardet e mësipërme dhe përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit e këtyre koncepteve dhe vlerave, i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektive

Disa nga konceptet bazë të qytetarisë janë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, demokracia (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) dhe parimet demokratike (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria etj.); qytetaria (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrja aktive etj.), zhvillimi (zhvillimi dhe ndryshimi i qëndrueshëm etj.).

Qytetari i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për fatet e bashkësisë ku jeton dhe më gjerë, është i pajisur jo vetëm me njohuritë dhe konceptet e domosdoshme për të ndikuar në mirëqenien e vetes dhe të bashkësisë, por edhe me aftësitë intelektuale dhe pjesëmarrëse që e rrisin cilësinë e rolit të tij në bashkësi.

Struktura e re: integrimi, lidhja me jetën reale

Konceptet dhe përmbajtja e lëndës “Qytetaria” për klasën 10-të

Duke pasur si bosht themelor konceptet e përgjithshme të qytetarisë demokratike, përmbajtja e lëndës së qytetarisë është e organizuar në disa blloqe tematike që i japin përgjigje pyetjes se çfarë duhet të dijë nxënësi në lëndën e qytetarisë në fund të klasës së 10-të ose 11-të.

Kjo përmbajtje dhe njohuri do të mundësojnë edhe realizimin e aftësive bazë intelektuale dhe pjesëmarrëse që në programin e lëndës shprehen përmes objektivave të linjave. Në këtë mënyrë merr përgjigje edhe pyetja se çfarë duhet të jetë i aftë të bëjë nxënësi në fund të klasës së 10-të dhe 11-të.

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë është e organizuar në linjat ose tematikat e mëposhtme:

Ligji dhe ne

Sot, në çdo hap të jetës së përditshme ne ndeshemi me ligjin. Ligji është rregullatori i tërë veprimtarisë njerëzore në të gjitha fushat. Ne duhet të jemi përgjegjës për zbatimin e ligjit. Në të njëjtën kohë, ne duhet të jemi përgjegjës edhe për cilësinë e ligjeve që rregullojnë jetën tonë.

Kushtetuta e Shqipërisë dhe të drejtat e njeriut

Kushtetuta e Shqipërisë është ligji themeltar i shtetit.

Aty i kanë fillesat të gjitha ligjet e veçanta që rregullojnë veprimtarinë njerëzore.

Familja

Familja është qeliza bazë e shoqërisë që ofron dashuri, mbrojtje, edukim. Ajo është shkolla e parë e të nxënësit për jetën, për të bashkëjetuar me të tjerët.

Si e tillë ajo duhet të mbrohet për të kryer si duhet detyrat ndaj fëmijëve dhe shoqërisë.

Shkolla

Shkolla luan një rol të pazëvendësueshëm për rritjen dhe edukimin e fëmijës nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore. Ajo i përgatit fëmijët, jo vetëm për të hyrë me këmbë të sigurt në botën e të rriturve, por edhe që t'i aftësuar të vetëzhvillohen e t'i përshtaten më mirë ndryshimeve të botës.

Fëmijëria

Fëmijë quhen personat deri në moshën 18 vjeç. Ata kanë të drejta dhe detyra. Ata duhet të kenë mundësi të rriten në një mjedis të qetë e të sigurt, duhet të mbrohen nga shfrytëzimi dhe nga dhuna. Në të njëjtën kohë ata duhet të mësojnë të jenë të përgjegjshëm jo vetëm për vete por edhe për të tjerët dhe për bashkësinë ku jetojnë

Rritja e fëmijës, ndryshimet

Kjo moshë është një etapë e rëndësishme në formimin botës emocionale dhe intelektuale të fëmijës. Në të njëjtën kohë, është një moshë që karakterizohet nga pasiguria dhe paqartësia. Për këtë arsye, është një moshë që kërkon mbështetje të madhe dhe të vazhdueshme nga të rriturit.

Puna

Puna është një e drejtë e sanksionuar në kushtetutë dhe e rregulluar me ligje të ndryshme. Ajo ndryshon në varësi të ndryshimeve ekonomike dhe shoqërore dhe është një ndër faktorët kryesorë të realizimit të çdo individi.

Si e tillë ajo duhet të jetë një mundësi për të gjithë dhe asnjëherë nuk duhet të jetë një faktor që krijon dhe mbështet diskriminime për arsye të ndryshme.

Mjedisi

Mjedisi është burimi kryesor i jetës në Tokë dhe për këtë arsye duhet ruajtur dhe përdorur me kujdes. Mjedisi sot përdoret në mënyrë të pabarabartë në vende të ndryshme të botës dhe kërcënohet nga faktorë të shumtë. Mbrojtja e tij është një domosdoshmëri jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe për brezat e ardhshëm.

Shëndeti

Shëndeti përbën një të drejtë dhe një vlerë që duhet mbrojtur me kujdes. Ai sot rrezikohet nga armiq të shumtë, të cilët mund të shmangen me informacion dhe masa parandaluese. Në të njëjtën kohë, ai është fushë e kërkimeve të shumta, që shoqërohen edhe me shumë pikëpyetje për njerëzimin.

Ushqimi

Ushqimi siguron energjinë bazë për funksionimin e organizmit njerëzor. Për të kryer si duhet detyrën për të cilën përdoret, ushqimi duhet të jetë cilësor dhe i kontrolluar. Çdo individ duhet të jetë i informuar për ushqimet që duhet të përdorë, që përdor dhe për ushqimet që janë të dëmshme për organizmin e tij.

Konsumatori

Përshkrimi i linjës: Çdo individ është një konsumator. Si i tillë ai është edhe objekt i abuzimeve të ndryshme, të cilat mund të shmangen nëse merret informacioni i duhur jo vetëm për produktet që konsumohen, por edhe për të drejtat dhe detyrimet që ai ka si konsumator ndaj shoqërisë.

Siguria rrugore

Të gjithë jemi përdorues të rrugës. Në disa raste jemi shkelës të rregullave të qarkullimit dhe në disa raste të tjera viktimë të shkeljeve të tjerëve.

Njohja dhe zbatimi i rregullave do të shmangte shumë pasoja të rrezikshme për jetën tonë dhe të tjerëve.

Informimi

Informacioni është thelbësor për çdo shoqëri demokratike. Ai është e drejtë dhe detyrim. Ai është pushtet dhe për këtë arsye, shpesh herë përdoret në mënyrë të padrejtë, në dëm të interesave të individëve, grupeve ose shoqërisë. Si i tillë ai duhet të jetë vazhdimisht në qendër të shikimit kritik.

Zhvillimi i aftësive

Aftësitë kryesore

Në misionin historik të lëndës së qytetarisë bën pjesë zhvillimi i aftësive të tilla, si:

- aftësia e të menduarit kritik,
- aftësia e të qenit krijues dhe i efektshëm,
- aftësia për të zgjidhur problemet,
- aftësia për të zbatuar njohuritë,
- aftësia për arsyetime dhe reflektime morale.

Në misionin e kësaj lënde bën pjesë edhe zhvillimi i aftësive që lidhen me sjelljen shoqërore, si:

- aftësia pjesëmarrëse,
- aftësia komunikuese,
- aftësia për të bashkëpunuar,
- aftësia për të debatuar, për të negociuar dhe për të bërë kompromise,
- aftësia ndërkulturore,
- aftësia për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet,
- aftësia për të shpallur të drejtat vetjake pa shkelur të drejtat e të tjerëve,
- aftësia për të marrë përsipër përgjegjësi demokratike etj.

Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, në misionin e qytetarisë është edhe edukimi dhe konsolidimi i përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuara si universale në shoqëri, si:

- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjykitimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

Lidhja e qytetarisë me lëndët e tjera

Kërkesat ndaj lëndëve të tjera

Qytetaria	Matematika
Familja, shkolla, adoleshenca, puna.	Nxënës/i-ja: - të llogaritë përqindjen në situata specifike, si: ndryshimet demografike, braktisja shkollore, shfrytëzimi i fëmijëve në botë. - të lexojë të dhënat nga statistikat.
Qytetaria	Fizika

Mjedisi	Nxënës/i-ja: - të përshkruajë energjinë, burimet e energjisë dhe mënyrat e shfrytëzimit të tyre.
Qytetaria	Biologjia
Shëndeti	Nxënës/i-ja: - të përshkruajë rrugët dhe mënyrat e mbrojtjes së shëndetit, si: metodat kontraceptive, higjiena, drogat. - të përshkruajë faktorët dhe pasojat e një ushqimi të shëndetshëm, dietat dhe sëmundjet që rrjedhin nga kequshqyerjet.
Qytetaria	Kimia
Mjedisi	Nxënës/i-ja: - të përshkruajë mbetjet energjetike dhe mënyrat e pastrimit të ndotjeve prej tyre.
Qytetaria	Psikologjia
Shëndeti, ushqimi	Nxënës/i-ja: - të përshkruajë llojet dhe shkaqet e disa sëmundjeve mendore, karakteristike të moshës dhe jetës së përditshme. - të përshkruajë anoreksinë dhe buliminë, si dhe faktorët që ndikojnë në to.

1.2 Klasifikimi i objektivave

Objektivat e kurrikulës bërthamë që ndodhen në programin e lëndës qytetaria mund të klasifikohen sipas niveleve të mëposhtëm:

- 1 Niveli bazë
- 2 Niveli i mesëm
- 3 Niveli avancuar

Ky klasifikim e ndihmon mësuesit të përcaktojë objektivat specifike të një ore mësimore dhe të përcaktojë shkallën e realizimit të tyre nga nxënës të ndryshëm.

Mbajtja parasysht e këtyre klasifikimeve, do të mundësojnë

njehsimin në nivel kombëtar edhe të kriterëve të vlerësimit të nxënësit.

Objektiva specifike të arritjes

Niveli	Shembuj të objektiva specifike sipas niveleve
Niveli bazë: 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar	Të identifikosh do të thotë: ▪ të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (për shembull mjedisi ose jo të prekshme (për shembull koncepte të tilla si drejtësia, barazia, përgjegjësia qytetare etj). ▪ të dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj. Të përshkruash do të thotë: ▪ të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime ligje etj.
Niveli i mesëm: 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar	Të shpjegosh do të thotë: ▪ të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, për shembull, shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara. Të analizosh do të thotë: ▪ të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

Niveli i avancuar: 3. Aftësia për të vlerësuar, marrë dhe mbrojtur qëndrime të caktuara	Të vlerësosh do të thotë: ▪ të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar për shembull për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj. Të marrësh një qëndrim të caktuar do të thotë: ▪ të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri. Të mbrosh një qëndrim të caktuar do të thotë: ▪ të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.
--	--

2.METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Listohet metoda, strategji, modelohet shembuj të përdorimit të tyre. Kjo shoqërohet me një listë të mjeteve mësimore më të domosdoshme për zhvillimin e lëndës.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që t’i realizojnë ato. Realizimi i objektivave në kapituj ose në tema dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Për shembull, nëse programi i lëndës “Qytetaria” kërkon që nxënësi/ ja të jetë i/e aftë “Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e ushqimit e të bëjë interpretimin e tyre”, kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia të realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e këtij objektivi nxënësit duhet t’i jepet detyra, koha dhe mundësi të tjera që të mbledhë

fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre.

Nëse një mësues/ese nuk e bën këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objektivi nga nxënës/i,-ja si më poshtë:

1. Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual).
2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar intelektual).
3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).

Për shembull, programi kërkon që nxënës/i-jë të jetë i/e aftë:

Të shprehë qëndrimin e tij për kundërshtitë që ekzistojnë lidhur me përdorimin e drogës, alkoolit, duhanit dhe për karakterin e tyre të ligjshëm ose jo.

Ky objektiv mund të arrihet në disa nivele:

- I. Nxënës/i-jë dallon kundërshtitë në pikëpamje.
 - II. Nxënës/i-jë shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
 - III. Nxënës/i-jë krijon qëndrimin e tij/saj për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve të ndryshme nga të vetat.
- Së pari, mësues/i-jë duhet t'i krijojë çdo nxënës/i-eje mundësinë të shprehë arritjet e tij/saj në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësues/i-jë nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënës/i-eje që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij/asaj, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.
 - Së dyti, mësues/i-jë duhet të vlerësojë nxënësi/in-en për nivelin e shprehur të arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij/asaj të gjitha mundësitë të shprehë aftësitë e veta.

Orët mësimore

Programi i qytetarisë për klasën e 10-të dhe 11-të të gjimnazit është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia dhe nxënia duhet të zhvillohen në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi/ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur ve re se nxënësit e tij, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij/saj konkretizojnë një përvetësim të kënaqshëm të objektivave.

Në programin e lëndës së qytetarisë afërsisht **60-65%** e orëve mësimore gjithsej janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **40-35%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore)
- Testimin e njohurive bazë.
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës.
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo orë mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë).
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si aftësia e komunikimit, aftësia e manaxhimit të informacionit, aftësia e zgjidhjeve problemore, aftësia e të menduarit kritik dhe krijues.
- Aftësive që lidhen me veçoritë e lëndës.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohej mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

3.VLERËSIMI I NXËNËSIT

Kjo pjesë kërkon:

- Të përshkruajmë rëndësinë e përdorimit të një sërë mënyrash e formash vlerësimi dhe të jepen shembuj si të përdoren këto në lëndën tuaj.
- Tregoni se si lidhet vlerësimi me objektivat e arritjes të identifikuar në tabelën e mësipërme.

Vlerësimi i nxënës/it-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i-ja vlerësohet me notë ndërsa konkretizon arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produkteve të tjera.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi/ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi/ja vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e shkurtër për një objektiv të veçantë të të nxënësit, deri tek ato një orësh; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Një mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi është **portofoli i nxënësit-es**, që është një përmbledhje e punimeve të tij/saj përgjatë një periudhe të caktuar kohe ose gjatë gjithë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet

për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Në vlerësim, mësuesi duhet të marrë parasysh çrregullime të vërejtura si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtazi nga emigracioni etj. Ai duhet t'u krijojë mundësi këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar ato me shkrim ose me gojë.

Të veçanta

Standardet e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: **njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare.** Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetje të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuarra gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës. Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë ata **të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.**

Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë në jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët,

duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke manaxhuar konfliktet.

Një rol të rëndësishëm në lëndën e qytetarisë ka edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, i aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe matjen e shkallës, në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë prirjet qytetare që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare **të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale.** Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u vlerësohet, për shembull, aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi etj. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore, në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë. Për këtë arsye, një mundësi e mirë për të vlerësuar aftësitë intelektuale, në procesin e zbatimit të njohurive dhe të pjesëmarrjes qytetare, janë projektet qytetare, që përfundojnë me një produkt të caktuar, për shembull, me një portofol individual, grupi ose klase.

Vlerësimi bazohet në kërkesat e programit dhe **synon të nxjerrë në pah qartë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në lidhje me një mësim, më një njësi mësimore ose në lidhje me programin e lëndës.**

Kjo do të thotë se:

1. Nxënësi testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës
2. Nxënësi testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë zhvillimit të lëndës në shkollë të tilla, si:
4. **Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët intelektual).**
5. **Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar intelektual)**
6. **Aftësia për të vlerësuar, për të mbrojtur dhe për të krijuar qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual)**

4. DISA STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES SË QYTETARISË

Hyrje

Numri i metodave dhe teknikave që mund të përdoren për zhvillimin e lëndës së qytetarisë janë të shumta. Më poshtë po ju kujtojmë shkurtimisht disa prej metodave, strategjive dhe teknikave që përdoren më shpesh në fushën e këtij edukimi. Ajo që ka rëndësi për një mësues është që kur zgjedh ose përdor metodën, strategjinë ose teknikën ai duhet të ketë parasysh përcaktimin e tyre, qëllimin, rëndësinë dhe procedurat e tyre përkatëse.

Strategjitë dhe teknikat e mëposhtme nuk janë të reja. Ato gjenden pothuajse në të gjitha manualët e trajnimit që kanë në bazë metodat ndërvepruese të mësimdhënies. Mësuesi është i lirë të zgjedhë metodat që mendon se përshtaten më mirë me mjedisin arsimor në të cilin do të zhvillojë veprimtaritë që lidhen me aspekte të ndryshme të qytetarisë, kryesisht, me aspektin ligjor të saj.

Kjo ka vlerë edhe për veprimtaritë të cilat në këtë manual janë thjesht modele mësimi për të nxitur imagjinatën dhe përvojën e pasur të mësuesit. Si të tilla ato nuk trajtojnë të gjitha temat e mundshme në këtë fushë. Çdo mësues, mund të zgjedhë të zhvillojë ato tema që mendon se i shërbejnë realizimit të objektivave që i ka vënë vetes në një orë mësimi, duke qenë të sigurt se ai do t'i pasurojë ato me shumë tema dhe veprimtari të tjera që mund të shërbejnë si modele për të tjerët. Si i tillë ky udhëzues shërben thjesht për të nxitur krijimtarinë në fushën e mësimdhënies.

BRAINSTORMING(IDE)

Qëllimi

Metodë ndërvepruese mjaft e njohur dhe e përdorur gjerësisht në

mjediset arsimore pasi i nxit pjesëmarrësit të përdorin imagjinatën dhe të jenë krijues në gjetjen e zgjidhjeve të duhura për një problem.

Cilat janë disa nga rregullat që duhen mbajtur parasysh kur zhvillojmë një metode të tillë?

- Gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk lejohet të bëhet vlerësimi i ideve të shprehura, pasi, nëse nxënësit gjykojnë dhe vlerësojnë idetë e shprehura vëmendja do të përqendrohej më shumë në mbrojtjen e ideve se sa në dhënien e ideve të reja që janë objektit i kësaj faze të veprimtarisë.
- Të gjithë nxënësit duhet të nxiten të japin sa më shumë ide, madje duhen nxitur edhe ide “të guximshme”. Kjo ka vlerë, pasi prirja e nxënësve është të censurojnë idetë e tyre duke pasur frikë nga mendimi se mund të japin ide që tingëllojnë të paarsyeshme.
- Kjo metodë kërkon dhënien e sa më shumë ideve, pasi në fund të fundit sasia do të çojë edhe në arritjen e cilësisë. Madje shpejtësia me të cilën jepen idetë shmang edhe vlerësimin e tyre dhe për rrjedhojë rrit edhe numrin e ideve të shprehura.
- Secili është i lirë të ndryshojë idetë e tij të shprehura më parë ose ato të të tjerëve. Kombinimi ose ndryshimi i ideve, çon në ide të reja, ndoshta më “cilësore” se të parat.

Procedura

- Nxënësit ulen lirisht sipas dëshirës;
- Është e domosdoshme që në klasë të ketë një tabelë ose një tabak të madh letre për të shkruar idetë e shprehura;
- Bëhet i njohur problemi ose çështja që do të trajtohet;
- Bëhen të njohura rregullat:
 - Nuk lejohet vlerësimi
 - Nxiten idetë personale të nxënësve
 - Sa më shumë ide aq më mirë është
 - Mbështetja tek idetë e të tjerëve ose kombinimi i ideve të shprehura më parë
- Idetë regjistrohen në tabelë ose në tabakun e letrës sa më shpejt që të jetë e mundur;

- Mësuesi mund të shtojë idetë e tij si çdo pjesëmarrës tjetër;
- Të mos lejohen talljet, komentet etj;
- Në fund diskutohen dhe vlerësohen idetë e shprehura.

NJËRI MËSON TJETRIN

Qëllimi

Kjo strategji përdoret për të rritur interesimin e nxënësve gjatë paraqitjes së një mësimi ose kapitulli të ri ose gjatë fazës së përfundimit të saj.

Ajo ndihmon dhe aftëson nxënësit të ndajnë informacionin lëndor me njëri-tjetrin.

Procedura

1. Mësuesi përgatit më paraprakisht kartat ose fletët në të cilët përmbahen fakte rreth mësimi (një fakt një kartë) të cilat i shpërndahen nxënësve (një nxënës-një kartë);
2. Çdo nxënës duhet të lexojë për disa minuta informacionin që ndodhet në kartën e tij ndërkohë që mësuesi përpiket të ndihmojë nxënësit që kanë nevojë për të kuptuar më mirë informacionin e tyre;
3. Mësuesi u kërkon nxënësve të lëvizin nëpër klasë dhe t'u transmetojnë informacionin që ndodhet në kartën e tyre, nxënësve të tjerë. Kjo duhet të vazhdojë deri sa të gjithë nxënësit të jenë informuar për informacionin që ndodhet në të gjitha kartat;
4. Gjatë këtij procesi të shkëmbimit të informacionin, nxënësit duhet të flasin me nxënësin e dytë vetëm pasi të kenë mbaruar shkëmbimin e informacionit me të parin. Pra, ata nuk lejohen të flasin njëkohësisht me disa nxënës;
5. Pasi nxënësit të kenë mbaruar veprimtarinë, mësuesi i pyet ata për atë që mësuan nga shkëmbimi i informacionit ndërmjet tyre.

TË PYETURIT

Qëllimi

Rëndësia e kësaj teknike për suksesin e mësimit është e madhe. Pyetjet duhet të jenë të tilla që të kërkojnë vënien në punë të arsyes dhe të niveleve të larta të menduarit si dhe të nxisin dialogun ndërmjet nxënësve (në vend vetëm të dialogut të vjetër mësues-nxënës). Nxënësit duhet të nxiten të shqyrtojnë alternativa të ndryshme zgjidhjeje për problemet e tyre mësimore, reale ose imagjinare qofshin ato.

Megjithëse disa nga pyetjet mund t'i shërbejnë vjeljes së informacionit për njohuritë e nxënësve, qëllimi kryesor i tyre duhet të jetë aftësimi i nxënësve për të zgjidhur probleme. Në këtë mënyrë sistemi i pyetjeve që duhet të zhvillohen në klasë duhet të përfshijë nxënësit në proceset e analizës dhe të sintezës së koncepteve kryesore dhe më pas t'i udhëheqë ata në zbatimin e njohurive në praktikë.

Procedura

- Nxënësve nuk u kërkohet që vetëm të riprodhojnë informacionin, por ftohen ta përdorin atë, duke ju ofruar situata problemore imagjinare ose reale për zgjidhje.
- Nxënësve u kërkohet të formulojnë gjykime rreth ligjeve ose politikave publike. Gjithnjë të kërkohen argumente.
- Në raste konfliktesh, nga nxënësit kërkohet të ofrojnë alternativa zgjidhjeje duke dhënë argumentet për zgjidhjet më të mira.
- Në përgjithësi, bëhen pyetje për t'u siguruar që nxënësit e kuptojnë materialin mësimor që ata studiojnë, por në më të shumtën e raste atyre u kërkohet të analizojnë, të vlerësojnë dhe të zbatojnë njohuritë e marra.

LOJA ME ROLE DHE SIMULIMI

Gjatë lojës me role nxënësit ndjejnë, mendojnë ose veprojnë si çdo individ tjetër gjatë në varësi të problemit ose të situatës

Gjatë simulimit nxënësit reagojnë ndaj një problemi ose situatë brenda një mjedisi të strukturuar, për shembull gjatë një gjyqi të imituar

ose seance dëgjimore legislative. Në këtë mënyrë simulimi synon më tepër të imitojë një proces ose procedurë të caktuar.

Qëllimi

Megjithëse loja me role dhe simulimi janë dy metoda të ndryshme, ato plotësojnë njëra- tjetrën dhe ndajnë qëllimet e mëposhtme:

- zhvillojnë imagjinatën dhe shprehitë e të menduarit kritik
- nxisin shprehjen e qëndrimeve, të opinioneve dhe të vlerave
- zhvillojnë më tej aftësinë e nxënësve për të zhvilluar dhe vlerësuar alternativa të ndryshme veprimi
- të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar tjetrin.

Procedura

1) Veprimtaritë fillestare duhet të jenë të thjeshta. Komplexiteti i tyre duhet të vijë gradualisht, në përputhje me vetë synimet e lojës me role;

2) Nga nxënësit nuk duhet pritur përsosmëria e lojës me role që në fillim. Atyre u duhet dhënë koha e mjaftueshme për të fituar aftësitë që kërkon loja me role dhe simulimi. Gjatë përdorimit të tyre është mirë që mësuesi t'u ofrojë nxënësve larmi veprimtarish;

3) Gjatë zhvillimit të lojës me role ose simulimit mësuesi duhet të mbajë mirë parasysh momentet e mëposhtme:

- planifikimi paraprak dhe parapërgatitja e mësuesit
- parapërgatitja dhe trajnimi i nxënësve
- përfshirja aktive e klasës në të gjithë veprimtarinë
- diskutime të kujdesshme dhe reflektim rreth veprimtarisë

4) Nëse nxënësit ndjehen jo mirë ose të shqetësuar për rolet që kanë, është mirë që ato të zhvillohen në mjedise më të sigurta, në të cilat ekziston klimë e sigurt dhe mirëkuptimi për të gjithë. Kjo do t'u japë mundësi nxënësve të kuptojnë se mund të ekzistojnë disa mënyra për të reaguar ndaj një situate ose problemi. Kjo gjë arrihet përmes ushtrimeve të herëpashershme të nxënësve në veprimtari të tilla.

5) Përmbledhja duhet të shoqërohet me analiza dhe reflektime të thella të nxënësve dhe të mësuesve.

PËRDORIMI I MATERIALEVE PAMORE

Qëllimi

Zhvillimi i lëndës së edukimit ligjor do të pasurohej nëse në të do të mund të përdoreshin materialet e shumta vizuale si videokaseta, sekuenca filmike, pamje etj.

Materialet pamore janë një mjet i efektshëm për të transmetuar, në një kohë të shkurtër, informacione të caktuara gjë që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shprehitë e tyre vëzhguese dhe analitike. Përveç kësaj, ato i ndihmojnë nxënësit të formulojnë, të shprehin dhe të qartësojnë opinionet e tyre, duke rritur motivimin dhe interesin në fushën e tyre të studimit.

Procedura

1. Zgjidhet një mjet pamor që ka lidhje me temën që do të zhvillohet;
2. Rishikohet ai me kujdes përpara se t'i bëhet i njohur nxënësve. Kjo ka rëndësi për të përcaktuar kohën dhe mënyrën më të mirë për përdorimin e tij në klasë, në përputhje me planin e orës së mësimi dhe në harmoni me teknika të tjera të parashikuara në të. Përveç kësaj, materiali duhet parë paraprakisht edhe për të kontrolluar nëse ai është i pastër nga njëanshmëritë dhe paragjykimet;
3. Paraqitja e materialit pamor nuk duhet të bëhet i pa harmonizuar me materialet e tjera dhe jashtë përmbajtjes së kapitullit ose të lëndës. Qëllimi është që të aftësohen nxënësit të zbulojnë thelbin e dukurisë në trajtim dhe lidhjen e saj me problemet e tjera të lëndës;
4. Paraqitja e materialit mund të bëhet e plotë ose shkallë-shkallë duke i lënë nxënësit mundësinë e reflektimit dhe të diskutimeve pas çdo paraqitje;
5. Përmbledhja e materialit. Mësuesi duhet të jetë kurdoherë i përgatitur të bëjë përmbledhjen e materialit pamor të paraqitur dhe nxënësve u duhet dhënë kurdoherë mundësia të diskutojnë për atë që shohin e dëgjojnë. Ata kanë të drejtë ta pranojnë ose ta kundërshtojnë materialin e paraqitur dhe duhen nxitur të shprehin ndjenjat dhe mendimin e tyre për të. Përveç kësaj, mësuesi mund t'u kërkojë atyre të identifikojnë njëanshmëritë ose mungesat e tjera të informacionit pamor me të cilin ata u njohën si dhe të shprehin mendimin e tyre jo vetëm lidhur me materialin e paraqitur por më tepër lidhur me dukurinë që ai përfaqëson ose shpreh.

BURIMET KOMUNITARE

Në çdo komunitet ka shumë burime njerëzore që mund të pasurojnë procesin e mësimdhënies së edukimit ligjor. Përdorimi i tyre mund të bëhet në dy mënyra: me pjesëmarrjen në orën e mësimi të personave të ftuar ose e tërë klasa ftohet të marrë pjesë në një veprimtari komuniteti.

Qëllimi

Qëllimi i “përfimit” nga personave të ftuar ose vizitat në vende të posaçme të komunitetit mund t’u sigurojë nxënësve informacione të larmishme lidhur me çështjen në trajtim, si dhe përvoja që nuk mund të përfshihen në një tekst shkollor. Të nxënit përmes burimeve komunitare përbën një ndër veçoritë e edukimit ligjor, pasi u jep mundësi nxënësve të njihen sa do pak me sistemin ligjor në veprim. “Përfitimi” nga persona të ftuar mund t’u japë nxënësve shanse që të përfshihen, në një farë mënyre, në fushën e ligjit, të zgjerojnë këndvështrimet e tyre për të, dhe si i tillë, i shërben realizimit të objektivave të edukimit ligjor në përgjithësi.

Procedura

- Në fillim zgjidhet personi që do të ftohet. Numri i personave që mund të ftohen është i madh dhe kjo varet nga tema e mësimi dhe qëllimet e saj. Ata mund të jenë juristë, avokatë, studentë të fakultetit të drejtësisë, punonjës të policisë etj. Por ata mund të jenë edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, punonjës socialë, gazetarë etj.
- Për të përfituar sa më shumë nga i ftuari është e domosdoshme përgatitja paraprake e folësit dhe e klasës. I ftuari duhet të ketë informacionin e nevojshëm për klasën, temën që do të trajtohet dhe interesin e nxënësve për të. Në të njëjtën kohë ai duhet të njihet me objektivat e lëndës në përgjithësi dhe të temës në veçanti dhe të përgatisë fjalën e tij në përputhje me to. Po kështu edhe klasa duhet të njihet me personin që do të ftohet dhe duhet të përgatisin edhe një listë pyetjesh për të, mundësisht të shkruara me të cilat i ftuari duhet të njihet paraprakisht.
- Zhvillimi i orës së mësimi. Zakonisht të ftuarit paraqesin material të shkurtër lidhur me çështjen për të cilën janë ftuar dhe për të cilën kanë përvojë dhe më pas vijojnë me një seancë pyetje-përgjigje.

- Përveç kësaj, i ftuari mund të përfshihet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në një veprimtari të planifikuar në klasë, për shembull, ai mund të luajë rolin e një gjykatësi ose të një dëshmitari në një gjyq të imituar në klasë, ai mund të ftohet në një diskutim në klasë, ose të luajë rolin e një ligjbërësi që u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve në një konferencë shtypi të improvizuar në klasë. Përfshirja e të ftuarit në veprimtarinë e klasës e liron këtë të fundit nga përgjegjësia e menaxhimit të saj dhe suksesi i veprimtarisë së planifikuar të klasës nuk varet vetëm nga aftësitë e të ftuarit në të. Dhe së fundi, nëse i ftuari nuk është në gjendje të vijë në klasë, veprimtaria e saj nuk dështon.
- Përmbledhja. Pas zhvillimit të orës së mësimit ose si pjesë të saj mësuesi duhet të pyesë klasën për atë çka ata mësuan nga i ftuari, si u ndjenë, ç'refleksione kanë etj.

ORGANIZIMI I VIZITAVE NË INSTITUCIONE TË NDRYSHME PUBLIKE

Procedura

1. Në fillim vendoset për institucionin që do të vizitohet. Institucionet që lidhen me ligjin ose më çështje që lidhen me të, janë gjykatat, prokuroritë, policinë, institucionet qeveritare etj. Megjithatë ka edhe shumë institucione të tjera që mund të vizitohen madje më shumë se një herë. Për shembull, nxënësit mund të marrin pjesë në një gjyq civil, në seanca pajtimi ose në procedime të tjera që mund të bëhen në të njëjtën ndërtesë.
2. Planifikimi i vizitës. Nxënësit duhet të përgatiten mirë për vizitën që do të kryejnë, po kështu duhet bërë përpjekje për të përfshirë sa më shumë që të jetë e mundur personelin e institucionit që do të vizitohet. Nëse nxënësit do të marrin pjesë në një gjyq, mësuesi ose një person i ngarkuar prej tij duhet të përpiqet që, së bashku me personin përgjegjës të institucionit, të vendosin për kohën më të përshtatshme për pjesëmarrje, domethënë më interesante për nxënësit dhe të lidhur edhe me objektivat e veprimtarisë mësimore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë mund t'i kërkohet një gjyqtari ose punonjësi tjetër të ligjit që t'u shpjegojë nxënësve thelbin e veprimtarisë që zhvillohet në institucion. Mirë është që nxënësit të

pajisen me një fletë punë në të cilën ata mund të regjistrojnë çfarë vëzhguan dhe mësuan gjatë vizitës.

3. Kryeja e vizitës. Si në çdo orë ose veprimtari mësimore, nxënësit duhet të jenë të përgatitur për të bërë pyetje, për të vëzhguar dhe për të marrë shënime për gjëra të veçanta që lidhen me përmbajtjen e punës së institucionit ose të rezultateve të saj. Planifikimi i kujdesshëm do të ishte edhe bazë për suksesin e një vizite të tillë.
4. Përmbledhja. Fletët e vëzhgimit të plotësuar nga nxënësit shërbejnë edhe për përmbledhjen e rezultateve të vizitës së bërë. Përveç fletëve, përmbledhja mund të realizohet edhe duke dialoguar me nxënësit. Për këtë qëllim mund të përdoren edhe pyetje të tilla si:
 - Çfarë vëzhguat gjatë vizitës në institucion?
 - Çfarë ndjetë për atë që patë ose kuptuat nga veprimtaria e tij?
 - Çfarë mësuar nga kjo vizitë?
 - Në ç'mënyrë lidhet ajo që mësuar nga kjo vizitë me njohuritë tuaja të mëparshme rreth veprimtarisë së institucionit?
 - Çfarë do të dëshironit të dinit më shumë për veprimtarinë e këtij institucioni? Etj.

TË MENDUARIT KRITIK

Të mësosh nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike qëndron në bazë të arsimit të shkencave shoqërore. Edukimi ligjor, si pjesë e këtij arsimimi, i mundëson nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike për probleme të rëndësishme, që lidhen me jetën e individëve dhe të shoqërisë njerëzore në tërësi. Edukimi ligjor i përfshin nxënësit në studimin e konflikteve dhe të çështjeve kontradiktore. Vetë ligjet nënkuptojnë konflikte dhe edukimi ligjor u siguron nxënësve mundësinë të mësojnë rreth çështjeve kontradiktore të përshtatura për moshën e tyre dhe me rolin e tyre si qytetarë. Së fundi, edukimi ligjor kërkon shqyrtimin e vlerave që bien ndesh me njëra-tjetrën dhe me politikat që qëndrojnë në themel të ligjeve, duke u ofruar në këtë mënyrë nxënësve mundësinë të shqyrtojnë idetë, opinionet dhe bindjet e tyre.

Qëllimi

Demokracia u kërkon qytetarëve të saj të jenë të aftë të trajtojnë me zgjuarsi çështjet kontradiktore. Një nga arsyt kryesore të studimit të çështjeve kontradiktore është edhe nxitja e zhvillimit të shprehive të të dëgjuarit dhe të komunikimit, rritja e empatisë (domethënë e aftësisë dhe e dëshirës së nxënësve për të vënë veten në vendin e tjetrit me qëllim që të kuptojë më mirë ndjenjat dhe gjendjen e tij emocionale, shpirtërore ose intelektuale), rritja e aftësisë së nxënësve për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime, për të zhvilluar shprehitë për të arsyetuar dhe menduar në mënyrë kritike si dhe për të rritur aftësitë e nxënësve për të pasur, mbështetur dhe përdorur bindjet e tyre.

Procedura

Metodat dhe teknikat që mund të përdoren për të rritur aftësinë e nxënësit për të menduar në mënyrë kritike për çështjet kontradiktore janë të shumta. Ato më të përdorurat janë: radhitja e opinioneve, kontinuumi i vlerave (segmenti me dy ekstreme që lejon nxënësit të pozicionohet nga njëri ekstrem në tjetrin), deklaratat e hapura dhe veprimtaritë që kërkojnë renditjen sipas një kriteri të caktuar. Pavarësisht nga teknika, procesi i të menduarit në mënyrë kritike përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Nxënësve u kërkohet ose ju jepet shansi për të shprehur qëndrimin e tyre për një çështje të caktuar.
2. Nxënësve u kërkohet të qartësojnë mendimin e shprehur. Kjo mund të bëhet duke zhvilluar pyetje të tilla si:
 - Çfarë doni të thoni me... ?
 - A mund të shpjegoni qëndrimin tuaj?
 - A mund të jepni një përcaktim për mendimin që shprehët? Etj.
3. Kërkojuni nxënësve të shqyrtojnë arsyt që mbështesin mendimin e tyre. Për këtë mund të ndihmojnë pyetje të tilla si:
 - Pse mendoni kështu?
 - Cilat janë arsyt që mbështesin mendimin tuaj?
 - Cilat janë argumentet që jepni për të mbështetur qëndrimin tuaj?
 - Cilat janë faktet që i mbështesin pikëpamjen tuaj? Etj.
4. Kërkojuni nxënësve të marrin parasysh pikëpamjet e kundërta. Kjo ka shumë rëndësi dhe mund të realizohet me anë të pyetjeve të

tilla si:

- Si mendoni se ndjehen të tjerët për ...?
 - Cilat janë disa nga mendimet e të tjerëve për...
 - Cilat janë alternativat që ekzistojnë përveç qëndrimit tuaj? Etj
5. Nxënësit duhet të analizojnë qëndrimin e tyre dhe këndvështrimet e të tjerëve. Kjo do të thotë se nxënësit duhet të krahasojnë dhe të kundërvënë pikëpamjet dhe pasojat e secilës prej tyre. Pyetje tipike që përdoren për të përfshirë nxënësit në një proces të tillë janë:
- Cili është argumenti kryesor që mbështet pikëpamjen tuaj? Cila është pika e dobët e pikëpamjes suaj?
 - Cili është argumenti më i fortë që kundërshton pikëpamjen tuaj? Po pika më e dobët e pikëpamjes së kundërt me ju?
 - Cilat janë faktet që kundërshtojnë ose mbështesin pikëpamjen tuaj?

Të menduarit për pasojat logjike që mund të shoqërojnë çdo pikëpamje të shprehur mund të arrihet me anë të pyetjeve të tilla si:

- Çfarë mund të ndodhë nëse pikëpamja juaj pranohet nga shoqëria?
 - Cilat mund të jenë disa nga pasojat e saj për shoqërinë?
 - Cili mund të jetë rezultati përfundimtar i saj?
6. Nxënësit duhet të marrin një vendim lidhur me çështjen në diskutim. Ky është edhe hapi i fundit në këtë proces. Kjo mund të arrihet duke i ftuar nxënësit të rivlerësojnë dhe të zgjidhin konfliktin ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme. Disa nga pyetjet që mund të bëhen në këtë rast janë:
- Cili mund të ishte rezultati më i mirë? Cili është rezultati më i dëshiruar? Si mund ta arrijmë atë? Çfarë duhet për bërë për të arritur qëllimin e dëshiruar? Etj.

Cilat janë disa nga strategjitë për të nxitur të menduarit kritik?

Siç e thamë edhe më lart ndër më të përdorurat për këtë qëllim në fushën e edukimit ligjor janë:

a) Radhitja e opinioneve.

Kjo është një strategji që i lejon nxënësit të shprehin mendimin e tyre për çështjen në studim. Përgjithësisht, radhitja lejon një shpërndarje të opinioneve (për shembull nga: jam shumë dakord/

jam dakord/

jam i pavendosur/

nuk jam dakord /

kundërshtoj fuqimisht).

Një radhitje e tillë e opinioneve mund:

- të shërbejë si nxitje për diskutime në klasë;
- t'i japë mësuesit informacion për t'u njohur me vlerat, qëndrimet dhe bindjet e nxënësve;
- të përdoret për të vlerësuar ndryshimet e mundshme në qëndrimet e nxënësve si rrjedhojë e procesit të të mësuarit.

Për të realizuar këtë strategji mësuesi duhet të sigurojë që çdo nxënës të mund të shprehë lirisht mendimin e tij personal.

Në fund nxënësve duhet t'u kërkohet të argumentojnë mendimet e tyre dhe në të njëjtën kohë ata duhet të mësojnë të dëgjojnë edhe mendimet e kundërta.

Është mirë që mësuesi, duke e përdorur këtë strategji për çështje të ndryshme, të kontrollojë se sa qëndrueshmëri kanë nxënësit në pikëpamjet e shprehura.

Po kështu mësuesi mund t'u ofrojë nxënësve edhe ndonjë studim rasti që lidhet me ndonjë mendim të veçantë të shprehur nga nxënësit gjatë radhitjes së opinioneve. Për shembull, nëse pjesa më e madhe e nxënësve shprehen pro ose kundër dënimit me vdekje, mësuesi mund t'u japë atyre një studim rasti që kërkon një analizë më të thellë nga ana e tyre të një çështje të caktuar që lidhet me dënimin me vdekje.

b) Renditja sipas një kriteri të caktuar. Kontinumi

Renditja sipas një kriteri të caktuar është një strategji që u ofron mundësinë nxënësve të analizojnë dhe të diskutojnë bindjet e tyre duke u kërkuar atyre të bëjnë zgjedhjet ndërmjet disa alternativave që konkurrojnë me njëra-tjetrën. Kjo strategji mund të përdoret për shembull kur nxënësve

u kërkohet të rendisin veprat penale sipas shkallës së rrezikshmërisë së tyre shoqërore.

Variacion i kësaj strategjie është kontinumi, që u kërkon nxënësve të vendosin veten midis dy skajeve të një segmenti që përfaqësojnë pikëpamje diametralisht të kundërta lidhur me një çështje të caktuar, për shembull: jam krejtësisht kundër dënimit me vdekje – jam plotësisht dakord për dënimin me vdekje)

Është mirë që nxënësve t'u jepet mundësia të argumentojnë radhitjen ose vendosjen e tyre në një kontinuum, të dëgjojnë pikëpamjet e kundërta të të tjerëve si dhe të rivlerësojnë qëndrimet e tyre pas diskutimeve ose reflektimeve të bëra.

STUDIMI I RASTIT - KAZUSI

Studimet e rastit ose kazuset, siç përdoren shpesh në gjuhën juridike, mund të ndërtohen në forma të ndryshme. Ato mund të bazohen në situata hipotetike, që përfshijnë konflikte të ndryshme ose në situata jetësore reale të marra nga gazetatat, revistat, librat ose nga burime të tjera. Ato zakonisht paraqiten në formë të shkruar, por kur është e mundur edhe me mjete audiovizive, si videokaseta, filma etj.

Qëllimi

Studimi i rastit është një metodë e orientuar nga shqyrtimi (hetimi) i thelluar i çështjes, që synon të ndihmojë nxënësit në zbatimin e njohurive ligjore në situata të ndryshme jetësore. Përveç njohjes me një rezultat ligjor që lidhet me një problem të caktuar, nxënësit vihen në situata në të cilat ata duhet të zbulojnë dhe të shqyrtojnë si idetë ashtu dhe përfundimet e tyre. Një proces i tillë rrit aftësitë e nxënësve për analiza e gjykime të pavarura, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të marrë vendime, ndërsa në fushën afektive, rrit interesin e tyre në shqyrtimin e ideve dhe të përfundimeve që lidhen me to.

Si i tillë studimi i rastit kërkon nga nxënësit:

- Të analizojnë situata problemore
- Të sintetizojnë dhe të arrijnë në përfundime
- Të gjykojnë dhe të vlerësojnë përfundimet
- Të zbatojnë njohuritë në situata reale.

Procedura

1. Kuptimi i fakteve të një studimi rasti

Fillimisht, nxënësit duhet të kuptojnë faktet e studimit të rastit. Ata duhet të lexojnë ose të dëgjojnë përshkrimet e fakteve të një studimi rasti. Një mënyrë e efektshme për të siguruar të kuptuarit e fakteve të studimit të rastit nga nxënësit, është që ata të vendosen në çift ku secili prej tyre përpiqet që t'i përmbledhë faktet e tij për t'ia thënë tjetrit.

Për të ndihmuar nxënësit në kuptimin e studimit të rastit, ftohen ata në dialogë me pyetje të tilla si:

- Çfarë ndodh në këtë kazus?
- Cilat janë palët e përfshira?
- Cilat janë motivet e veprimeve të përfshira në kazus?
- Cilat fakte janë të rëndësishëm?
- Çfarë mungon?

Për mësuesin është e rëndësishme që të verifikojë nëse nxënësit i kanë kuptuar si duhet faktet e studimit të rastit.

2. Përcaktimi i problemit (i çështjes)

Përcaktimi i problemit dhe i aspekteve që lidhen me të, ka shumë rëndësi për vazhdimësinë e veprimtarisë. Mund të ndodhë që për nxënësit të jetë e vështirë të përcaktojnë ose të paraqesin, në formën e një pyetjeje, çështjen ligjore që qëndron në thelb të një studimi rasti. Në këtë rast, mësuesi i ndihmon ata dhe i fton që, përveç aspektit ligjor të një studimi rasti, të zbulojnë edhe aspekte të tjera politike, morale ose praktike që përfshihen në të. Për shembull, në një rast aborti mund të trajtohen aspektet e mëposhtme:

- Ligjore: Cila është çështja ligjore(dallohet fakti nga çështja ligjore)
- Politike: Cili duhet të jetë ligji. (A duhet aborti të jetë i ligjshëm?).
- Etike: Cilat vlera morale janë më rëndësishme?: e drejta e gruas për të vendosur vetë për fatin e saj apo e drejta e fetusit për të jetuar?

Pse?

- Praktike: Si mund të zgjidhim praktikisht situatën ligjore në të cilën ndodhemi? Cilat janë mundësitë e zgjidhjes? Etj.

3. Diskutimi i argumenteve

Pasi nxënësit të jenë njohur me faktet dhe me çështjet që përfshihen në një studim rasti, ata duhet të zhvillojnë dhe të diskutojnë argumentet në favor të një qëndrimi të caktuar ose kundër tij. Kur diskutohen argumentet, duhet mbajtur parasysh që nxënësi:

- të përcaktojë argumentet ligjore, politike etj, duke konsideruar të dy anët e problemit;
- të dallojë argumentet më të rëndësishme dhe më bindëse nga ato që nuk janë të tilla;
- të marrë në konsideratë pasojat e shumëfishta të çdo zgjedhjeje që do të bëjnë;
- të marrë në konsideratë alternativa të ndryshme.

Në diskutim është i domosdoshëm krijimi i një klime të hapur dhe të ngrohtë që lejon dhe mirëpret të gjitha pikëpamjet dhe idetë sado të ndryshme dhe kundërshtuese të jenë ato. Për të krijuar një klime të tillë edhe nxënësit duhen nxitur të dëgjojnë, të marrin parasysh dhe të vlerësojnë të gjitha këndvështrimet e shprehura.

4. Marrja e vendimit

Marrja e vendimit është edhe përgjigja ose zgjidhja e studimit të rastit.

Kur nxënësve u jepet vendimi nga mësuesi, atyre u kërkohet ta vlerësojnë atë, duke marrë parasysh edhe pasojat e tij për shoqërinë, për individët e përfshirë në studimin e rastit etj.

Ndonjëherë nxënësit duhet të marrin vetë vendimin. Në çdo rast ata duhet të diskutojnë, të krahasojnë vendimet e ndryshme dhe të japin kurdoherë shpjegimet përkatëse.

5. Variacione

Kur mësuesi u jep nxënësve studimet e rastit, ai mund të zgjedhë një ndër variantet e mëposhtme:

1. Studimi i rastit është dhënë i plotë: faktet, problemi(çështja), argumentet, vendimi. Nxënësit i kërkohet:
 - të identifikojë elementët e tij
 - të vlerësojë vendimin
2. **Janë dhënë faktet dhe problemi. Nxënësit i kërkohet të identifikojë argumentet e kundërta**
3. Janë dhënë faktet, problemi, argumentet dhe opinione të ndryshme lidhur me zgjidhjen. Nxënësit i kërkohet:
 - të zgjedhë opinionin me të cilin është dakord, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse
 - të krahasojë zgjedhjen e tij me vendimin që i bëhet i njohur më pas.
4. Janë dhënë faktet, problemi, argumentet. Nxënësi duhet të marrë vendim mbi bazën e arsytimeve.

Më poshtë po japim disa sugjerime për zgjedhjen e kazuseve ligjore në kuadrin e zhvillimit të veprimtarive në fushën e edukimit ligjor.

Për zgjedhjen e studimeve të rastit, të vlefshme për t'u zhvilluar në një veprimtari në fushën e edukimit ligjor, është e rëndësishme të mbahen parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Njohuritë juridike.

Këtu përfshihen ato studime rasti, njohja e të cilave shërben për zhvillimin e njohurive bazë të domosdoshme për të kuptuar sistemin gjyqësor dhe për të qenë të aftë për të marrë vendime të pjekura e logjike rreth çështjeve të politikës së sotme publike. Ky kriter nënkupton që nxënësi nuk duhet vetëm të mësojë se si të trajtojë një ose disa studime rasti, por edhe të vlerësojë që disa prej tyre janë aq të rëndësishme, sa që është e domosdoshme të njihen konkretisht.

2. Çështjet “e nxehta” të politikës publike.

Quhen të tilla çështjet që janë ose që, shpejt apo vonë, do të jenë objekt i arenës politike, pavarësisht se cili ka qenë apo do të jetë vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me to. Këto janë çështje për të cilat parlamenti

duhet të reagojë duke kryer funksionin e tij legjislativ dhe, më rrallë, vetë kushtetuta duhet të plotësohet me amendamente për shkak se ato e kërkojnë një gjë të tillë.

3. Faktet interesante.

Këtu futen çështjet të cilat përputhen me interesat e brezit të ri. Disa nga këto mund të marrin jetë nga të rinjtë ose në emër të tyre. Ndër këto mund të jenë çështjet që lidhen me shkollën. Duhet të bëjmë kujdes që kur flasim për përputhje me interesat e të rinjve ose kur e cilësojmë një fakt ose një çështje interesante hamendësohet që të gjithë të rinjtë janë të interesuar njëllëj rreth tij/saj, në një kohë kur të gjithë e dimë se kjo nuk është e vërtetë. Për të shmangur këtë, është e domosdoshme që të njihen mirë veçoritë, interesat dhe parapëlqimet e nxënësve.

4. Çështje të përhershme ose konfliktuale

Një çështje ligjore ose kushtetuese që përmbahet në një kazus përsëritet në një mënyrë apo tjetër, sepse ajo përfaqëson një konflikt ose tension ndërmjet vlerave demokratike pozitive si, shanset e barabarta dhe liria. Nxënësit është mirë të mësojnë rreth kazuseve të tilla sepse ata nxitin jo vetëm të nxënit por edhe përsosjen morale. Përveç kësaj, edhe pse vetë kazusi ose çështja humbasin parësinë e tyre në kohë dhe hapësirë ose ndryshojnë, konflikti ndërmjet vlerave që ata përfaqësojnë do të rishfaqet herë pas here. Dhe në qoftë se pas një pyetje të tillë si “Me se ka të bëjë ky rast”? (dhe me këtë kihet parasysh një kazus konkret çfarëdo) nxënësit do të vijnë te konflikti në fjalë, atëherë mund të themi se kriteri për të cilin po flasim është plotësuar.

5. Fakte “të kapshme”(të kuptueshme)

Është e rëndësishme që faktet e një kazusi të jenë të kuptueshme nga nxënësit. Vetëm në këtë rast mund të themi se kazusi mund t’i vlejë qëllimit për të cilin është zgjedhur. Mund të ndodhë që kazusi të plotësojë disa nga kriteret, por njëkohësisht ai mund të jetë i një shkalle të tillë vështirësie sa që zbulimi i thelbit të tij nga nxënësit do të ishte praktikisht i pamundur. Në fakt, shumë kazuse kanë të bëjnë me rregullime apo procedura që, ndonëse i interesojnë specialistëve, nuk mund të kuptohen lehtë nga ne. Në të kundërtën, një kazus që plotëson këtë kriter mund të përmbajë fakte të thjeshtë e interesante që do të na krijojnë ne mundësinë të shpenzimit pjesën më të madhe të kohës duke u marrë me të.

6. Faktet që përmban kazusi dhe çështja (ose çështjet) të jenë në përputhje me synimet kurrikulare.

Në këtë rast le të kujtojmë pyetjen që ia bëjmë vetes sa herë që fillojmë një veprimtari, ose përgatisim një orë mësimi: Çfarë do të dijë dhe do të jetë i aftë të bëjë nxënësi në fund të mësimi/të kapitullit/të lëndës në shkollë? Pra, nëse kazusi e çon nxënësin drejt objektivit të përcaktuar, atëherë mund të thuhet se kriteri është plotësuar. Për shembull, nëse një nga objektivat do të ishte kuptimi nga nxënësit e ndarjes së pushteteve, atëherë edhe kazuset do të kërkoheshin lidhur me këtë çështje.

7. Ekzistenca e materialeve mësimore cilësore.

Pyetja që shtrohet në këtë rast është: A ekzistojnë burime materiale rreth një kazusi të caktuar që mund të shfrytëzohen pa vështirësi nga nxënësi? Megjithëse, psh., interneti mund të ofrojë mjaft të tillë, përsëri ekziston çështja e kohës që duhet për përkthimin e tyre nga nxënësit. Sigurisht, kjo nuk do të përbënte problem për mjaft nxënës të rritur që zotërojnë gjuhën, por megjithatë, është fakt që edhe mësues shumë të mirë shfrytëzojnë materiale të përkthyer e përgatitura që më parë nga të tjerë.

8. Orientimi drejt së ardhmes.

Nëse kazusi do të jetë i orientuar drejt së ardhmes, atëherë ai do të shoqërohet me pyetje të tilla si: Në ç'mënyrë një ligj ndryshon, përshtatet dhe reflekton ndryshimet e shoqërisë? Cilat janë disa nga çështjet që duken se do shqetësojnë në mënyrë të veçantë të ardhmen? Jini vigjilentë për kazuse që lidhen me zhvillimet teknologjike dhe ato që kanë të bëjnë me shoqërinë gjithnjë e më shumëkulturëshe në të cilën jetojmë.

9. Humanizmi .

Për të plotësuar këtë kriter është e rëndësishme që të zgjidhen kazuse që vënë theksin në përmasat njerëzore të procesit gjyqësor. Ka kazuse që shërbejnë mjaft mirë për të ngjallur interes rreth aventurave të jetës së dikujt, sikurse ka të tjerë që tregojnë se individët mund të bëjnë shumë për të ndryshuar shoqërinë. Çështja thelbësore në këtë rast do të ishte: Në çfarë shkalle kazusi konkret hap një dritare për të kuptuar më mirë aspektin njerëzor? P.sh. kazuset që kanë të bëjnë me një individ të caktuar (dhe që shpesh shfaqet si përfaqësues i të tjerëve) do të rritnin mjaft përgjegjësinë dhe detyrimin të rinjtë ndaj fateve të shoqërisë. Megjithatë, nuk duhet harruar që në raste të tilla, në fokus të jenë njerëz dhe situata reale.

10. Kazuse që janë në interesin e mësuesit

Është i njohur fakti që të rinjtë (por jo vetëm ata) reagojnë ndaj pasionit me të cilin mësuesi trajton një çështje të caktuar. Përveç përpjekjes për të mësuar të tjerët rreth një kazusi, rreth çështjeve që lidhen me të, të ardhmes, të shkuarës, dramës njerëzore etj., mësuesi transmeton tek ata edhe dashurinë për të nxënit. Për këtë arsye do të ishte me vend që të zgjidhen kazuse që do të ndihmonin dhe lehtësonin atë në punën me nxënësit.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE KONTRADIKTORE

Një nga teknikat që përdoret më shpesh në rastet kur diskutohen çështje që karakterizohen nga qëndrime krejtësisht të kundërta është **Kontinumi**.

Qëllimi

Qëllimi i një teknike të tillë është:

- Të identifikojë qëndrimet e kundërta për një çështje për të cilën normalisht ekzistojnë mendime të tilla
- Të shqyrtojë qëndrimet alternative dhe pasojat e tyre në shoqëri dhe tek individët
- Të praktikojë shprehitë e mbrojtjes së një qëndrimi të caktuar
- Të praktikojë shprehitë e të dëgjuarit të opinioneve të të tjerëve

Procedura

- Veprimtaria fillon me përshkrimin nga mësuesi të çështjes në detaje që janë të mjaftueshme për të përcaktuar qartë qëndrimet diametralisht të kundërta. Këto qëndrime duhet të paraqiten në një vend të dukshëm në klasë;
- Nxënësit ftohen të shkruajnë qëndrimin e tyre dhe të listojnë dy nga argumentet më të rëndësishme për mbrojtjen e qëndrimit të tyre;
- Gjatë kohës që nxënësit shkruajnë argumentet e tyre mësuesi përcakton si skaje të kontinuumit dy muret ballore të klasës. Kur nxënësit mbarojnë shkrimin e argumenteve, mësuesi lexon dy pozicionet e mundshme diametralisht të kundërta të cilat i vendos

në skajet e kontinuumit. Më pas, ai fton disa nxënës të qëndrojnë në skajet e kontinuumit ose ndërmjet tyre në përputhje me mendimin e tyre. Nxënësit janë të lirë të lëvizin përgjatë kontinuumit, pra të ndryshojnë pozicionin e tyre nëse sqarimet e mëtejshme të shokëve do t'ua sugjeronin këtë gjë;

- Pasi mbaron lëvizja e nxënësve përgjatë kontinuumit, nxënësit e tjerë pyeten nëse vendosja e nxënësve në të është bërë në përputhje me kuptimin nga ana e tyre të deklaratave të mësuesit;
- Nxënësve që ndodhen në kontinuum u kërkohet që të japin argumentet e tyre për vendndodhjen e tyre në të, ndërkohë që ata mund t'i përgjigjen pyetjeve të mundshme që lidhet me argumentet e tyre por pa lejuar të jepen argumente të tjerë;
- Për të siguruar që nxënësit i dëgjojnë pikëpamjet e kundërta dhe i marrin ato parasysh, atyre mund t'u kërkohet të japin argumentet e kundërta edhe pse ato mund të jenë të kundërta me qëndrimin e tyre. Një gjë e tillë mund t'i bëjë ata të mendojnë edhe një herë për qëndrimin e tyre, madje edhe ta ndryshojnë atë, nëse mendojnë se argumentet e kundërta mund t'u duken më bindëse ;
- Së fundi, nxënësit ftohen të identifikojnë dhe të vlerësojnë pasojat e zgjidhjeve ose të qëndrimeve alternative. Më pas klasa diskuton për ndikimin që qëndrimet ekstreme mund të kenë për shoqërinë ose individin.

Udhëzime për trajtimin e çështjeve kontradiktore në klasë

Diskutimi i çështjeve kontradiktore jo vetëm që i nxit nxënësit për të marrë pjesë në veprimtari, por edhe i mëson atyre shprehitë e marrjes së vendimeve, të pjesëmarrjes shoqërore dhe të menaxhimit të konflikteve.

Shpesh mësuesit janë rezistencë në trajtimin e çështjeve kontradiktore duke pasur frikë se nxënësit nuk do të jenë të aftë të diskutojnë ato të zhveshur nga ngarkesat emocionale. Megjithatë, debati i arsyeshëm dhe kundërshtitë e rrisin interesin e nxënësve në mësim dhe i përfshin ata aktivisht në procesin e të nxënës dhe të ushtrimit të shprehive që lidhen me trajtimin e çështjeve në fjalë.

Në vijim jepen disa sugjerime që mund të ndihmojnë në trajtimin e çështjeve kontradiktore:

- Nxitini nxënësit të shqyrtojnë dhe të paraqesin pikëpamjet e kundërta ose konfliktuale. Bëni ç'është e mundur që të shqyrtohen të gjitha aspektet e çështjes. Nëse është e nevojshme ndërhyni për të bërë plotësimet e e duhura;
- Ndihamoni nxënësit të përcaktojnë pikat kryesore të marrëveshjeve dhe të mosmarrëveshjeve, vendin ku mund të arrihet kompromisi si dhe vendet ku ky kompromis ka pak të ngjarë të ndodhë.
- Bëni kujdes që nxënësit të jenë të përqendruar tek idetë ose qëndrime dhe jo tek njerëzit.

Ndoshta këtu është vendi të kujtojmë një thënie të vjetër që thotë:

- mendjet e mëdha merren me idetë
- mendjet mesatare merren me ngjarjet
- mendjet e vogla merren me njerëzit
- Theksoni vazhdimisht idenë se, për nxënësit, ajo që ka më shumë rëndësi nuk është rezultati, por aftësia e tyre për të marrë një vendim dhe për ta shprehur atë në mënyrë të qytetëruar. Madje, mund të kujtohet edhe thënia se njerëzit e mençur dallohen nga ata që nuk janë të tillë pikërisht në mënyrën e trajtimit të çështjeve kontradiktore;
- Përfundoni me një përmbledhje të veprimtarisë ose të diskutimeve, pa harruar argumentet e paraqitura nga nxënësit si dhe rrjedhojat e alternativave të sugjeruara prej tyre në diskutim.
- Përveç sa më sipër, kur përdoren strategji që kërkojnë diskutime dhe ndarje mendimesh është mirë që në fillim të vendosen disa rregulla bazë. Për shembull:
 - Të gjithë duhet të kenë mundësi të shprehen dhe, mundësisht, kur flet njëri, të tjerët duhet të dëgjojnë;
 - Nxënësit duhet të presin radhën për të shprehur mendimin e tyre dhe askush nuk duhet të ndërpritet;
 - Nxënësve u duhet bërë e qartë se duhet të argumentojnë vetëm me idetë ose arsyet dhe jo me njeri-tjetrin;
 - Secili mund të ndryshojë pikëpamjen ose qëndrimin e vet. Në këtë rast ai duhet të jetë i përgatitur për të dhënë argumentet përkatëse për këtë ndryshim.
 - Nxënësit duhet të dëgjojnë me kujdes idetë ose argumentet e dhëna nga shokët e klasës, pasi atyre mund t'u kërkohet që të

shprehin mendimin e tyre se cila nga idetë e shokëve ju duket më bindëse.

PJESA E PESTE

MODELE VEPRIMTARISH

Në vijim paraqiten disa modele veprimtarish që mund të zhvillohen për trajtimin e aspektit ligjor në lëndën e qytetarisë. Ato nuk trajtojnë të gjitha aspektet që lidhen me dimensionin ligjor, dhe nuk përfshijnë të gjitha metodat, strategjitë ose teknikat që u paraqitën më sipër në këtë udhëzues. Ato janë thjesht modele mësimorë që mund të ndihmojnë mësuesit të vënë në përdorim imagjinatën dhe përvojën në fushën e mësimdhënies për të zhvilluar veprimtaritë e tyre, që pa dyshim do të pasurojnë veprimtaritë e përfshira në këtë manual.

Veprimtaria 1. Ligji dhe qëllimet e tij

Objektiva.

Nxënësi në fund të aktivitetit duhet të jetë i aftë:

- Të shpjegojë qëllimin e ligjit
- Të diskutojë për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri.
- Të identifikojë dhe vlerësojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri
- Të argumentojë me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë.

Procedura.

Hapi I. (15-17'). Pasi bën një hyrje të shkurtër për ligjin si një ndër çështjet më të rrahura e më të diskutueshme në fjalorin e përditshëm të njerëzve, mësuesi shkruan në tabelë deklaratën e marrë nga dialogu i një shkelësi të ligjit me përfaqësuesin e rendit. Ai ndan klasën në tre grupe të

mëdha dhe secilit prej tyre i jep detyrën e mëposhtme:

- Grupi I. vendos vetën në rolin e përfaqësuesit të ligjit dhe përpiqet të gjejë argumente me anë të të cilave ai mbështet pozicionin e tij në shërbim të rendit e të mirës së përgjithshme.
- Grupi II. vendos veten në rolin e shkelësit të ligjit dhe përpiqet të vazhdojë idenë e tij duke dhënë argumente në favor të pikëpamjes dhe qëndrimit të tij ndaj ligjit.
- Grupi III. Vendos veten në qëndrim asnjës dhe përpiqet të gjejë argumente në favor apo kundra deklaratës së mësipërme.

Ligji është tërësi e rregullave të sjelljes, të vendosura dhe të imponuara nga autoriteti i një shteti të caktuar

Pasi përpunojnë argumentet e tyre, grupet i paraqesin dhe i mbrojnë ato para klasës. Mësuesi i shënon argumentet në tabelë sipas grupeve.

Hapi II.(5’). Pasi nxënësit plotësojnë (nëse kanë) argumentet e tyre, mësuesi kërkon nga nxënësit të përpiqen të evidentojnë në mënyrë të përmblëdhur thelbin dhe funksionet e ligjit në shoqëri bazuar në rezultatet e punës së tyre.

Hapi III(10’). Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë tabelën që ndodhet në librin e tyre.

Hapi IV (10-12’). Reflektim dhe diskutim. Mësuesi i përmend nxënësve faktin se qëndrimi ndaj ligjit kurdoherë ka qenë i ndryshëm. Kjo ka ndodhur sepse shpesh roli dhe kuptimi i ligjit, i qëllimeve të tij në shoqëri, në kohë e vende të ndryshme ka qenë i ndryshëm, gjë që ka pasur pasoja jo vetëm në sjelljen e individit ndaj vetë ligjit, por njëkohësisht edhe në marrëdhëniet e tij të gjera me shoqërinë dhe institucionet e saj në përgjithësi.

Shpeshherë në qëndrimin ndaj ligjit kanë ekzistuar dhe ekzistojnë ende paragjykime dhe opinione që nuk mbështeten me fakte bindëse. Këto qëndrime jo rrallë janë ulur deri në plan moral dhe e kanë vënë ligjin përballë kriterit të të mirës dhe të keqes. Një gjë e tillë mund të bëhet edhe me nxënësit të cilët duke u mbështetur në njohuritë dhe përvojën e tyre personale të diskutojnë çështjen mbi rolin pozitiv apo negativ të ligjit në

shoqëri. Në diskutim nxënësit duhet të nxiten të mbështesin qëndrimin e tyre me shembuj nga realiteti. Këtu nxënësve mund t'u kërkohej të përfytyrojnë një shoqëri pa ligje (duke filluar që nga mungesa e semaforëve në rrugë e pasojat e mungesës së tyre e deri te....)

E rëndësishme në diskutim është që nxënësit të cilët kanë evidentuar funksionet e ligjit në shoqëri të ftohen të japin mendimin dhe sugjerimin e tyre lidhur me gjetjen e rrugëve dhe mundësive që ligji të kryejë si duhet dhe brenda mundësive funksionet për të cilat është krijuar. Edhe këtu është mirë që nxënësit, përveç mendimeve të përgjithshme, të mbështeten edhe raste apo ligje konkrete që ata njohin.


Gjatë diskutimit mësuesi mund të pyesë nxënësit edhe lidhur me arsyet pse ata e zbatojnë ligjin.

Nxënësit e zbatojnë ligjin:

- nga frika;
- sepse kështu i kanë thënë;
- sepse e kanë urdhëruar
- për të tjera arsye

Ligji dhe qëllimet e tij.

(Fleta e nxënësit)



Fjalët e mësipërme dalin nga goja e një shkelësi të ligjit dhe i drejtohen një polici.

Reflektoni rreth tyre. Përpiquni të vini veten në fillim në njërin pozicion e më pas në tjetrin.

- Çfarë ndjeni në këtë çast?

- Si do të përgjigjeshit nëse do të ishit polici?
 - Si do t'i argumentonit thëniet e mësipërme nëse do të ishit shkelësi i ligjit?
 - A mund të ekzistojë ndaj ligjit një qëndrim i ndryshëm nga qëndrimet e mësipërme?
 - Cili do të ishte ai?
- Pra,
- Ç'është ligji?
 - Cilat janë funksionet e tij?

Nga jeta:

Fakte apo opinione?

1. Një numër jo i vogël individësh nuk duan të kenë të bëjnë me ligjin dhe organet e tij ndërkohë që të tjerë e kërkojnë dhe i drejtohen ligjit për të mbrojtur interesat e tyre.
 1. Njerëzit që punojnë në organet e rendit shpesh kanë pasoja të pakëndshme për vete dhe familjen e tyre, megjithatë nuk janë të paktë ata që ende dëshirojnë të punojnë në organet e drejtësisë e të merren me ligjin .
 2. Shumë njerëz besojnë se vetëm të pasurit dhe ata që kanë pushtetin mund të fitojnë në fushën e ligjit. Për ta ligji nuk është gjë tjetër veçse
- “një tërësi rregullash të ngatërruara që shpesh vepron kundër tyre”.

Ligji është tërësi e rregullave të sjelljes të vendosura dhe të imponuara nga autoriteti i një shteti të caktuar.

Le të reflektojmë e të diskutojmë së bashku:

- A mund të bëjë shoqëria pa ligje?

Përfytyroni një shoqëri pa ligje !

- A është ligji diçka e mirë apo e keqe?

Ç'duhet bërë që ligjet të kryejnë funksionet për të cilat janë krijuar? Mbështetni përgjigjet tuaja me shembuj nga realiteti.

Detyrë:

Zgjidhni 5 aktivitete që ju i kryeni në jetën tuaj të përditshme dhe përpikuni të plotësoni tabelën e mëposhtme:

Aktiviteti	Ligji që lidhet me aktivitetin	Arsyeja pse ekziston ligji	Unë e zbatoj ligjin sepse:
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

Diskutoni përfundimet.

Veprimtaria 2. Ligji dhe vlerat

Objektivat:

Në fund të aktivitetit nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Identifikojnë dhe diskutojnë për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve.
- Të pasqyrojnë aftësinë, të vlerësojnë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara.

Procedura.

Hapi I(5’) Përmes një brainstorming (ide), mësuesi kërkon nga nxënësit të kujtojnë se ç’janë “vlerat” dhe “normat kulturore”, duke ndërtuar edhe një klastër të shpejtë lidhur me to.

Hapi II (10’) Pasi evokon së bashku me nxënësit lidhjet e normave kulturore me ligjet, mësuesi zgjeron këndvështrimin me të cilin ligji sheh vlerat e shumta(morale, politike, ekonomike dhe sociale) që qëndrojnë në

themel të tij dhe prej të cilave nisen njerëzit kur hartojnë apo vendosin ligje.

Hapi III(20’). Klasa ndahet në grupe të vogla në varësi të rasteve ligjore që përfshihen në librin e nxënësit. Detyra e çdo grupi është të identifikojë dhe analizojë vlerat që qëndrojnë në themel të ligjit që ata kanë në diskutim.

Përfaqësuesi i çdo grupi ndan përfundimet me grupet e tjera duke i shoqëruar ato me argumentet përkatëse.

Hapi IV (10’). Reflektim dhe diskutim. Në këtë fazë mësuesi të mbajë parasysh dhe të theksojë idenë që ligji dhe qëndrimi ndaj tij kanë të bëjnë me fatin e secilit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Po kështu, çdo përpjekje dhe angazhim për të kundërshtuar, zbatuar, ndryshuar apo përmirësuar një ligj duhet parë i lidhur ngushtë me të gjitha pasojat që ajo sjell për individin dhe shoqërinë në plan moral, social, politik dhe ekonomik.

Gjatë diskutimit mësuesi shfrytëzon pyetjet në librin e nxënësit me idenë se qëndrimi ndaj ligjit duhet të shoqërohet kurdoherë me analizën e gjithanshme të vlerave që qëndrojnë në themel të tij.

Vetëm në këtë mënyrë edhe roli ynë si qytetar në përgjithësi dhe në zbatimin apo përmirësimin e ligjeve në veçanti do të jetë më i përgjegjshëm e cilësor.

Variacion

Hapi I. Nxënësve u jepet një ligj për të cilin ata duhet të shprehen pro apo kundër. Ligji shënohet në tabelë së bashku me numrin e votave pro dhe kundër.

Hapi IV. Pas analizës së vlerave nxënësve u kërkohet të votojnë edhe njëherë për ligjin në fjalë. Mësuesi mund të ftojë nxënësit të diskutojnë lidhur me:

- faktorët që ndikuan apo mund të ndikojnë në qëndrimin pro apo

kundër ndaj ligjit konkret.

- faktorët që ndikuan në ndryshimin e qëndrimit ndaj ligjit konkret dhe ligjit në përgjithësi.

Po kështu mësuesi nëse e sheh të arsyeshme mund të zgjerojë diskutimin me çështjen e faktorëve që ndikojnë në qëndrimin ndaj ligjit të individëve, grupeve shoqërore, apo partive të ndryshme që ekzistojnë në Shqipëri

Ligji dhe vlerat

(Fleta e punës e nxënësit)

Ligjet në përgjithësi pasqyrojnë dhe nxisin vlerat e një shoqërie. Edhe sistemi ynë ligjor ngrihet dhe ndikohet nga vlerat dhe idetë tradicionale të shoqërisë sonë për atë që është e drejtë dhe atë që është e padrejtë. Për shembull ligjet kundër krimit pasqyrojnë besimin moral që e konsideron vrasjen e njeriut të padrejtë, faj. Madje shumica e njerëzve e bëjnë vrasjen pavarësisht nga ligji .

Megjithatë jo çdo gjë që është apo vlerësohet nga shoqëria apo nga individë të ndryshëm si e pamoralshme është njëkohësisht edhe e paligjshme. Për shembull gënjeshtria ndonëse vlerësohet e pamoralshme jo gjithmonë është e paligjshme.

Ligjet mund të bazohen në vlera morale, ekonomike, politike ose sociale.

Vlerat morale kanë të bëjnë me çështjen themelore të asaj që është e drejtë dhe e padrejtë apo e gabuar, për shembull ligjet kundër vrasjes mbështeten dhe nxisin vlerën morale primare të shoqërisë, mbrojtjen e jetës.

Megjithatë disa gjera që konsiderohen të pamoralshme mund të mos e shkelin ligjin. Për shembull, vetëmbrojtja në kohë lufte dhe vrasja me paramendim mund të jetë e ligjshme në kohë lufte ose për vetëmbrojtje.

Vlerat ekonomike kanë të bëjnë me asimilimin, ruajtjen, përdorimin dhe ruajtjen e pasurisë. Shumë ligje i mbrojnë vlerat ekonomike duke inkurajuar vendime të caktuara ekonomike dhe duke dekurajuar vendime të tjera. Për shembull ekzistenca dhe veprimi për një kohë të caktuar i ligjit që përjashtonte prodhuesit shqiptarë nga tatimi mbi fitimin në katër vitet e para të veprimtarisë së tyre ekonomike nëse kjo veprimtari parashikonte të zgjaste mbi 10 vjet bëhet për të inkurajuar prodhuesit shqiptarë në vitet e

para të krijimit të biznesit vendas.

Vlerat politike pasqyrojnë lidhjen midis shtetit dhe individit. Ligjet, duke lehtësuar, për shembull, votimin, nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin politik, gjë që përbën një vlerë politike të rëndësishme dhe bazë për demokracinë.

Vlerat sociale kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme për shoqërinë, p.sh. ekzistenca e arsimit falas në shkollat publike synon të mbrojtë dhe të nxisë një vlerë sociale për shoqërinë tonë e pikërisht atë që të gjithë të kenë mundësi të përfitojnë arsimim.

Shumë ligje kombinojnë vlerat morale, politike, ekonomike dhe sociale. Për shembull ligjet kundër vjedhjes trajtojnë çështjen morale të vjedhjes, çështjen ekonomike të mbrojtjes së pronës, çështjen politike, se si qeveria dënon vjedhësit dhe çështja sociale e respektimit të pronës së tjetrit.

Për secilin nga ligjet e mëposhtme tregoni se cilat janë vlerat që i mbështesin.

Jepni argumente për përgjigjet tuaja.

Nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 21

Jeta e personi mbrohet me ligj

Neni 30.

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 35/2

Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 43.

Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Neni 57

Kushdo ka të drejtën për arsim

Ligji që dënon mospagimin e taksave nga ndërmarrjet e vogla apo të mëdha.

Gjatë dhënies së argumenteve mbani parasysh pyetjet e mëposhtme:

1. A duhet të ekzistojë një ligj i tillë?
2. Në cilat vlera mbështetet?
 - Morale
 - Politike
 - Sociale
 - Ekonomike
3. Kush përfiton e kush humbet në plan moral, politik, social, ekonomik?Etj

Reflektoni.

1. A ka pasur raste që keni qenë pro apo kundër një ligji të caktuar? Zgjidhni një ligj konkret. Cili ka qenë qëndrimi juaj ndaj tij?
2. Analizoni edhe një herë vlerat që qëndrojnë në themel të ligjit?
 - A keni përsëri të njëjtin mendim?
 - Jepni shpjegimin tuaj për këtë fakt.

Veprimtaria 3. Diskriminimi i arsyeshëm apo i padrejtë?

Në trajtimin e problemit të diskriminimit është e rëndësishme të mbahet parasysh fakti që ai lidhet pazgjidhshmërisht me një parim të përgjithshëm me karakter kushtetues, atë të **barazisë** së trajtimit dhe të mbrojtjes së saj.

Krahas parimit të barazisë, në ligj parashikohet edhe diskriminimi ose dallimi në rastet kur përligjet si arsyeshëm dhe objektiv. Në rastet kur diskriminimi apo dallimi është i pabazuar në ligj, apo në kundërshtim me ligjin, pra kur nuk përligjet si i arsyeshëm dhe objektiv atëherë ai konsiderohet si diskriminim i padrejtë.

Cilin do të konsiderojmë diskriminim të arsyeshëm dhe cilin të padrejtë?

1. Nxënësit duhet të ndërgjegjësohen se diskriminime në kuptimin e dallimeve apo preferencave ndodhin gjithmonë e në çdo hap të jetës tonë e megjithatë jo gjithmonë ato përbëjnë shkelje nga pikëpamja e

ligjit kushtetues. Për shembull, dallimet, përjashtimet ose preferencat e bazuara në cilësitë e kërkuara për një vend pune të caktuar, për shembull pilot, shofer etj, nuk konsiderohen si shkelje e të drejtave. Po kështu, diskriminimi që ndalon fëmijët nën moshën 14-16 vjeç për të parë disa lloje filmash konsiderohet si diskriminim i arsyeshëm.

2. Duke trajtuar rastin që është objekt i këtij aktiviteti është e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë se barazi nuk do të thotë thjesht mungesë diskriminimi. Madje vet koncepti i barazisë përmban me një dilemë të brendshme:

- Si mundet që një individ apo një grup njerëzish të gëzojnë më shumë barazi pa shkaktuar të tjerët privime lidhur me gëzimin e saj?
- Në ç'mënyrë veprimet që synojnë të venë në vend drejtësinë apo barazinë e munguar për shkak të një diskriminimi të mëparshëm të mos shkaktojnë diskriminim të ri të njerëz të tjerë, të pafajshëm?

3. Në diskutimin përfundimtar mund të qendrohet dhe diskutohen pasojat komplekse, sociale, morale, ekonomike dhe psikologjike të rastit konkret apo të rasteve të tjera të zgjedhura nga nxënësit.

Nxënësve mund t'u bëhen pyetjet e mëposhtme:

- Cilat mund të ishin pasojat e cilit nga grupet e nxënësve (studentëve) të prekur nga politika konkrete?
- Cilat mund të ishin pasojat morale, sociale, ekonomike etj të politikës në fjalë?

E rëndësishme është që gjatë diskutimit t'i kushtohet më shumë rëndësi mendimeve dhe qëndrimeve të nxënësve dhe vetëm interpretimeve ligjore që mund të kenë efekte frenuese të ta.

Kujtesë.

Prania e mundshme në klasë e nxënësve që rrjedhin nga familje që në të kaluarën kanë vuajtur diskriminim kërkon nga mësuesi që të bëjë kujdes për të parandaluar lindjen e konflikteve të mundshme midis nxënësve.

Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë

- të shpjegojë diskriminimin në ligj
- të gjykojë rreth drejtësisë apo padrejtësisë së një diskriminimi të veçantë
- të mbrojë me argumente një qëndrim të caktuar lidhur me diskriminimin

Koha: 45'

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë

Fillimisht nxënësit lexojnë individualisht tekstin dhe materialin që kanë në librin e tyre.

Pas kësaj mësuesi shkurtimisht u shpjegon lojën me role që kërkohet prej tyre:

Nxënësit ndahen në **dy grupe të mëdha**, që përfaqësojnë secili njërin nga qëndrimet e kundërta. Brenda grupit ata mund të punojnë me grupe më të vogla me nga dy-tre veta. Grupet duhet të zhvillojnë argumentet për qëndrimet e tyre të cilat do të duhet t'i paraqesin në seancën tjetër përpara “kryesisë” e cila përbëhet prej tre-katër vetash. Për këtë, ata edhe mund të zgjedhin një kryetar që do t'i përfaqësojë.

Hapi i dytë

Nxënësit diskutojnë fillimisht në grupe të vogla dhe bien dakord për argumentet që do të përdorin. Kryetari i grupit duhet të lëvizë nëpër grupe për t'i mbledhur ato dhe për të përpunuar mendimin e të gjithë grupit.

Hapi i tretë

Kryetari i organit drejtues fton përfaqësuesin e secilit grup për të bërë paraqitjen e pikëpamjeve të tyre. Ndërkohë pjesa tjetër mund të luajë rolin e vëzhguesit.

Hapi i katërt

Diskutim i përgjithshëm lidhur me çështjet dhe pikëpamjet e parashtruara.

Veprimtaria 3: Diskriminimi i arsyeshëm apo i padrejtë?

Fleta e punës së nxënësit

Në periudhën 1992 - 1995, rregulli i përgjithshëm për të vazhduar studimet e larta ishte pjesëmarrja e domosdoshme në konkursin e pranimit dhe arritja e një niveli të caktuar pikësh që varej nga numri dhe cilësia e pjesëmarrësve.

Në këtë periudhë, një numër i caktuar nxënësish, me vendim të Këshillit të Ministrave, fituan të drejtën të hynë në shkollën e lartë pa u nënshtruar rregullit të konkursit. Këta nxënës rridhnin nga familje që kanë vuajtur persekutimin politik dhe janë diskriminuar gjatë regjimit totalitar.

Kjo bëri që numri i nxënësve që do të zgjidheshin për të hyrë në shkollën e lartë përmes konkursit të ishte më i vogël.

Në vendin tonë, në të cilin, në të kaluarën, një pjesë e njerëzve janë diskriminuar janë bërë e bëhen përpjekje për të vënë në vend drejtësinë dhe barazinë e munguar nëpërmjet disa vendimeve apo veprimeve të cilat në thelb favorizojnë disa për shkak të diskriminimit të sipërpërmendur. Kjo realizohet nëpërmjet prioriteteve në punësim, në të drejta studimi, në privatizime etj.

Qëndrimet ndaj politikave të tilla kanë qenë kontradiktore!

Ata që i mbështesin, i argumentojnë ato të domosdoshme për të mundësuar zbutjen e pasojave të diskriminimit të së kaluarës dhe për të shtuar shpresën e atyre që nuk e kanë pasur atë.

Ata që janë kundër i vlerësojnë qëndrime të tilla si një tjetër formë e diskriminimit të padrejtë që do të çonte në pasoja negative në plan social, moral, ekonomik dhe psikologjik.

Pyetje

- A e mbështesni ju politikën e favorizimit të familjeve të persekutuar ose të diskriminuara në të kaluarën? Jepni argumente për qëndrimin tuaj.
- Nëse jo argumentoni qëndrimin tuaj. A mund të konsiderohen veprime të tilla një formë e re diskriminimi? Pse?

Ç'është diskriminimi ?

Shumë ligje diskriminojnë. Ata e bëjnë këtë duke dalluar dhe klasifikuar njerëzit në grupe të ndryshme.

Diskriminimi është rrjedhojë e pashmangshme e bërjes së ligjeve.

Jo të gjitha diskriminimet janë antiligjore. Për sa kohë dallimet dhe ndarjet janë të arsyeshme ato zakonisht nuk përbëjnë shkelje të së drejtës së mbrojtjes së barabartë. Në këto raste diskriminimi quhet i arsyeshëm.

Për shembull ligji nuk lejon dhënien e licencës për të ngarë makinën nën moshën 18 vjeç.

Po kështu, sipas ligjit, lejen për t'u martuar e kanë meshkujt që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe femrat që kanë mbushur moshën 16 vjeç. Kjo do të thotë se vetë ligji në rastet e mësipërme diskriminon personat që nuk kanë mbushur moshën 16 dhe 18 vjeç (sipas rastit). Por në këtë rast nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një diskriminim antikushtetues. Arsyeja e ligjeve të mësipërme qëndron në faktin e aftësisë për të marrë përsipër përgjegjësi të caktuara (për të ngritur familje), pra ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis dallimit (diskriminimit) dhe qëllimit të ligjit.

Provoni veten!

- I. Më poshtë janë dhënë disa shembuj diskriminimesh. Vendosni se cili prej tyre është diskriminim i arsyeshëm dhe duhet lejuar dhe cili nuk është i arsyeshëm (është i padrejtë) dhe duhet ndaluar. Argumentoni qëndrimet tuaja.
1. Në regjimin e kaluar fëmijët e drejtuesve të lartë të partisë, shtetit dhe të heronjve të punës etj pranoheshin në shkollë të lartë me mesatare më të ulët note.
2. Fëmijët e punëtorëve kishin prioritet në të drejta studimi dhe në vende pune në raport me fëmijët e ish të pasurve.
3. Ligji për shërbimin ushtarak parashikon shërbimin e detyruar ushtarak vetëm për meshkujt që kanë mbushur moshën 18 vjeç por jo për femrat.
4. President i RSH mund të zgjidhet vetëm shtetas shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

II. Jepni shembuj të tjerë diskriminimi.

Shkruani një ese të shkurtër me temë:

Një rast që më bëri të mendoj për diskriminimin...

Veprimtaria 4. Kioskat.

Objektivat.

Në fund të zhvillimit të këtij aktiviteti nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë qëllimet e një ligji konkret;
- të evidentojë vlerat që qëndrojnë në themel të një ligji;
- të diskutojë për rëndësinë e zbatimit të ligjit;
- të diskutojë për pasojat që shoqërojnë zbatimin apo moszbatimin e ligjit;
- të demonstrojë angazhimin e tij në respektimin e ligjit.

Zhvillimi i mësimit

1.

Në fillim mësuesi i njeh nxënësit shkurtimisht me vendimin dhe veprimin e Bashkisë së Tiranës për të prishur kioskat në qendër të qytetit. Pasi shkruan në tabelë pyetjen:

A duhet të prisheshin kioskat?

Mësuesi kërkon nga nxënësit të pozicionohen lidhur me këtë veprim me anë të ngritjes së dorës. Pas kësaj ai i fton nxënësit të ndahen në dy grupe të mëdha sipas përgjigjes pro apo kundër dhe kërkon nga disa prej tyre, shkurt të justifikojnë qëndrimin e tyre.

2.

Mësuesi u kërkon nxënësve që pasi të lexojnë shkrimin me titull “Kioskat” të plotësojnë kolonat që kanë në tekst.

Grupi që është kundër prishjes së kioskave do t’i përgjigjet pyetjeve nën titullin **“Kioskat nuk duhet të hiqen nga qendra e Tiranës”**, ndërsa grupi që është pro prishjes duhet t’i përgjigjet pyetjeve të kolonës me titull **“Kioskat duhet të hiqen nga qendra e Tiranës”**.

Nxënësit duhet të lexojnë fillimisht në mënyrë individuale e më pas të dalin me një përgjigje grupi lidhur me pyetjen “A duhet të hiqen kioskat apo jo?”

Procedura.

1. Hyrje 5-7’

1. Veprimtari në grup 25’

2. Reflektim 12-15’’

Ky aktivitet synon të evidentojë dhe përgjithësojë përmes një shembulli konkret disa nga idetë kryesore të kapitullit të parë dhe pikërisht ato që kanë të bëjnë me:

- Funksionet dhe qëllimet e ligjit
- Vlerat që qëndrojnë në themel të ligjit
- Lidhjen e ligjit me prioritetet e kohës si në fushën e hartimit ashtu dhe në atë të zbatimit.
- Zbatimi dhe moszbatimi i ligjit sjell rrjedhoja që prekin si individët ashtu edhe shoqërinë.
-

Pasi përfaqësuesit e grupeve prezantojnë dhe argumentojnë qëndrimin e tyre mësuesi pyet nëse ndonjë nga nxënësit ka ndryshuar qëndrimin e tij pas zhvillimit të pyetjeve. Ai fton këta nxënës të kalojnë në grupin tjetër dhe të justifikojnë ndryshimin e qëndrimit të tyre.

3.

Në këtë fazë mësuesi fton nxënësit të diskutojnë rreth çështjeve të mëposhtme:

- Cili është qëllimi i ligjit që ndalon ndërtimet pa leje?
- Cilat janë vlerat që qëndrojnë në themel të këtij ligji?
- Cilat janë pasojat e afërta dhe të largëta të:
- zbatimit të ligjit për shoqërinë dhe për individët
- moszbatimit të ligjit për shoqërinë dhe për individët.
- A mendoni se ky ligj është zbatuar në kohën e duhur?
- Cilat mund të jenë pasojat nëse një ligj
- nuk hartohet në kohën e duhur?
- nuk zbatohet në kohën e duhur?
- Cili do të ishte ligji që do të propozonit ju?

- Ne jemi njëkohësisht përgjegjës dhe viktimë të zbatimit apo moszbatimit të ligjit.
- E rëndësishme është që nxënësit të jenë të aftë jo vetëm të identifikojnë funksionet apo vlerat e ligjit por edhe të demonstrojnë përgjegjësinë e tyre ndaj zbatimit të tij e për më tepër, ata të jenë të aftë të ndryshojnë sjelljet apo qëndrimet e tyre nëse e kundërta nuk mund të mbrohet me argumente.
- Do të ishte dhe do të jetë sukses nëse nxënësi do të arrijë ta shohë ndryshimin e pikëpamjes apo qëndrimit të tij jo si humbje personale por si diçka normale dhe të natyrshme në rrugën e zhvillimit.

Në Janar të vitit 1999, Bashkia e Tiranës ndërmori një fushatë për heqjen e kioskave, të ndërtuara pa leje, nga mjediset dhe parqet qendrore të Qytetit.

Një pjesë e njerëzve e përshëndetën këtë vendim dhe veprim të Bashkisë, me argumentin që, më së fundi, qyteti i Tiranës dhe veçanërisht qendra e tij do të rifitonin hapësirën dhe gjelbërimin e mëparshëm në shërbim të publikut, duke u pastruar nga kafenetë, lojërat e fatit, e madje edhe nga ËC të improvizuara në qendër të qytetit. Në të njëjtën kohë, një pjesë tjetër e njerëzve ishin të shqetësuar për fatin e aktivitetit ekonomik të kioskave që lidhej me punësimin dhe plotësimin e nevojave ekonomike të një pjese të popullsisë në një kohë që qeveria nuk kishte mundësi të ofronte alternativa të tjera punësimi për ta.

Me mijëra familje janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e kioskave, të cilat u zhvilluan në një kohë shumë të shkurtër dhe të çrregullt pas ndryshimit të regjimit. Kioskat në një farë mënyre plotësonin mungesën e supermarketeve dhe shërbenin për të plotësuar edhe nevojat e popullsisë së Tiranës dhe shërbime më të mira.

Në të njëjtën kohë mjaft pronarë i zëvendësuan kioskat e ndërtuara me material të lehtë si dru ose metal me ndërtime të qëndrueshme betoni deri në tre kate duke krijuar probleme të vërteta urbane. Përveç kësaj shumë janë të frikësuar për qëndrueshmërinë e këtyre godinave për shkak të themeleve jo të përshtatshme.

Problemi i kioskave në qendër të Tiranës përbën vetëm një pjesë të problemit të ndërtimeve pa leje në kryeqytet. Që nga viti 1992 Tirana ka pësuar ndryshime të ndjeshme si në numrin e popullsisë e cila është më shumë se e dyfishuar si rezultat i migrimit të brendshëm ashtu dhe në fushën e ndërtimeve veçanërisht në disa zona në periferi të saj, ku janë ngritur qyteza të vërteta.

Nga ana tjetër një numër i madh emigrantësh shqiptarë janë kthyer nga vendet ku kanë punuar dhe kanë ndërtuar banesa të cilat shpesh përmbajnë edhe dyqane apo veprimtari të tjera. Por shumë prej tyre i ndërtuan shtëpitë pa marrë fillimisht lejen e ndërtimit e cila nga ana e saj, në shumë raste, prekte interesa të pazgjidhura të pronarëve të tokës apo të pretenduesve të saj. Këtu duhen përmendur edhe vonesat për arsye objektive apo subjektive të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve

nga ana e ligjit dhe organeve gjyqësore, për të cilat flitet dhe ekziston opiniononi që janë të korruptuara në shkallë të konsiderueshme.

Shumë banorë të Tiranës ankohen për kaosin dhe zhvillimin jo të rregullt urban të qytetit duke e parë këtë edhe si mungesë efektiviteti të qeverisjes lokale, ndërsa të tjerë pohojnë që një ndër prioritetet e qeverisë pas ndryshimit të regjimit ka qënë zhvillimi i tregut të lirë për inkurajimin e tregtisë. Në fakt, Tirana në vitin 1992 kishte nevojë urgjente për të hapur vende pune të reja e të hidhte themelet e tregtisë dhe të funksionimit të ekonomisë. Nga kjo pikëpamje zhvillimi i kioskave duket se luajti rol, ndonëse jo esencial në rimëkëmbjen e ekonomisë. Por 7 vjet më vonë prioritetet ndryshuan. Qeveria po përpiqet të rifitojë hapësirat publike që humbi në vitet e mëparshme duke shpresuar të rritë cilësinë e jetës në qytet.

Megjithatë, duket se është e pamundur që të rrëzosh apo heqësh më shumë se 4000 ndërtime të paligjshme në gjithë qytetin e Tiranës. Më e vështirë do të jetë heqja e kioskave që ndodhen në Parkun Rinia përballë Hotel Dajtit si dhe ndërtimet përgjatë Lanës, një pjesë e të cilave u përkasin biznesmenëve të rëndësishme e me influencë.

Bashkia ende nuk ka marrë një vendim lidhur me ndërtimet buzë Lanës e cila në gjatësinë më të madhe të saj është e mbushur me ndërtime. Ndërkohë dihet që Lana shërben për derdhjen e ujërave të zeza të shumë zonave të Tiranës.

Bashkia, deri tani duket se ka ndërmend të prishë një pjesë të ndërtimeve, ato që ndodhen pranë bulevardit kryesor por ka të ngjarë që ajo të tolerojë të tjerat që ndodhen më larg këtij bulevardi.

Kioskat

Duke u mbështetur në shkrimin e mësipërm

A duhet të hiqeshin kioskat nga qendra e Tiranës?

Kioskat duhet të hiqen nga qendra e Tiranës	Kioskat nuk duhet të hiqen nga qendra e Tiranës
1. Argumentet 	1. Argumentet
2. Cilat janë pasojat ekonomike dhe sociale të heqjes së kioskave? 	2. A e di se ekziston një ligj që ndalon ndërtimet pa leje, dhe a mendoni se ndërtimi i kioskave është veprim i kundërligjshëm?
3. A mendon se pasojat e sipërpërmendura duhet të merreshin parasysh përpara se të zbatohet vendimi kundër ndërtimeve pa leje? 	3. A e di se ligji që ndalon ndërtimet pa leje ka ekzistuar edhe në kohën e ndërtimit të kioskave? A mendon që pronarët e tyre duhet t'i kishin marrë parasysh pasojat e ardhshme?

[illegible]

- pronarët e kioskave

- mjedisin publik në Tiranë

zhvillimin urbanistik të qytetit

- qëndrimin ndaj ligjit

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines, typical of notebook paper. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

[illegible]

[illegible]

7. Çfarë ka ndryshuar në realitetin shqiptar që të justifikojë këtë qëndrim?

8. A duhet të zbatohet ky ligj?

PO

JO

7. A mendoni se duhet të ekzistojë ky ligj?

8. A duhet të zbatohet ky ligj?

PO

JO

Pra, a duhet të hiqen kioskat?

Veprimtari që lidhet me edukimin mjedisor

Tema: Prodhimet e pyjeve tropikale

Kjo veprimtari synon të nxisë rritjen e vetëdijes së nxënësve për disa nga çështjet që lidhen me përdorimin e pyjeve tropikale dhe të ndihmojë ata të reflektojnë për pasojat e përdorimit të tyre për kombe, shtresa dhe grupime të ndryshme të shoqërisë në botë.

Nga ana tjetër kjo është një veprimtari që aftëson nxënësit të arrijnë marrëveshje si dhe të marrin pjesë në diskutime dhe ndarje mendimesh dhe qëndrimesh personale. Po kështu nxënësve u jepet mundësia të shprehin qëndrimet dhe vlerat e tyre lidhur me çështjet në diskutim.

Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë disa prej produkteve të pyjeve tropikale dhe përdorimeve të tyre në botën e sotme;
- Të reflektojnë për disa prej çështjeve komplekse që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e disa prej produkteve të pyjeve tropikale;
- Të mbajnë qëndrimin e tyre lidhur me shkallën e pranimiit dhe të mospranimiit të disa prej përdorimeve të produkteve të pyjeve tropikale;
- Të reflektojnë për përgjegjësitë qytetare kombëtare dhe globale lidhur me përdorimin e mjedisit si një çështje e të drejtave të njeriut.

Materiale

Ngjitës, kartat me prodhimet e pyjeve tropikale dhe disa prej përdorimeve të tyre, nga një set për çdo çift nxënësish, tabakë të mëdhenj letre.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë

Nxënësit të ndarë në çifte pajisen me nga një set të kartave që përmbajnë prodhimet dhe përdorimet e produkteve të pyjeve tropikale.

Në tabakun e letrës çifti vizaton një vijë të drejtë në skajet e së cilës ndodhen pohimet “pranoj plotësisht” dhe “nuk e pranoj aspak”.

Në fillim nxënësit duhet të bien dakord për pranueshmërinë dhe për papranueshmërinë e përdorimeve të produkteve të pyjeve tropikale. Ata bien dakord edhe për vendosjen e një vije ndarëse ndërmjet skajeve që ndan përdorimet e pranueshme nga të papranueshmet. Pas kësaj ata duhet të vendosin pohimet (kartat) përgjatë vijës ndërmjet dy skajeve sipas shkallës së pranueshmërisë ose të të papranueshmërisë së përdorimit të produkteve të pyjeve.

Hapi i dytë

Në këtë fazë tri çifte formojnë një grup. Në fillim çdo çift duhet të shpjegojë dhe të justifikojë zgjidhjen e tij në hapin e parë. Më pas, të gjithë anëtarët e grupit duhet të bien dakord për vendosjen e kartave në vijën e kontinuitetit (ndërmjet dy skajeve). Në fund ata diskutojnë dhe vendosin për vijën që ndan të pranueshmet nga të papranueshmet.

Hapi i tretë

Grupet bëjnë të njohur përfundimet e tyre dhe mësuesi ose drejtuesi fton nxënësit në diskutim rreth veprimtarive njerëzore që shfrytëzojnë produktet e pyjeve tropikale që në shkallë të ndryshme shkatërrojnë botën e pyjeve duke ndikuar kështu edhe në ekosistemin e tyre kompleks. Këtu mësuesi mund të përdorë edhe konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm duke lidhur atë me hapat e rëndësishëm praktikë që duhet të ndërmerren për të shpëtuar atë çfarë ka mbetur, për shembull duke ricikluar letrën, duke mos blerë kafshë të rralla të pyjeve tropikale etj.

Po kështu mësuesi mund të trajtojë edhe çështjen se kush përfiton nga shfrytëzimi i përdorimit të produkteve të pyjeve tropikale. Është mirë që mësuesi t’u japë mundësi nxënësve të identifikojnë përfitues të ndryshëm të burimeve të pyjeve tropikale në mënyrë që nxënësit të mund të japin argumente të shumta për pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Mësuesi duhet të lidhë nevojën për mbrojtjen e mjedisit me të drejtën e njeriut për një mjedis të shëndetshëm dhe për nevojën e veprimit të përbashkët për krijimin e kushteve të domosdoshme për respektimin e kësaj të drejte.

Mësuesi mund të pyesë nxënësit se si u ndjenë në pozicionin e atyre që marrin vendime, se cilat veprimtari do të quhen të pranueshme dhe cilat të papranueshme. Këtu ai mund të hapë një diskutim për çështjen se kush duhet të marrë vendime për fatin e njerëzimit dhe a kanë njerëzit ose popujt e botës mundësi të marrin vendim për fatin e tyre apo të tjerët të marrin vendime për ta? Këtu është vendi që të trajtohen edhe kriteret mbi bazën e të cilave merren këto vendime. A janë kriteret të pranuar njësoj nga të gjithë?

Fleta e punës për nxënësit

(kartat me përdorimet e produkteve të pyjeve tropikale)

Drutë e zjarrit Një e treta e popullsisë së botës përdor drutë për ngrohje dhe gatim. Në vendet më të varfra të botës pjesa më e madhe e druve të mbledhura përdoret për prodhimin e energjive të ndryshme.	Blegtoria Sipërfaqe të mëdha pyjesh tropikale shpyllëzohen për të mundësuar ushqimin e blegtorisë. Pjesa më e madhe e mishit që sigurohet prej tyre përdoret për hamburger në vendet e pasura.
Barnat mjekësore Shumë barna mjekësore kanë në bazë lëndë të parë të prodhuara nga drurë pyjesh tropikale. Për shembull, kinina që përdoret për mjekimin e sëmundjes së malaries prodhohet nga një lëkurë e një peme.	Letra Bota përdor sasi të mëdha druri (rreth katër miliardë pemë çdo vit) për prodhimin e letrës. Për shembull vetëm një numër i gazetës amerikane Neë York Times kërkon drurët e 400 ha pyje.
Kërkimet mjekësore Kompanitë e mëdha farmaceutike studiojnë me mijëra lloje drurësh që përdoren në mjekësi nga banorët vendas në shumë vende. Disa prej tyre mund të kurojë sëmundje të tilla si kanceri.	Kafshët shtëpiake Zogjtë e pyllit tropikal, si papagalli etj shiten dhe mbahen në kafaze në vendet perëndimore.

Ushqimi Shumë nga ushqimet më të përdorshme si kafeja, kakao, orizi etj., e kanë origjinën nga pyjet tropikale. Gjetet nga këto bimë të egra kërkohen ende për mjekimin e sëmundjeve.	Lëkurat Lëkura e shume kafshëve të egra si macet, jaguarët etj. përdoren për të prodhuar gëzofë të shtrenjtë për zonjat e pasura të botës. Për të prodhuar një gëzof të tillë shpesh herë përdoret lëkura e dhjetë kafshëve.
Drurët e zbukurimit Shumë drurë të pyjeve tropikale përdoren për të prodhuar mobilie të cilësisë së lartë, dritare, anije dhe vegla muzikore.	Nxjerrja e mineraleve Minerale të shumta si ari, alumin etj janë gjetur në pyjet tropikale. Nga ana tjetër nxjerrja e mineraleve shkakton dëme të mëdha tokës dhe mjedisit.
Elektriciteti Më tepër se 30 hidrocentrale ndodhen në lumin Amazona gjë që ka përmbytur sipërfaqe të madha të pyjeve tropikale.	Transporti Industritë për nxjerrjen e mineraleve, për përpunimin e drurëve të pyllit etj, kërkojnë ndërtimin e rrugëve dhe të hekurudhave prej mijëra kilometrash në pyjet tropikale.

Veprimtari: Edukim global

Tema: Linjat e së ardhmes

Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të parashikojnë dhe të projektojnë të ardhmen e tyre personale dhe shoqërore;
- të reflektojnë për marrëdhëniet ndërmjet faktorëve të ndryshëm që kushtëzojnë jetën tonë personale dhe atë shoqërore në të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen;
- Të projektojnë të ardhmen e tyre dhe të diskutojnë për rrugët e ndryshme të realizimit të saj;


- Të diskutojnë për përgjegjësinë qytetare të nxënësve për realizimin e një bote më të mirë dhe më të drejtë në përputhje me vlerat dhe parimet e demokracisë.

Materiale: tabakë të mëdhenj letre dhe lapsa me ngjyra për çdo çift nxënësish

Procedura

Hapi I

Mësuesi pasi vizaton në tabelë linjat e kohës



Pika A përfaqëson të kaluarën ndërsa pika B përfaqëson të tashmen. Drejtëza AB përfaqëson jetën personale nga e kaluara deri në të tashmen. Drejtëza BJP përfaqëson të ardhmen personale të individit kurse drejtëza BJS përfaqëson jetën shoqërore nga e tashmja në të ardhmen.

Nxënësit duke punuar në çifte plotësojnë në një tabak të madh letre pjesët e vijave si më poshtë:

Nxënësit zgjedhin çastet ose ngjarjet më të rëndësishme të jetës së tyre, ato ngjarje që kanë përcaktuar edhe vijën e jetës së tyre. Ata i vendosin ato në mbi vijën AB. Po kështu ata kujtojnë ngjarjet më të rëndësishme shoqërore që kanë në ndikuar jetën e tyre dhe i rreshtojnë poshtë vijës AB. Nxënësit i plotësojnë ato duke përdorur ngjyra të ndryshme për ngjarjet e tyre personale.

Pas kësaj nxënësit në vijën BJP vendosin duke përdorur ngjyrat e tyre personale projektet e tyre për 50 vjetët e ardhshme. Në vijën BJS ata vendosin ngjarjet kryesore që ata mendojnë se do të ndodhin në të ardhmen 50 vjeçare në nivel lokal, kombëtar ose global. Pasi bëjnë këtë çiftet duhet të përcaktojnë nëse ka, marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet të ardhmes personale dhe asaj shoqërore. Pra a do të ndikojë e ardhmja e projektuar shoqërore në të ardhmen e tyre personale dhe anasjelltas? Për të treguar këtë lidhje nxënësit duke përdorur ngjyra të veçantë tregojnë me shigjeta që nisen nga vija e JS drejt vijës së JP, lidhjet ndërmjet ngjarjeve të jetës shoqërore dhe atyre të jetës private. Shigjetat shoqërohen me shpjegime të shkurtra për marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Pasi çiftet përfundojnë punën kalohet në diskutim me të gjithë klasën për çështjet e mëposhtme:

- A mendoni se ekzistojnë lidhje ndërmjet ngjarjeve të jetës personale nga e kaluara në të tashmen dhe atyre të jetës shoqërore?
- Si ndikojnë ngjarjet shoqërore në ngjarjet e jetës private?
- A mendoni se ndikojnë ngjarjet e jetës personale në ato shoqërore?
- Ku i mbështesni projektet e jetës personale në të ardhmen?
- A kanë lidhje ato me ngjarjet e sa kaluarës dhe të së sotmes? Në ç'drejtime?
- Po ngjarjet shoqërore të së ardhmes, a lidhen me të sotmen dhe me mundësitë që krijon ajo apo janë krejtësisht të shkëputura?
- A varet e ardhmja jonë personale dhe ajo shoqërore nga kontributi dhe nga veprimtaria jonë e sotme?
- Çfarë detyrimesh shoqërore lindin para nesh për të përmirësuar jetën tonë personale dhe atë shoqërore?


Varianti 2

AM

K

AD

S



Drejtëza KS përfaqëson jetën, ngjarjet kryesore personale dhe shoqërore nga e kaluara në të sotmen.

Drejtëza SAM përfaqëson të ardhmen e mundshme kurse drejtëza SAD përfaqëson të ardhmen e dëshiruar.

Si në variantin e mësipërm nxënësit në fillim individualisht dhe më pas në çifte plotësojnë:

- në vijën KS ngjarjet kryesore të jetës personale dhe shoqërore
- në vijën SAM ngjarjet që mund të ndodhin në një të ardhme të mundshme
- në vijën SAD ngjarjet që ata do të dëshironin të ndodhnin pavarësisht nga mundësia reale e ndodhjes së tyre.

Pasi nxënësit të kenë plotësuar vijat mësuesi i fton disa prej çifteve t'i bëjnë të njohur klasës përfundimet e punës së tyre.

Pas kësaj ai i fton nxënësit të diskutojnë çështjet e mëposhtme:

- Cilat janë faktorët që mendoni se kanë ndikuar në ngjarjet e jetës suaj personale në të kaluarën dhe të sotmen? Po nga ngjarjet shoqërore?
- Në çfarë shkalle mendoni se jeta e sotme është rrjedhojë e jetës personale dhe shoqërore të së kaluarës?
- Cilët janë faktorët që keni marrë parasysh kur ndërtuat të ardhmen e mundshme. Pse mendoni se ajo është një e ardhme që mund të ndodhë?
- Pse e ardhmja e dëshirueshme nuk është e mundur? Cilët janë faktorët që e pengojnë atë të bëhet e mundshme për t'u realizuar?
- Çfarë duhet të bëjmë për të afruar të ardhmet? Cila është përgjegjësia jonë qytetare për të krijuar një të ardhme sa më të pëlqyeshme për të gjithë?

Kujtesë

Varianti i parë synon të ndihmojnë nxënësit të parashikojnë dhe të projektojnë të ardhmen e tyre personale dhe shoqërore dhe ajo që është më e rëndësishme është që i përfshin ata në një proces të të menduarit kritik dhe të reflektimit për marrëdhëniet ndërmjet faktorëve të ndryshëm

që kushtëzojnë jetën tonë personale dhe atë shoqërore në të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen. Po kështu i rëndësishëm është edhe reflektimi për marrëdhëniet që ka e ardhmja në të gjitha nivelet e saj me të sotmen, madje edhe me të kaluarën tonë. Nxënësit në këtë mënyrë ftohen të identifikojnë faktorët e shumtë social, ekonomik, personal etj që ndikojnë në krijimin e të ardhmes së tyre. Për këtë arsye mësuesi u kërkon atyre të eksplorojnë pse ata kanë shpresa të përbashkëta për të ardhmen personale si dhe për faktorët e shumtë lokal, kombëtar ose global që mund të ndihmojnë, të pengojnë ose të ndryshojnë realizimin e shpresave të tyre për të ardhmen.

Varianti i dytë jep mundësi nxënësve që duke projektuar të ardhmen e dëshiruar të diskutojnë edhe për vlerat e tyre. Po kështu përmes njohjes me disa nga përfundimet e nxënësve për të ardhmen e dëshiruar krijohet mundësia që të diskutohen rrugë të ndryshme për realizimin e tyre. Në këtë mënyrë diskutimi krijon edhe mundësinë për të diskutuar për përgjegjësinë qytetare të nxënësve për realizimin e një bote më të mirë dhe më të drejtë në përputhje me vlerat dhe parimet e demokracisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

LËNDA: HISTORI

TIRANË, 2010

PËRMBAJTJA

Thënie të ndryshme

1. Rëndësia e historisë në kurrikulën e re të gjimnazit

1.1 Synimet e kurrikulës së re

1.2 Fusha dhe përmbajtja

1.3 Zhvillimi i aftësive

1.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e Historisë me lëndët e tjera

1.5 Objektivat e arritjes

1.6 Objektivat specifike të arritjes në kurrikulën bërthamë të lëndës Histori

2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës

3. Vlerësimi i nxënësit

4. Shtojcë

Historia është dëshmitarja e kohëve, drita e së vërtetës, mësuesja e jetës, lajmëtarja e lashtësisë.

Ciceroni

Të mos dimë se çfarë ngjarjesh kanë ndodhur para nesh, është njëlloj sikur të mbetemi gjithmonë fëmijë.

Ciceroni

Historia është kullimi për shekuj të tërë i një personaliteti kolektiv.

Fernand Braudel

Historia është një funksion i rëndësishëm i jetës, në të cilin ajo nuk mban vetëm lidhje me të kaluarën, por në aspektin e plotkuptimshmërisë së jetës ajo mbart gjithashtu lidhje me të ardhmen. Ajo është një gjë që i shkon përkrah jetës, një forcë që formohet pa pushim në të.

Teodor Lit

Duke lexuar të kaluarën, mund t'i përgjigjemi së tashmes dhe të parashikojmë të ardhmen.

Ciceroni

Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi kurrikular i lëndës Histori është një material ndihmës për përdoruesit e kurrikulës, dhe veçanërisht për mësuesit e gjimnazit të cilët zhvillojnë lëndën e Historisë. Ky udhëzues ndihmon mësuesit në zbatimin e programeve mësimore të kësaj lënde dhe sugjeron metoda të suksesshme të mësimdhënies dhe të nxënës.

Udhëzuesi shërben si nxitës i përmirësimit të përvojave të deritanishme të mësimdhënies. Ai i fton mësuesit të mendojnë rreth të nxënës aktiv, kurrikulës së hapur dhe fleksibël, lidhjes ndërlëndore, duke i lënë vendin e duhur si lirisë akademike të tyre, ashtu dhe krijimtariisë dhe artit të të mësuarit. Në kushtet e përdorimit të teksteve alternativë, ky udhëzues nuk i shërben punës së mësuesit me një tekst, ai përpiqet të qëndrojë mbi to duke i dhënë peshë dhe vlerë asaj çka planifikon dhe organizon çdo ditë mësuesi në lëndën e tij, me nxënësit dhe mjedisin ku operon.

Duke shpresuar që ky udhëzues të bëhet një libër tryeze për mësuesit e kësaj lënde në gjimnaz, mirëpresim dhe falenderojmë çdo përdorues të tij që bën sugjerime në drejtim të përmirësimit të tij.

1. RËNDËSIA E HISTORISË NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

Historia është shkencë humane që merret me studimin e jetës dhe veprimtarisë së popujve, përvojave dhe kontributeve të tyre në zhvillimin e shoqërisë, që nga lindja e njerëzimit deri sot.

Kultura historike i ndihmon nxënësit për të kuptuar se si ka qenë e organizuar shoqëria në të kaluarën, si ka funksionuar dhe si ajo ka evoluar deri sot.

Pa historinë, shoqëria njerëzore do ta kishte të vështirë t'u përgjigjej pyetjeve të tilla si:

si ka qenë?, ku ka ndodhur?, si ka ndryshuar?, cilat janë shkaqet e ndryshimit dhe si janë kuptuar dhe zgjidhur ngjarjet dhe dilemat historike?.

Duke u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, historia të ndihmon të kuptosh të sotmen dhe të orientohesh drejt së ardhmes.

Studimi i historisë i ndihmon nxënësit të kuptojnë kompleksitetin e çështjeve historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar, të vlerësojnë burimet historike, të njohin abuzimet historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën të “burgosurit” e saj.

Një kuptim i thellë dhe i gjerë i historisë pasuron përvojën personale të nxënësve dhe i ndihmon ata të zhvillojnë ndenjë e humanizmit. Ajo i mëson ata të luajnë rolin e tyre në jetë dhe shoqëri si ruajtës të parimeve të një shoqërie demokratike, si trashëgimtarë të kulturave të ndryshme dhe anëtarë të një bote të ndërvarur, e cila duhet të jetojë në harmoni, duke respektuar identitetin e secilit.

Kurrikula bërthamë e lëndës së Historisë në gjimnaz është strukturuar në dy blloqe të mëdha: Historia e Qytetërimit Botëror që zhvillohet në klasën e 10-të dhe 11-të të gjimnazit, dhe Historia e Shqiptarëve e cila zhvillohet në klasën e 12-të të gjimnazit.

1.1. Synimet e kurrikulës së re

- Historia synon të njohë nxënësit me eksperiencën historike të shoqërisë, për të kuptuar më mirë jetën aktuale dhe për të qenë të aftë për të projektuar të ardhmen, duke nxitur te nxënësit të menduarin në mënyrë kritike.
- Historia synon të edukojë nxënësit me ndenjë e mirëkuptimit dhe besimit reciprok midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, shkëmbimeve të shumanshme dhe trashëgimisë.
- Historia synon të zhvillojë tek nxënësit aftësitë për të kuptuar perspektivat e ndryshimit, në një botë në ndryshim.
- Historia synon të formojë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Historia e Qytetërimit Botëror në këtë nivel shkollimi synon:

- Historia e Qytetërimeve në Antikitete dhe Mesjetë synon t'u japë nxënësve njohuri mbi *Qytetërimin Parahistorik dhe atë Antik*, duke i ndihmuar ata për të kuptuar ndikimin e këtyre qytetërimeve në qytetërimet e mëvonshme botërore.
- Historia e Qytetërimeve në Antikitete dhe Mesjetë synon të zhvillojë njohuritë e nxënësve mbi mënyrën e organizimit shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor të *Qytetërimeve në Mesjetë*, duke evidentuar tiparet e përbashkëta, veçantitë e tyre, rëndësinë dhe rolin që ato kanë, në zhvillimet e mëvonshme historike.
- Historia e Qytetërimeve Moderne dhe Bashkëkohore synon t'u japë nxënësve njohuri mbi qytetërimin evropian nga mesjeta në periudhën moderne. Ajo synon t'u zhvillojë nxënësve njohuritë mbi lëvizjet kulturore, fetare e politike, që përfshinë Evropën pas shekullit XV, si dhe ndryshimet e mëdha që ndodhën pas Luftës së Dytë Botërore deri në ditët e sotme.
- Historia e Qytetërimeve Botërore synon që nxënësit të përcaktojnë dhe vlerësojnë *vendin e Qytetërimit Shqiptar* brenda qytetërimit botëror në këto periudha.
- Historia e Qytetërimeve Botërore synon të zhvillojë aftësitë krijuese

të nxënësve nëpërmjet teknikave alternative, punëve kërkimore etj., të cilat do të realizohen përmes *veprimtarive praktike*.

Historia e Shqiptarëve në këtë nivel shkollimi synon:

- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë njohuritë për historinë e vendit, të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar veprimtarinë njerëzore në të kaluarën, të tashmen përmes zhvillimit të këndvështrimit historik për ngjarjet dhe zhvillimet e rëndësishme bashkëkohore;
- T'u japë nxënësve mundësinë të kuptojnë si përvojat e paraardhësve kanë ndikuar në botën e pasardhësve si dhe të shpjegojnë si historia e Shqipërisë ose e çështjeve të ndryshme të saj, lidhen ose qëndrojnë në kontekstin e historisë rajonale dhe botërore (konteksti ballkanik, evropian, botëror, diaspora);
- T'u ofrojë nxënësve mundësinë të bëhen të vetëdijshëm për interpretimet e ndryshme të çështjeve të veçanta historike;
- T'i aftësojë nxënësit në njohjen dhe pranimin e natyrës së dijes historike;
- Të zhvillojë tek nxënësit aftësitë e kërkimit historik dhe të punës me dëshmitë historike;
- Të zhvillojë tek nxënësit përgjegjësinë qytetare për të dhënë kontributin e tij vetjak në zhvillimin e personalitetit të tij si individ dhe si qytetar i një bashkësie.

Terminologjia kyç - konceptet

Programi përfshin një numër konceptesh bazë mbi të cilat mbështetet zhvillimi i lëndës së **Historisë së Qytetërimit Botëror** për periudhën *Parahistorike, Antike, Mesjetare, Moderne dhe Bashkëkohore* dhe **Historia e Shqiptarëve**. Përvetësimi i këtyre koncepteve ndihmon dhe aftëson nxënësit për të përvetësuar dhe realizuar objektivat dhe synimet e lëndës.

Programi i lëndës „Historia e Qytetërimeve në antikitet dhe mesjetë“ për klasën e 10-të të gjimnazit prezanton një sërë termash dhe

konceptesh kyç:

- Kështu, në linjën e parë përdoren gjerësisht koncepte të tilla, si: histori qytetërimi, qytetërim, burime, periodizim, dokumente, mjedis, paleolit, mezolit, neolit, homicid, homosapiens, epokë akullnajore, parahistori, shoqëri parahistorike etj.

- Në linjën e dytë: “Qytetërimet botërore në antikitet” (*Mijëvjeçari IV pr. K. – shek. V ps. K.*) prezantohen këta terma dhe koncepte kyç:

kodet, pushtet hyjnor, pushtet i dhuruar nga zoti, kavaleri, shpikje, shkrimi, politeizmi, henoteizmi, piramida, mumie, barbarë, koloseumi; popuj të detit, shkrim fenikas, mure ciklopike, qytet-shtet, koloni, luftë civile, oligarki, demokraci, tirani, patrikë, plebenj, skllavopronarë, gladiator, luftë punike, perandori, stil dorik, jonik e korintik, hark triumfi, obelisk, politeizëm, letërsi, filozofi, art, arkitekturë, krishterim, dyndje, migrim, krizë, shtete romane-gjermanike, “epokë e errët”, mesjetë etj.

- Në linjën e tretë “Qytetërimet botërore në mesjetë” (Shek. V – shek. XV) prezantohen këta terma dhe koncepte kyç:

trashëgimi greko-romake, ndarja e kishës, perandori, katolicizëm, ortodoksi, kod, islam, Allah, kalifat, kalif, mysliman, kuran, vend i shenjtë, agjërime, feudalizëm, feud fisnikëri, vasalitet, bujkrobëri, vasal, detyrim, qytet, luks, konflikte, shtresa shoqërore, shtet- komb, komunë, Karta e Madhe e Lirive, parlamentarizëm, monarki absolute, monarki e kufizuar, republikë, emancipim, kryqëzatë, ripushtim, sistem feudal-ushtarak, sulltan, spahi, timar, krahina të vetëqeverisura, jeniçer etj.

Në programin e lëndës “Historia e qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore” për klasën e 11-të të gjimnazit,

- në linjën “Qytetërimet në fillimet e historisë moderne” prezantohen koncepte dhe terma kyçe të tilla, si: humanizëm, rilindje, “Bota e re”, reformacion, kundërreformacion etj.
- Në linjën “Koha e ndryshimeve thelbësore” trajtohen konceptet: merkantilizëm, kapitalizëm, kolonializëm, iluminizëm, revolucion, revolucion politik, revolucion social, revolucion industrial, luftë civile, protektorat, restaurim, kompromis, kushtetutë, liri, barazi, vëllazëri, komb-shtet, liberalizëm.
- Linja “Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945) trajton konceptet demokraci, komunizëm, fashizëm, antisemitizëm, nazizëm, imperializëm, social-demokraci, racizëm, proteksionizëm, ekonomi

socialiste, krizë ekonomike, shoqëri civile, diktaturë, diktatura e proletariatit, lufta e klasave.

- Në linjën “Qytetërimet bashkëkohore” (1945 deri më sot) zhvillohen konceptet Luftë e Ftohtë, perde e Hekurt, superfuqi, bllok, detantë, dekolonizim, bashkëekzistencë paqësore, denazistifikim, çmilitarizim, komitete për të drejtat e njeriut, armë bërthamore, garë armatimesh, ekonomi mikse, globalizëm, “gllasnost”, “perestrojkë”, integrim, integrim rajonal, grup etnik, konflikt etnik etj.

Në programin e lëndës “Historia e Shqiptarëve” për klasën e 12-të të gjimnazit,

prezantohen një sërë konceptesh të cilat nxënësi duhet të jetë i aftë t’i përdorë për studimin dhe shkrimin e historisë:

- **Koncepte procedurale:** Burime dhe dëshmi, fakte dhe opinione, njëanshmëri dhe objektivitet.
- **Koncepte të interpretimit:** Ndryshimi dhe vazhdimësia, shkak dhe pasoja, krahasimi dhe kundërvënia.
- **Koncepte të përmbajtjes:** Pushteti dhe autoriteti, konflikti dhe ripajtimi, demokracia dhe të drejtat e njeriut, kultura dhe qytetërimi, ekonomia dhe shoqëria, identiteti dhe bashkësia, koha dhe hapësira.

Në numrin e madh të koncepteve të përmendura më sipër, merr rëndësi të veçantë njohja nga nxënësit e disa koncepteve historike bazë, që përdoren gjatë gjithë zhvillimit të programit mësimor si :

▪ Kuptimi kronologjik.

Nxënësi duhet të përdorë me saktësi datat, fjalorin, të vendosë ngjarjet dhe personazhet historike në periudhën përkatëse, si dhe të ndërtojë tabela kronologjike sinkronike.

▪ Shkak dhe pasoja

Nxënësi duhet të aftësohet dhe të bindet se ngjarjet historike nuk lindin dhe zhvillohen nga hiçi, apo në mënyrë kaotike, por ato kanë një lidhje të brendshme, e cila shprehet në binomin shkak-pasojë.

▪ Qytetërim

Nxënësi duhet të krijojë një përfytyrim të qartë dhe të saktë mbi konceptin qytetërim si një veprimtari shoqërore e vazhdueshme,

me vlera materiale dhe shpirtërore.

- **Diversiteti kulturor etnik dhe fetar**

Nxënësi duhet të aftësohet për të kuptuar, pranuar, vlerësuar dhe respektuar veçoritë kulturore të qytetërimeve, të besimeve dhe të etnive të ndryshme.

Ndryshimet dhe vazhdimësia

Nxënësi duhet të kuptojë dhe të shpjegojë ecurinë e qytetërimeve, veçanërisht atë nga periudha antike në atë mesjetare.

- **Interpretimi**

Nxënësi duhet të aftësohet që të interpretojë ngjarjet historike duke u mbështetur në burime historike për të vlerësuar saktësinë dhe objektivitetin e tyre.

Struktura e programit

Programi bërthamë i lëndës “Historia e Qytetërimit Botëror” që zhvillohet në dy vitet e para të gjimnazit përfshin “Historinë e Qytetërimeve në antikitet dhe në mesjetë” që zhvillohet në klasën e 10-të të gjimnazit, dhe “Historinë e Qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore” që zhvillohet në klasën e 11-të të gjimnazit.

- **Programi bërthamë i lëndës “Historia e Qytetërimeve në Antikitet dhe Mesjetë”** përfshin njohuritë e domosdoshme historike për periudhën parahistorike, antike dhe mesjetare. Ky program është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit e klasës së 10-të të gjimnazit, duke synuar studimin dhe përvetësimin e të gjitha njohurive historike që përmban ai.

Programi ka karakter përzgjedhës. Nga historia e antikitetit dhe mesjetës në rrafshin botëror, programi ka trajtuar vetëm qytetërimet që kanë dhënë kontribute të mëdha në historinë e qytetërimit botëror dhe që shprehin tipologjinë e kohës. Përvetësimi i këtij programi nga nxënësit konsiderohet i mjaftueshëm për formimin e qytetarit me kulturën e nevojshme historike në lidhje me veçoritë dhe shkallën e zhvillimit të qytetërimit antik dhe mesjetar dhe kontributin e tij në qytetërimin e sotëm botëror.

Programi shpreh risi për problematikën që ai sjell dhe mënyrën e

trajtimit, në krahasim me kurrikulën e mëparshme të arsimit të mesëm. Ai synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimeve më të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të.

Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve në lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike e historisë së qytetërimit botëror, shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë botërore, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm.

Programi krijon hapësira që i japin mundësi nxënësit për t’u përfshirë në ato fusha ku ai dëshiron të thellohet.

Programi bërthamë i lëndës “Historia e Qytetërimeve në Antikitet dhe Mesjetë” do të zhvillohet në 36 orë mësimore vjetore, prej të cilave: 26 orë njohuri të reja dhe 10 orë përpunim njohurish, pra, në raportin 70% njohuri të reja kundrejt 30% orë për përpunimin e njohurive nëpërmjet veprimtarive praktike, përsëritjeve dhe testeve.

Programi ka natyrë tematike-kronologjike dhe është strukturuar në linja dhe nënlinja, që vijnë njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera historike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zbërthimin e këtyre tematikave (linjave) në kapituj (nën linja).

Programi “Historia e Qytetërimeve në Antikitet dhe Mesjetë” është strukturuar në 3 linja që vijnë njëra pas tjetrës, secila linjë ka nënlinjat përkatëse.

Linja 1: Qytetërimi në parahistori.

Nënlinja 1.1 Historia e qytetërimit

Linja 2: Qytetërimet botërore në antikitet.

Nënlinja 2.1 Qytetërimet e hershme. (Mijëvjeçari IV – II pr. K.)

Nënlinja 2.2 Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut

Linja 3: Qytetërimet botërore në mesjetë.

Nënlinja 3.1 Qytetërimet botërore në mesjetë. (Shek. V – shek. X)

Nënlinja 3.2 Evolucion i qytetërimeve mesjetare. (Shek. X – shek XV)

Nr.	Linja	Nënlinja	Nr.orëve/ linjë
I.	Qytetërimi në parahistori	1. Historia e qytetërimit	4
II.	Qytetërimet botërore në antikitet	1. Qytetërimet e hershme. (Mijëvjeçari IV – II pr. K.) 2. Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut	16
III.	Qytetërimet botërore në mesjetë	1. Qytetërimet botërore në mesjetë. (Shek. V – shek. X) 2. Evolucion i qytetërimeve mesjetare. (Shek. X – shek XV)	16
	Totali		36

Çdo linjë ka përmbajtjet si më poshtë:

Linja 1: *Qytetërimi në parahistori*

Kjo linjë do t'i prezantojë nxënës/it,-es kuptimin dhe vlerat që ka historia e qytetërimit botëror. Nëpërmjet kësaj linje, nxënës/i,-ja do të kuptojë dhe analizojë ngjarjet historike, në lidhjet e tyre shkak pasojë, rolin që ka luajtur mjedisi në zhvillimin e qytetërimeve si dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore, që pësoi njeriu në parahistori. Ai/ajo do të kuptojë veprimtarinë e historianit në punë nëpërmjet veprimtarive praktike.

Në këtë linjë nxënës/i,-ja përmes veprimtarive praktike, mëson si ta vërë veten në pozitën e një historiani, si një eksplorues dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, si përzgjedhës, gjurmues (kërkues/hetues), vlerësues dhe parashikues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij/saj për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike. Vetëm në këtë linjë ndryshon raporti ndërmjet njohurive të reja dhe veprimtarive praktike, në favor të këtyre të fundit

Linja 2: Qytetërimet botërore në antikitet. (Mijëvjeçari IV pr. K. – shek. V ps. K.)

Linja përshkruan dhe analizon kushtet, etapat dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë. Nëpërmjet njohurive të marra në këtë linjë, nxënësit i krijohet mundësia të analizojë zhvillimet e qytetërimeve në brigjet e lumenjve në plan krahasues me qytetërimet në brigjet e deteve mesdhetare, për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. Kjo linjë do t'i pajisë nxënësit me njohuri dhe shprehje për shoqëritë në lashtësi, duke evidentuar tiparet e përbashkëta dhe veçantitë e tyre.

Linja 3 : Qytetërimet botërore në mesjetë. (Shek. V – shek. XV)

Kjo linjë ka për qëllim të shpjegojë dhe analizojë etapat kryesore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë mesjetare dhe qytetërimet në mesjetë; do të krahasojë mënyrën e organizmit ekonomik, politik, dhe kulturor të këtyre qytetërimeve për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. Nëpërmjet kësaj linje nxënësi do të kuptojë dhe shpjegojë kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare dhe ndryshimet që pësuan këto qytetërimet.

- **Programi “Historia e Qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore”** përfshin njohuritë e domosdoshme historike mbi evoluimin e qytetërimit evropian nga periudha e mesjetës në atë moderne, duke vazhduar më pas me qytetërimin bashkëkohor deri në ditët e sotme. Ky program zhvillohet në 72 orë mësimore, pra 2 orë mësimore në javë (36 javë gjithsej). Raporti njohuri të reja/përpunim njohurish është afërsisht në masën 70% me 30%.

Programi ka natyrë tematike-kronologjike, i strukturuar në 4 linja dhe 8 nënlinja.

Linja 1: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne

Nënëlinja 1.1: Ndryshimet në qytetërimet botërore

Linja 2: Koha e ndryshimeve thelbësore

Nënlinja 2.1: Ndryshimet në kulturën politike dhe ekonominë evropiane

Nënlinja 2.2: Revolucionet dhe ideologjitë e reja

Linja 3: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

Nënlinja 3.1: Fillimet e krizave të shekullit XX. Lufta dhe paqja (1914-1920)

Nënlinja 3.2: Qytetërimet midis dy Luftërave Botërore

Nënlinja 3.3: Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)

Linja 4: Qytetërimet bashkëkohore (1945-sot)

Nënlinja 4.1: Qytetërimi botëror në periudhën 1945-1990

Nënlinja 4.2: Fitorja e demokracisë

Nr.	Linja	Nënlinja	Nr.orëve/ linjë
I.	Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	1. Ndryshimet në qytetërimet botërore	8
II.	Koha e ndryshimeve thelbësore	1. Ndryshimet në kulturën politike dhe ekonominë evropiane 2. Revolucionet dhe ideologjitë e reja	25
III.	Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	1. Fillimet e krizave të shekullit XX. Lufta dhe paqja (1914-1920) 2. Qytetërimet midis dy Luftërave Botërore 3. Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)	17
IV.	Qytetërimet bashkëkohore (1945-sot)	1. Qytetërimi botëror në periudhën 1945-1990 2. Fitorja e demokracisë	22
	Totali		72

Përmbajtja e linjave të kësaj lënde në vija të përgjithshme është si vijon:

Linja 1: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne

Kjo linjë prezanton kthesën e madhe që mori qytetërimi botëror pas Rilindjes Evropiane dhe Zbulimeve të Mëdha Gjeografike. Përmes kësaj linje, nxënësit kuptojnë ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare, të cilat sollën fillimin e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor.

Linja 2: Koha e ndryshimeve thelbësore

Linja “Koha e ndryshimeve thelbësore” synon të pasqyrojë ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin perëndimor dhe botëror. Linja përfshin lindjen e nacionalizmit i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale në Evropën Qendrore dhe Ballkan. Gjithashtu linja trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike.

Linja 3: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

Në këtë linjë trajtohen tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nëpërmjet kësaj linje nxënësit do të kuptojnë, analizojnë dhe gjykojnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, frontet e luftës si dhe do të vlerësojnë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Përmes kësaj linje nxënësit mësojnë për përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijohet te ata bindja se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje më të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Linja krijon një tablo të qartë për drejtimitet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë dy sistemeve (demokratike dhe totalitare).

Linja 4: *Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)*

Kjo linjë ka për qëllim t'i njohë nxënësit me shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë, arsyen e ndarjes së botës në dy blloqe dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore. Linja do të përshkruajë ecurinë e zhvillimeve të mëvonshme ekonomike e njohur si “mrekullia ekonomike” apo “ vitet e arta” gjatë së cilës u realizua kalimi në shoqërinë postindustriale dhe triumfi i shteti i mirëqenies sociale. Në këtë linjë nxënësit do të prezantohen dhe me prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme.

- **Programi bërthamë i lëndës “Historia e Shqiptarëve”** studion aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore, si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke u përpjekur të vendosë një raport të baraspeshuar ndërmjet këtyre fushave të jetës. Ky program synon të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimi i sotëm shqiptar është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara. Në program ngjarjet historike trajtohen në vazhdimësi kronologjike, gjë e cila mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror.

Ky program zhvillohet në 68 orë mësimore, pra 2 orë mësimore në javë (34 javë gjithsej). Raporti njohuri të reja/përpunim njohurish është afërsisht në masën 70% me 30%.

Programi ka natyrë tematike-kronologjike, i strukturuar në 8 linja.

Linja 1: Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)

Linja 2: Qytetërimi ilir mijëvjeçari II– mijëvjeçari I (p.e.r.)

Linja 3: Shqipëria mesjetare (Shek V – XIV)

Linja 4: Shqiptarët gjatë sundimit osman Shek. XV – XX)

Linja 5: Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939

Linja 6: Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939-1944)

Linja 7: Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)

Linja 8: Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2008

Nr.	Linja	Nr.orëve/linjë
I.	Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)	5
II.	Qytetërimi ilir mijëvjeçari II– mijëvjeçari I (p.e.r.)	9
III.	Shqipëria mesjetare (Shek V – XIV)	10
IV.	Shqiptarët gjatë sundimit osman Shek. XV – XX)	10
V.	Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939	10
VI.	Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939-1944)	7
VII.	Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)	9
VIII.	Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2008	8
	TOTALI	68

Trajtesa tematike e historisë së shqiptarëve shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen

e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës; ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të nënlinjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t'i ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit. Veprimtaritë praktike e bëjnë programin dhe lëndën e historisë më përvetësues dhe më atraktive për nxënësin, duke e bërë atë aktorin kryesor në orën e mësimi.

Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohet historia e qytetërimit të popullit shqiptar me historinë e qytetërimit botëror, duke inkuadruar ngjarjet e historisë së popullit shqiptar në ngjarjet e historisë botërore, nëpërmjet periodizimit të historisë.

Formati i programit është:

1. Synimi i lëndës
2. Objektivat e përgjithshëm
3. Objektivat sipas linjave (janë 5 linja)
4. Kërkesa të historisë ndaj lëndëve të tjera
5. Kërkesa për zbatimin e programit
6. Vlerësimi

1.2. Fusha dhe përmbajtja

Lënda e historisë bën pjesë në grupin e shkencave shoqërore, së bashku me lëndën e qytetarisë, gjeografisë dhe ekonomisë.

Kjo lëndë, si të gjitha lëndët që zhvillohen në kurrikulën bërthamë, ka një kod, i cili gjendet në kopertinën e çdo programi dhe që përfaqëson vendin që zë kjo lëndë në planin mësimor të gjimnazit. Ai është:

Fusha: Shkencat shoqërore

Lënda: Historia

Kodi: 8.2

► Përmbajtja

Programi “Historia e Qytetërimeve Botërore” trajton qytetërimin në parahistori, disa nga qytetërimet e zhvilluara në luginat e lumenjve dhe në brigjet e deteve mesdhetare, veçoritë e zhvillimit dhe bashkëveprimin midis tyre. Ai përfshin dhe qytetërimin mesjetar, duke pasqyruar tipologjinë e këtij qytetërimi, i njohur ndryshe dhe si “epoka e errët” e qytetërimit botëror, si dhe ndikimin e qytetërimeve antike në ato mesjetare për të vazhduar më pas me fillimet e historisë moderne, ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike deri tek qytetërimet bashkëkohore.

Programi “Historia e Shqiptarëve” studion tërë aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore, si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke vendosur një raport të barabartë midis këtyre fushave të jetës.

Ky program është hartuar mbi bazën e objektivave, të cilat përcaktojnë konceptet kryesore (njohuri, aftësi, qëndrime) që synojnë këto objektiva. Njohuritë e reja dhe përpunimi i tyre shprehen nëpërmjet objektivave të programit.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat.

P.sh.: le të marrim objektivin:

Nxënës/i,-ja duhet të jetë i/e aftë “*të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike*”.

Ky objektiv do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të ushtrohen për ndërtimin e linjës së kohës dhe për vendosjen në këtë linjë të periudhave historike.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: le të marrim objektivin:

Nxënës/i, -ja duhet të jetë i/e aftë “të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, median, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike”.

Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të përdorin *burimet historike* dhe ato të *informacionit*, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të këtij koncepti historik.

Një nivel arritjeje është grumbullimi, përzgjedhja dhe kuptimi i materialit historik.

Një nivel më i lartë se ky është interpretimi i këtij materiali historik në kontekstin e njohurive të marra.

Një nivel edhe më i lartë do të ishte gjykimi për të, duke mbajtur qëndrim personal bazuar në argumente dhe duke parashikuar perspektivat e së ardhmes.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapituave paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme);

- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisje ngjarje aktuale ose thjesht kureshtjen e nxënësve.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- *aftësive të përgjithshme*, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- *aftësive të posaçme lëndore*, si: forcimi i personalitetit; edukimi i karrierës; aftësia për të vendosur në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike; aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak–pasojë; aftësia për të hetuar, interpretuar dhe parashikuar ngjarje historike; aftësia krijuese për shkrimin e një eseje apo referati, duke sjellë një opinion dhe qëndrim të vetin; aftësi krahasuese për krahasimin dhe renditjen e veçorive të ngjarjeve historike brenda të njëjtës periudhë apo periudhave të ndryshme; aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor; aftësi për komunikimin e saktë të njohurive, opinioneve, mendimeve, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.;
- *formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etik-social etj., gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

1.3. Zhvillimi i aftësive

Në të gjitha fushat e të nxënit, mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të stërvitet në kërkimin dhe përpunimin e informacionit, i cili i nevojitet që të përmbushë një detyrë të ndërmarrë nga ai vetë ose të ngarkuar nga të tjerë. Nëpërmjet lëndës së Historisë zhvillohen tek nxënësit, përveç të tjerave, edhe *aftësi dhe kompetenca krijuese e kritike*.

Programet vendosin *theksin* te kuptimi dhe përdorimi i aftësive pasi kjo gjë u krijon nxënësve mundësinë të zhvillojnë të nxënit aktiv. Ndërkohë që studiojnë të gjitha aspektet e programit, nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë e mëposhtme:

a) Aftësi për mbledhjen e informacionit nga:

- burime alternative historike;
- burime specifike nga tekste të ndryshëm;
- mundësi për shprehjen e vetvetes përmes gazetës së shkollës, apo një veprimtarie shkollore;
- burime dhe informacion nga teknologji të ndryshme të komunikimit dhe medias (p.sh.: të dhëna kompjuterike nga site të ndryshme interneti, programe TV dhe radio, burime audio dhe dixhitale).

b) Aftësi prezantimi dhe komunikimi duke:

- prezantuar dhe komunikuar informacionin dhe idetë nëpërmjet rrugëve të ndryshme (*prezantim gojor, flipchart, poëer point, video projektor, CD, DVD, etj.*);
- përdorur terma dhe koncepte të saktë historikë, gjatë zhvillimit të një argumentimi për një çështje të ngritur për diskutim, apo për të bërë një prezantim në mënyrë të saktë (p.sh.: hartimi i një eseje dhe database të të dhënave historike, etj.).

c) Aftësi vlerësimi për të:

- sintetizuar, analizuar, interpretuar dhe vlerësuar informacione dhe burime të ndryshme historike (p.sh.: bëjnë dallimin ndërmjet fakteve

dhe opinioneve, krahasojnë periudha dhe ngjarje të ndryshme historike, nxjerrin konkluzione, ngrenë gjykime të bazuara mbi një argument historik etj.).

d) Aftësi sociale për të:

- punuar në mënyrë efektive i vetëm ose në grup;
- ndjekur udhëzimet për punën në grup dhe bashkëpunimin;
- përdorur dhe komunikuar përmes diskutimit mbi informacionin apo punën e krijuar.

Aftësi dhe Kompetenca që duhet të arrijë nxënësi nëpërmjet studimit të lëndës së Historisë në gjimnaz:

- Të zhvillojë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur.
- Të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike.
- Të shpjegojë ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike, brenda dhe përtej periudhave historike.
- Të realizojë empatinë për një ngjarje ose personazh të shkuar historik.
- Të krijojë një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.
- Të analizojë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak– pasojë.
- Të tregojë një ngjarje historike me shkrim apo me gojë, duke përdorur përshkrimin, sqarimin, karakteristikën etj.
- Të bëjë analizën e materialit, ngjarjes, fenomenit dhe personazhit historik për të përcaktuar ose përkufizuar konceptin historik.
- Të aftësojë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndikimin e saj në të sotmen dhe në perspektivat e së ardhmes.
- Të dallojë faktet historike nga interpretimi historik.
- Të përgatisë, të prezantojë dhe të komunikojë një çështje historike

nëpërmjet mediave të ndryshme mësimore si: *flipchart, ëallchart, poëer point, albume, postera, referate, ese, video projektor, Cd, DVD, etj.*

- Të bëjë punë kërkimore për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë, duke u bazuar në burime alternative historike.
- Të ndërtojë hipotezën e tij, (mbajnë qëndrimin) për argumentimin e një ngjarjeje historike, duke u bazuar në burime historike.
- Të argumentojë vlerat e trashëgimisë historike, duke vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë e përcaktimit të identitetit të një populli.
- Të mbajë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj informacioneve në përgjithësi dhe atyre mediatike në veçanti.
- Të jetë i vëmendshëm ndaj argumenteve të të tjerëve dhe të mos u kundërvihet me paragjykime.
- Të punojë në mënyrë efektive i vetëm ose në grup.
- Të zhvillojë përmes studimit të historisë aftësitë qytetare, të cilat ndihmojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre për në jetë, punë dhe shoqëri.
- Të kuptojë detyrimet e përgjegjësitë qytetare në kuadrin e shtetit ligjor, nëpërmjet pajisjes me kulturë të plotë demokratike.

1. 4. Mundësitë kurrikulare për integrimin e Historisë me lëndët e tjera

Integrimi në kurrikulën e historisë së gjimnazit, kërkon transferimin në përgjithësi të njohurive dhe aftësive. Ky integrim është mishërimi i lidhjeve ndër-lëndore. Ai shkon deri në homogjenitetin e parimeve të mësimdhënies-mësimnxënies dhe përdorimin e teknikave të njëjta në të gjitha lëndët.

HISTORI	MATEMATIKË
Për të gjitha linjat e nënlinjat	Nxënës/i,-ja: ▪ të ndërtojë dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike. (p. sh.: vendosja në tabelë e të dhënave statistikore të dëmeve njerëzore gjatë Luftës së Dytë Botërore të vendeve të Evropës. Hedhja e tabelës në grafikë dhe interpretimi i saj.); ▪ të përdorë numrat e shifrat romake për leximin dhe shkrimin e shekujve; ▪ të përdorë boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës. (Vendos në boshtin numerik vitet para Krishtit dhe pas Krishtit.); ▪ të kryejë veprime matematikore në vlerë absolute, në funksion të llogaritjes së kohës. P.sh.: përcakton sa kohë ka kaluar nga periudha e vendosjes së Republikës Romake. (viti 409 para K. deri sot.)
HISTORI	GJUHË SHQIPE
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: ▪ të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik; ▪ të shprehë opinione, të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe bëjë debate tërheqëse dhe argumentuese me tematikë historike; ▪ të shkruajë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese me tematikë historike; ▪ të përzgjedhë informacionin e duhur historik në një vëllim të caktuar; ▪ të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një artikull historik; ▪ të shfrytëzojë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik; ▪ të lexojë dhe të interpretojë burime të ndryshme historike në dialektet gjuhësore; ▪ të përdorë teknikat, hapat dhe strategjitë për leximin dhe shkrimin e një dokumenti apo materiali zyrtar dhe jozyrtar historik; ▪ të dallojë në gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik.
HISTORI	LETËRSI

Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: - të shfrytëzojë veprat letrare-artistike si burim informacioni historik. P. sh.: nëpërmjet veprës së Homerit, njihet me organizimin shoqëror të jetës në antikitet. “Qytetërimi antik grek në veprën e Homerit”. - të përdorë folklorin shqiptar si burim historik; - të përdorë veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë. “Rilindësit-prodhim i epokës historike shqiptare”.
HISTORI	GJUHË E HUAJ
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: - të shfrytëzojë gjuhën e huaj si burim për interpretimin në gjuhën shqipe të një informacioni historik. (p. sh.: nxënësit në një veprimtari praktike i kërkohet të gjejë informacion me temë “Perandor romak me origjinë ilire”, duke shfrytëzuar si mjet burimor internetin.); - të përdorë terminologjinë bazë historike në gjuhë të huaj. - Terminologjia bazë e historisë që i kërkohet anglishtes: history; civilization; state; nation; laë; absolute monarchy; constitution; ëar; king; queen; time; place; religion; government; evidence; Ëorld Ëar I/II; empire; expirer; ancient; BC (before Christ); AC (after Christ); medieval; century.
HISTORI	TIK
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: - të shfrytëzojë simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter. - të përdorë Ëord-processor-in për shkrimin e një materiali historik. - të përdorë Poëer Point-in për prezantimin e një detyre në histori. - të ndërtojë tabela, grafikë e diagrame në kompjuter, për të paraqitur me anë të tyre të dhëna të ndryshme historike. (p. sh.: vendosja në tabela, diagrame e grafikë e të dhënave statistikore materiale dhe njerëzore të vendeve të Evropës për periudhën e Luftës së Dytë Botërore.); - të përdorë internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe figura historike.

HISTORI	GJEOGRAFI
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: ▪ të shfrytëzojë mjetet mësimore gjeografike si harta, globi dhe busulla për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike; ▪ të lexojë dhe të interpretojë harta të ndryshme historike dhe gjeografike; ▪ të orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike; ▪ të përcaktojë në hartë vendndodhjen e qytetërimeve. Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve; ▪ të përshkruajë teorinë e formimit të Tokës, për të argumentuar tezën e formimit të Tokës nga pikëpamja shkencore; ▪ të përkufizojë dhe të shpjegojë termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërime, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
HISTORI	Qytetaria
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i,-ja: ▪ të përkufizojë dhe shpjegojë konceptet liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve; ▪ të analizojë dhe interpretojë organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike; ▪ të shpjegojë dhe analizojë format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike; ▪ të analizojë dhe interpretojë besimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

1.5. Objektivat e arritjes

Lidhur me *objektivat e arritjeve*, termi “arritje” u fut në literaturën pedagogjike shqiptare në vitet ’90 të shekullit të kaluar për të përshtatur në shqip termin “*performance*” (anglisht dhe frengjisht), i cili përdoret për të treguar ato *dije, shprehi dhe qëndrime që nxënësi i demonstroi (i shfaq) në formën e veprimtarive dhe sjelljeve të ndryshme që ai kryen, të cilat janë të vëzhgueshme nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë, madje, shpesh herë, edhe të matshme*. Objektivat e arritjeve (performancës) janë e njëjta gjë me objektivat e sjelljes ose të veprimit. Një objektivi i programit mund të jetë i niveleve të ndryshme taksonomike, p.sh. nëse programi kërkon që nxënësi të krahasojë këtë me atë, ky objektivi është i nivelit bazë. Objektivat e programit janë të niveleve të ndryshme, në fushën e njohjes, të aftësive dhe qëndrimeve. Niveli i të nxënit të pritshëm rritet kur zhvendosemi nga të njohurit, në të kuptuarit dhe më pas në zbatim, analizë, sintezë dhe vlerësim.¹

Në tabelën e mëposhtme është bërë një ndarje e objektivave të programit sipas linjave dhe nënlinjave në tre nivelet e reduktuara të taksonomisë së Blumit (Bazë - njohje dhe kuptim; Mesatar - zbatim dhe analizë; I lartë - sintezë dhe vlerësim). Kjo për t’i ardhur në ndihmë mësuesit në përcaktimin e niveleve të arritjeve të nxënësve nisur nga objektivat e programit.

Në Shtojcë gjeni tabelën e taksonomisë konjitive të Blumit

Historia e qytetërimeve në antikitet dhe në mesjetë

LINJA I		QYTETËRIMI NË PARAHISTORI
Linja I/ Nënli nja I: Historia e qytetë rimit	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i, -ja: - të përkufizojë konceptet historike krye: histori qytetërimi, qytetërim, burime, periodizim, dokumente, mjedis, paleolit, mezolit, neolit, hominid, homosapiens, epokë akullnajore, parahistori, shoqëri parahistorike; - të shpjegojë kuptimin e nocionit qytetërim; - të përshkruajë ndryshimet që pësoi njeriu gjatë evolucionit të tij; - të tregojë epokat parahistorike, duke identifikuar shtrirjen kohore të tyre; - të përcaktojë periudhat historike: - Antikitet, - Mesjetë, Moderne (moderne e hershme 1500 – 1815 dhe moderne 1815 – 1945). - Bashkëkohore 1945 – sot ; - të tregojë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe të njerëzve në periudha të ndryshme historike, për të shpjeguar marrëdhëniet historike; - të shpjegojë rëndësinë e burimeve historike e të dokumentit historik dhe mënyrën e përzgjedhjes së tyre; - të klasifikojë burimet historike, duke i ndarë ato në burime parësore dhe dytësore.
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i, -ja: - të analizojë objektin e historisë së qytetërimit; - të analizojë kuptimin e nocionit qytetërim; - të shpjegojë karakteristikat e shoqërisë njerëzore sipas epokave parahistorike, duke evidentuar ndryshimet që ndodhën në to; - të analizojë veprimtaritë e njeriut që çuan në krijimin e komuniteteve të para njerëzore. - të shpjegojë dallimet mes shoqërisë matriarkale dhe asaj patriarkale; - të përdorë një sërë burimesh historike parësore dhe dytësore, për të arritur në përfundime të arsyetueshme mbi zhvillimin e një ngjarjeje historike; - të krijojë një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri, për çdo orë mësimore; - të kryejë veprime për llogaritjen e kohës; - të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë burimet historike, për të ndërtuar mbi bazën e këtyre një ngjarjeje historike.
	Niveli ilartë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i, -ja: - të vlerësojë tërësinë e vlerave materiale dhe shpirtërore të krijuara nga qytetërimet në zhvillimin historik të tyre; - të argumentojë rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve, duke krahasuar vlerën e tij dhe sot; - të argumentojë se si shoqëria parahistorike ndryshoi dhe evoluoi në kohëra; - të interpretojë dhe të vlerësojë etapat historike dhe ndryshimet fizike, ekonomike, sociale dhe kulturore, që pësoi njeriu në parahistori; - të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat, ngjarjet e rëndësishme historike botërore, si dhe ngjarjet e rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, për ta inkadruar atë brenda periudhave historike botërore; të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, medien, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike; - të evidentojë, nëpërmjet burimeve alternative, gjurmë të parahistorisë në vendin tonë dhe të identifikojë popujt, që kanë populluar në lashtësi Ballkanin.

LINJA 2		QYTETËRIMET BOTËRORE NË ANTIKITET. (MIJËVJEÇARI IV PR. K. – SHEK. IV PS. K.)
Linja 2/ Nënlinja I: Qytetërimet e hershme. <i>(Mijëvjeçari IV – II pr. K.)</i>	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ● të përkufizojë termat dhe konceptet historike kyç, si : kodet, pushtet hyjnor, pushtet i dhuruar nga zoti, kavaleri, shpikje, shkrimi, politeizmi, henoteizmi, piramida, mumie, barbarë, koloseumi; ● të tregojë në hartë vendndodhjen e të gjitha qytetërimeve, që lindën në brigjet e lumenjve; ● përshkruajë tiparet ekonomike të Mesopotamisë dhe të Egjiptit; ● të përcaktojë kohën e lindjes së qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt; ● të identifikojë tiparet e organizimit shtetëror dhe karakterin e tij në Mesopotami dhe në Egjipt.
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ● të analizojë rolin e mjedisit gjeografik në evolucionin e qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt; ● të krahasojë veçoritë ekonomike të Mesopotamisë dhe të Egjiptit; ● të shpjegojë ndërtimin shoqëror në Mesopotami dhe në Egjipt, duke krahasuar veçoritë e tyre; ● të shpjegojë karakterin dhe rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami; ● të analizojë kulturën materiale e shpirtërore të qytetërimeve në Mesopotami dhe në Egjipt.
	Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ● të vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë, si p. sh.: Sargoni, Hammurabi, Menesi, Ramsesi II; ● të gjykojë për ndikimin e këtij kodi dje dhe sot. ● të analizojë, nëpërmjet krahasimit, rolin e monarkut si “pushtet zot” dhe “pushtet i dhuruar nga zoti”, duke nxjerrë përfundime mbi këtë çështje; ● të analizojë në mënyrë kritike kodin e Hammurabit; ● të argumentojë ndikimin e arritjeve të këtyre qytetërimeve në qytetërimet e mëvonshme dhe në jetën e sotme; ● të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale për piramidat, duke diskutuar në klasë enigmat e tyre.

Linja 2/ Nënlinja II: Qytetë rimet në brigjet e deteve të Mesdheut	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/1,-ja: • të përkufizojë termat dhe konceptet historike kyç, si: popuj të detit, shkrim fenikas, mure ciklopike, qytet-shtet, koloni, luftë civile, oligarki, demokraci, tirani, patrikë, plebenj, skllavopronarë, gladiator, luftë punike, perandori, stil dorik, jonik e korintik, hark triumfi, obelisk, politeizëm, letërsi, filozofi, art, arkitekturë, krishterim, dyndje, migrim, krizë, shtete romane-gjermanike, “epokë e errët”, mesjetë; ▪ të përcaktojnë në hartë vendosjen dhe shtrirjen e popujve të detit. (Fenikia, Kreto – Mikenë, Greqia, Roma, Iliria); ▪ të përcaktojnë kohën e lindjes së qytetërimeve në Feniki, Kreto-Mikenë, Greqi, Romë dhe në Iliri; ▪ të përshkruajnë evolucionin politik të qytet – shteteve greke të Athinës dhe të Spartës; ▪ të përshkruajnë evolucionin politik të Romës; ▪ të dallojnë nëpërmjet ilustrimeve elemente të jetës së përditshme në qytetërimin grek e atë romak; ▪ të evidentojë rolin e gruas në qytetërimin grek e atë romak; ▪ të përcaktojnë në hartë përhapjen e qytetërimit grek e romak; ▪ të evidentojë rrugët nëpërmjet të cilave u përhapën këto qytetërimi; ▪ të përshkruajnë tiparet e artit, të kulturës, të shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek e atë romak; ▪ të përcaktojnë në hartë “dyndjen e popujve” në Evropë; ▪ të përcaktojnë faktorët historikë që shkaktuan lëvizjen e popujve; ▪ të tregojë veçoritë e besimit pagan;
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/1,-ja: ▪ të analizojë ndikimin e mjedisit në zhvillimin e këtyre qytetërimeve; ▪ të konkludojnë për karakterin e lidhjeve të qytet – shteteve greke. ▪ të krahasojë evolucionin politik të institucioneve greke dhe romake, duke argumentuar ndryshimet mes tyre; ▪ të shpjegojnë tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek e atë romak; ▪ të krahasojë kulturën greke me atë romake, duke treguar ndikimin e tyre në qytetërimet e mëvonshme, deri në ditë tona. ▪ të analizojë pasojat që sollën migrimet e popujve në Evropë.
	Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/1,-ja: ▪ të vlerësojnë rolin e figurave historike kryesore në këtë periudhë, si, p. sh.: Minosi, Homeri, Soloni, Dragoni, Klisteni, Perikliu, vëllezërit Grag, Jul Çezari, Oktaviani, Spartaku, Romuli, Remi, Krishti, Konstandini i Madh, Teodosi, Atila, Teodoriku; ▪ të argumentojë ndikimin e qytetërimit kreto-mikenas dhe atij etrusk në qytetërimin grek e romak; ▪ të vlerësojnë demokracinë antike dhe ndikimin e saj në qytetërimet e mëvonshme; ▪ të përdorë saktë konceptin koloni greke; ▪ të argumentojë faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit; ▪ të vlerësojnë rolin e migrameve të popujve në ndërprerjen e qytetërimit antik dhe lindjen e qytetërimit mesjetar; ▪ të analizojë krijimin e së drejtës romake si një prej legjislacioneve më të rëndësishme të jurisprudencës botërore; ▪ të vlerësojnë shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe qëndrimeve që zotëron nxënësi për qytetërimet antike. ▪ të argumentojë përfitimet e ndërsjella ndërmjet kulturave të qytetërimeve antike; ▪ të analizojë kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë; ▪ të argumentojë marrëdhëniet ekonomike, politike dhe kulturore ndërmjet qytetërimit ilir dhe atij romak; ▪ të vlerësojnë rolin e figurave historike në zhvillimin e shteteve.

LINJA 3		QYTETËRIMET BOTËRORE NË MESJETË.(400 PS. K–1450)
Linja 3/ Nënlinja I: Qytetërimet botërore në mesjetë. (Shek. V – shek. X)	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ■ të përkufizojë termat dhe konceptet kyç historike, si: trashëgimi greko-romake, “epokë e errët”, mesjetë ndarja e kishës, perandori, katolicizëm, ortodoksi, kod, islam, Allah, kalifat, kalif, mysliman, kuran, vend i shenjtë, agjërime; ■ të përshkruajë tiparet e organizimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimit bizantin; ■ të japë shembuj nga arti dhe kultura bizantine; ■ të përcaktojnë në hartë shtrirjen e perandorisë bizantine; ■ të shpjegojnë, me anë të ilustrimit, tiparet e qytetërimit arab; ■ të përcaktojnë në hartë shtrirjen e Perandorisë së shenjtë Romake;
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ■ të përcaktojnë në hartë lëvizjet e sllavëve në Ballkan e Bizant; ■ të krahasojë tiparet ekonomike dhe shoqërore të qytetërimit bizantin me tiparet ekonomike dhe shoqërore të qytetërimeve të mëparshme; ■ të analizojë tiparet e organizimit shtetëror të Perandorisë Bizantine; ■ të evidentojë ndikimin e qytetërimit arab në Evropë; ■ të demonstrojnë në hartë fazat e shtrirjes së Kalifatit Arab; ■ të analizojë kushtet historike të përhapjes së islamit, duke argumentuar rëndësinë e qytetërimit arab; ■ të përcaktojnë faktorët që ndikuan në përhapjen e krishterimit në Evropë; ■ të analizojë pozitën e Perandorisë së shenjtë Romake;
	Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: ■ të vlerësojnë rolin e figurave historike kryesore në këtë periudhë, si p. sh.: Justiniani, Muhamedi, Omar Khajani, Gregori i Madh, Karli i Madh, Leoni III, Otoni I; ■ të argumentojë në mënyrë kritike shkaqet e ndarjes së kishës së krishterë; ■ të shpjegojnë tiparet e qytetërimit bizantin, duke argumentuar shkaqet e krijimit të tij; ■ të shpjegojnë karakterin dhe rolin e kodit të Justinianit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Bizant; ■ të mbajnë qëndrim duke argumentuar ndikimin e këtij kodi dje dhe sot; ■ të analizojë rrugën historike të formimit të administratës kishtare; ■ të argumentojë forcimin e autoritetit papal në Evropë; ■ të argumentojë rrugët e formimit të dy autoriteteve në Evropë: Perandori dhe Papa; ■ të hartojë ese argumentuese me temë “Qytetërimi bizantin-vijimësi apo qytetërim i ri?”; ■ të argumentojë nëpërmjet diskutimit, pozitën e territoreve arbërore midis Romës dhe Bizantit; ■ të krahasojë dhe të argumentojë qëndrueshmërinë e Perandorisë Bizantine ndaj Perandorisë Romake të perëndimit.

Linja 3/ Nënlinja II: Evolucion i qytetërimeve mesjetare. (Shek. X – shek XV)	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: - të përkufizojë termat dhe konceptet historike kyç, si: feudalizëm, feud fisnikëri, vasalitet, bujkrobëri, vasal, detyrim, qytet, çiflig, luks, konflikte, shtresa shoqërore, komunë, Karta e Madhe e Lirive, monarki e kufizuar, republikë, emancipim, kryqëzatë, ripushtim, sistem feudal-ushtarak, sulltan, spahi, timar, krahina të vetëqeverisura, jeniçer; - të përshkruajë lindjen e qyteteve dhe zhvillimin e tregtisë në Evropën mesjetare; - të përshkruajë marrëdhëniet tregtare midis qytetërimit arab dhe atij evropian; - të përcaktojë në hartë itinerarin e lëvizjes së kryqtarëve drejt lindjes; - të identifikojë monarkitë kombëtare në hartën politike të Evropës mesjetare; - të shpjegojë marrëdhëniet midis lordëve dhe mbretërve në Angli; - të përshkruajë përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive; - të diskutojë për copëtimin feudal në Francë; - të përshkruajë tiparet e monarkisë absolute në Francë. - të përcaktojë lidhjen midis selxhukëve dhe osmanëve; - të tregojë kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane; - të përshkruajë rrugën e krijimit të shtetit osman.
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: - të shpjegojë tiparet themelore të sistemit feudal; - të analizojë strukturën shoqërore të Evropës mesjetare, nëpërmjet ilustrimit të një qyteti mesjetar të Evropës; - të krahasojë mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Evropën mesjetare; - të shpjegojë marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe qytetërimit evropian, duke evidentuar format e këtyre marrëdhënieve; - të shpjegojë shkaqet e fillimit të kryqëzatave; - të analizojë karakterin dhe grupet pjesëmarrëse në kryqëzata si dhe qëllimet e tyre; - të evidentojë pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve; - të vlerësojë rolin që mori parlamenti në jetën politike të Anglisë; - të përcaktojë karakterin e Kartës së Madhe të Lirive, si fillësë historike e monarkisë kushtetuese; - të analizojë arsyet e forcimit të pushtetit të mbretit në Francë; - të përcaktojë në hartë shtrirjen e Perandorisë Osmane sipas periudhave të zhvillimit të saj; - të analizojë karakterin dhe organizimin politik e shoqëror të Perandorisë Osmane; - të evidentojë tiparet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimet mesjetare; - të krahasojë prirjet e zhvillimit të artit, të kulturës dhe të arsimit në qytetërimin arab me ato në qytetërimin perëndimor.
	Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 10-të nxënës/i,-ja: - të vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë, si psh.: Grigori VII, Henriku IV, Urbani II, Bonifaci VIII, Filipi i Bukur, Xhoni Patokë; - të shpjegojë dhe të analizojë feudalizmin, duke evidentuar ndryshimet në jetën ekonomike dhe shoqërore; - të shpjegojë procesin e kalimit nga copëtimi feudal në shtet kombëtar, duke analizuar faktorët e këtij procesi; - të gjykojë mbi raportin e pushtetit të mbretit me parlamentin;

		▪ të shpjegojë marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë, duke analizuar shkaqet e këtyre marrëdhënieve; ▪ të krahasojë rolin e parlamentin anglez me atë të asamblesë së përgjithshme në Francë; ▪ të evidentojë rolin e Papatit në jetën politike të Evropës Perëndimore; ▪ të analizojë shkaqet dhe pasojat e konfliktit midis pushtetit të papës dhe monarkëve; ▪ të gjykojë për rolin e fesë në qytetërimin mesjetar; ▪ të argumentojë në veprimtarinë praktike trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare sot, duke iu referuar burimeve historike; ▪ të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale për të evidentuar lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet Evropiane të shek. XV; ▪ të shkruajë një ese argumentuese me temë: “Ndarja e kishës-dukuri teologjike apo politike?”; ▪ të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë materiale për të diskutuar në klasë mbi shkëmbimet tregtare midis botës arabe dhe asaj evropiane.
--	--	---

Po kështu, më poshtë po japim një model të ndarjes së objektivave të programit të **Historisë së Qytetërimeve Moderne dhe Bashkëkohore për klasën e 11-të** në tre nivelet e sipërpërmendura:

LINJA 1		QYTETËRIMET NË FILLIMET E HISTORISË MODERNE
Linja 1/Nënlinja I: Ndryshimet në qytetërimet botërore	Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/1,-ja: ■ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: Humanizëm, Rilindje; ■ të përcaktojnë tiparet e Humanizmit; ■ të përdorë saktë konceptin historik “Bota e Re”; ■ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: reformatcion, kundërreformatcion; ■ të përcaktojnë faktorët që sollën përçarjen në besimin katolik; ■ të ndërtojnë strukturën e shoqërisë evropiane në shek. XVI - XVII.
	Niveli i mesëm	Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/1,-ja: ■ të evidentojë kushtet historike që çuan në periudhën e Rilindjes evropiane; ■ të përcaktojnë në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të “Botës së Re”; ■ të shpjegojnë veçoritë e Reformacionit në Angli; ■ të shpjegojnë përmbajtjen dhe karakterin e Konkilit të Trentos; ■ të përcaktojnë në hartë zgjerimin e Perandorisë Osmane; ■ të ilustrojnë, nëpërmjet shembujve, trashëgiminë e qytetërimit osman në art, kulturë, shkencë dhe në ekonomi, jetë e përditshme; ■ të përcaktojnë ndryshimet sociale dhe kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë përparimet në teknologji, art, arkitekturë dhe në ide; ■ të vlerësojnë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë, si, p. sh.: Papa Leoni, Brunelesko, Gutenbergu, Erazmi i Roterdamit, Leonardo Da Vinçi, Mikelanxhelo Buonaroti, Servantesi, Shekspiri, Galileu, Koperniku.
	Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/1,-ja: ■ të analizojë ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë; ■ të argumentojë arsyet e shndërrimit të qyteteve italiane në djepin e qytetërimit modern evropian; ■ të analizojë rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”; ■ të vlerësojnë kulturën e popujve të “Botës së Re”; ■ të analizojë idetë kryesore të Luterit dhe Kalvinit, duke treguar veçoritë e pikëpamjeve të tyre; ■ të analizojë pasojat e Reformacionit protestant në Evropë; ■ të analizojë ndikimin që pati përhapja e qytetërimit osman në Evropë; ■ të argumentojë faktorët që sollën ndërprerjen e ekspansionit osman në Evropë; ■ të evidentojë kontributin e përparimeve shkencore në shoqërinë evropiane.

1.6. Objektivat specifike të arritjes në kurrikulën bërthamë të lëndës

Histori

a) Si të hartojmë objektivat specifike në tri nivele^{2*}?

Struktura e një objektivi

Dy pjesët më themelore të një objektivi janë: objekti dhe veprimtaria

Veprimtaria tregon atë që shfaq nxënësi për të demonstruar arritjet e tij: “përshkruan”, “identifikon”, “liston”, “mbledh”, “ndërton”, “harton”, “lidh”, “përmend”, “përsërit”, “shkruan”, “diskuton”, “përfshihet”, “respekton”, “analizon” etj.

Objekti mësimor (shkurt “objekt”), tregon termat, konceptet, shkaqet, pasojat, krahasimet, lidhjet, emrat, datat, modelet, faktet, burimet historike, personazhet historikë, etj. që shqyrtohen në programin e lëndës, mbi të cilat bien veprimtaritë e nxënësve.

Objekti + Veprimtaria = Objektiv

Shembull 1: koncepti qytetërim + të përkufizojë = të përkufizojë konceptin qytetërim

Veprimtaria është të përkufizojë, kurse objekti (ose produkti) është koncepti qytetërim

Pjesë të një objektivi, përveç veprimtarisë dhe objektit, janë dhe kushti e kriteri:

Kushti dhe *kriteri* plotësojnë dhe saktësojnë objektivin në përmbushjen e qëllimit të tij.

Kushtet bëjnë të mundur kryerjen e veprimtarisë për realizimin e objektivit (mjedisi, mjetet, pajisjet, materialet ndihmëse apo koha që nxënësi duhet të ketë në dispozicion për realizimin e objektivit).

Kriteret përdoren për të vlerësuar produktin e prodhuar nga nxënësi. Kriteri mund të mos shkruhet kur nënkuptohet, por nuk mund të shmanget kur është fjala për modalitetet e vlerësimit. Kështu, për shembull, vlerësimi që përdoret kur mësuesi do të nxjerrë notën përfundimtare të nxënësit është i bazuar në “kriteret”, d.m.th. në nivelin e arritjeve që demonstroi nxënësi,

* Kjo pjesë është marrë nga materiali i përgatitur nga grupi i specialistëve pranë QKTA-së në vitin 2007.

në raport me objektivat e programit, ose në raport me standardet.

b) Nivelet e arritjeve të objektivave:

- *Niveli bazë*
- *Niveli mesatar*
- *Niveli i lartë.*

Përsa i përket hierarkisë së arritjeve të nxënësve, ne do të ruajmë terminologjinë e futur të standardet: niveli bazë (më i ulëti) i arritjeve, niveli mesatar dhe niveli i lartë.

Po t'i referohemi klasifikimit të Blumit për nivelet e njohjes, atëherë, për objektivat e ndryshëm të programeve do të gjenim se:

- nëse nxënësi *duhet të japë përkufizimin* e një koncepti historik, ky objektiv është i nivelit bazë (në nivelin 1);
- nëse nxënësi *shpjegon me fjalët e tij*, kjo është e nivelit bazë (në nivelin 2);
- nëse nxënësi *vendos ngjarjet* në shkallën e kohës, kjo është e nivelit mesatar;
- nëse nxënësi *argumenton një çështje historike*, kjo përfshin ndoshta të gjitha nivelet, deri te më i larti.

c) Formulimi i objektivave specifike.

Objektivat specifike – paraqesin në mënyrë të matshme veprimtarinë e nxënësit.

Kur hartohen objektivat specifike (për objekte të caktuara mësimore), arritja e demonstrueshme bëhet e përcaktuar plotësisht, madje tani tregohen edhe kushtet në të cilat ajo prit të shfaqet, si dhe kriteret e saktësisë së përmbushjes (plotësimit) të arritjes së synuar (hartohen nga mësuesit).

Për të formuluar qartë një *objektiv specifik*, mund të ndjekim hapat e mëposhtëm:

- Shkruaj veprimtarinë e vëzhguar (sjelljen). Do të thotë se duhet të shkruhet ajo që nxënësi duhet të jetë i aftë të realizojë për të provuar se e ka arritur objektivin. Ky është një rregull i detyrueshëm.

- Shkruaj kushtet në të cilat duhet të manifestohet veprimtaria (sjellja). Saktësimi i këtyre kushteve lejon që objektivi të përcaktohet më mirë, që të sqarohen kufijtë e tij.

Kushtet mund të jenë:

- saktësime (“duke pasur të dhënë....”);
 - autorizime (“me ndihmën e...”);
 - ndalime (“ pa asnjë referencë...”) etj.;
 - nga memoria (përmendësh);
 - duke pasur ose jo një listë, tabelë, i jepet një vizatim, figurë, ose mjet hartë etj.;
 - veprimi do të kryhet në klasë, në muze, në arkiv, qendër arkeologjike, jashtë etj.
- Saktëso kriterin e arritjes (paraqitjes). *Shembuj kriteresh* janë: koha e kryerjes, përqindja e përgjigjeve të mira etj.

Kur formulon një objektiv specifik, pasi përcakton se cilit nivel shkollimi i përket ai (kjo në rastin tonë është e zgjidhur nga programi), duhet t’u përgjigjesh edhe pyetjeve të mëposhtme:

1. Cila është veprimtaria e vëzhguar që do të tregojë se objektivi është arritur ?
2. Cili do të jetë objekti (produkti) i kësaj veprimtarie (arritjeje) ?
3. Në cilat kushte do të ketë vend veprimtaria ?
4. Cilat kritere do të shërbejnë për të përcaktuar nëse produkti është i kënaqshëm ?

SHEMBULL 1 : Të përcaktojë në hartë të tëra fazat e shtrirjes së Kalifatit Arab;

- Veprimtaria e vëzhguar: të përcaktojë
- Objekti: fazat e shtrirjes së Kalifatit Arab
- Kushti: në hartë
- Kriteri: të tëra

Më poshtë, po japim shembuj të hartimit të objektivave specifike duke marrë si pikënisje objektivat e programit:

Lënda : Historia		Objektiva specifike
L i n j a I / Nënlinja I: Historia e qytetërimit	Niveli bazë ▪ të përkufizojë konceptet historike kyç: histori qytetërimi, qytetërim, burime, periodizim, dokumente, mjedis, paleolit, mezolit, neolit, hominid, homosapiens, epokë akullnajore, parahistori, shoqëri parahistorike; ▪ të përshkruajë kuptimin e nocionit qytetërim; ▪ të përshkruajë ndryshimet që pësoi njeriu gjatë evolucionit të tij; ▪ të tregojë epokat parahistorike, duke identifikuar shtrirjen kohore të tyre; ▪ të përcaktojë periudhat historike: ➤ Antikitët, ➤ Mesjetë, ➤ Moderne (moderne e hershme 1500 – 1815 dhe moderne 1815 – 1945) ➤ Bashkëkohore 1945 – sot; ▪ të tregojë organizimin kronologjik të historisë, me qëllim vendosjen e ngjarjeve dhe të njerëzve në periudha të ndryshme historike, për të shpjeguar marrëdhëniet historike; ▪ të klasifikojë burimet historike, duke i ndarë ato në burime parësore dhe dytësore.	▪ të identifikojë nga teksti konceptet historike kyçe të kësaj linje; ▪ të përshkruajë kuptimin e nocionit qytetërim duke përfrazuar tekstin; ▪ të vendosë në tabelë ndryshimet që pësoi njeriu në aspektin fizik, mendor, social, ekonomik; ▪ të vendosë në shkallën e kohës periudhat historike në parahistori dhe histori; ▪ të rendisë në linjë kronologjike disa nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së njerëzimit; ▪ të identifikojë në një listë të dhënë burimesh historike: burimet parësore nga ato dytësore.
	Niveli i mesëm ▪ të analizojë objektin e historisë së qytetërimit; ▪ të shpjegojë karakteristikat e shoqërisë njerëzore sipas epokave parahistorike, duke evidentuar ndryshimet që ndodhën në to; ▪ të analizojë veprimtaritë e njeriut që çuan në krijimin e komuniteteve të para njerëzore; ▪ të shpjegojë dallimet mes shoqërisë matriarkale dhe asaj patriarkale. ▪ të përdorë një sërë burimesh historike parësore dhe dytësore, për të arritur në përfundime të arsyetueshme mbi zhvillimin e një ngjarjeje historike; ▪ të krijojë një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri, për çdo orë mësimore; ▪ të kryejë veprime për llogaritjen e kohës; ▪ të kërkojë, të grumbullojë dhe të përzgjedhë burimet historike, për të ndërtuar mbi bazën e këtyre një ngjarjeje historike.	▪ të analizojë objektin e historisë së qytetërimit duke ju referuar përmbajtjes së tekstit, albumeve, fotove etj; ▪ të paraqesë në mënyrë skematike ose tabelore tiparet e shoqërisë njerëzore sipas epokave parahistorike; ▪ të krahasojë tiparet e shoqërisë matriarkale dhe asaj patriarkale nëpërmjet të dhënave të tekstit; ▪ të vendosë në shkallën e kohës ngjarjet kryesore në parahistori; ▪ të llogarisë distancat kohore të një ngjarjeje historike nga tjetra të dhëna nga mësuesi; ▪ të përgatisë një punim të thjeshtë historik (ese, poster, biografi, reportazh, CD) duke shfrytëzuar tërësinë e burimeve historike.
	Niv.	

Niveli i lartë - të vlerësojë tërësinë e vlerave materiale dhe shpirtërore të krijuara nga qytetërimet në zhvillimin historik të tyre; - të argumentojë rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve, duke krahasuar vlerën e tij dhe sot; - të argumentojë se si shoqëria parahistorike ndryshoi dhe evoluoi në kohëra; - të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat, ngjarjet e rëndësishme historike botërore, si dhe ngjarjet e rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, për ta inkuadruar atë brenda periudhave historike botërore; - të përdorë një gjerësi burimesh historike duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, mediat, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike; - të evidentojë, nëpërmjet burimeve alternative, gjurmë të parahistorisë në vendin tonë dhe të identifikojë popujt, që kanë populluar në lashtësi Ballkanin	- të vlerësojë tërësinë e vlerave materiale dhe shpirtërore të krijuara në qytetërimin parahistorik, nëpërmjet punëve me shkrim; - të argumentojë se si shoqëria parahistorike ndryshoi dhe evoluoi në kohëra, duke u bazuar në burimet alternative; - të vendosë në linjën e kohës të ngjarjeve historike botërore dhe ato shqiptare të së njëjtës periudhë historike; - të krijojë punime alternative mbi qytetërimin në parahistori, duke shfrytëzuar burimet historike.
---	--

Shembuj të formulimit të objektivave specifike të arritjes nisur nga objektivat e programit të lëndës **Historia e Qytetërimeve Moderne dhe Bashkëkohore, klasa e 11^{-të}**.

Objektivat specifike

Linja: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne.

Nënlinja: Ndryshimet në qytetërimet botërore

Objektivat e programit	Objektivat specifike
- të përdorë saktë konceptet historike kyçe: Humanizëm, Rilindje; - të analizojë ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë; - të vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në këtë periudhë, si, p. sh.: Papa Leoni, Brunelesko, Gutenbergu, Erazmi i Roterdamit, Leonardo Da Vinçi, Mikelanxhelo Buonaroti, Servantesi, Shekspiri, Galileu, Koperniku;	- të përkufizojë konceptet humanizëm, Rilindje; - të japë kuptimin e tij për konceptet humanizëm, Rilindje; - të përdorë në kontekste të ndryshëm konceptet humanizëm, Rilindje. - të evidentojë disa ndër ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, - të përshkruajë ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë; - të analizojë parimet themelore të Luterit, idetë e Kalvinit dhe veçoritë e protestantizmit në Angli; - të identifikojë disa ndër figurat kryesore historike që ndikuan në jetën shoqërore, artin dhe kulturën e shekujve XVI-XVII; - të përshkruajë rolin e disa nga figurave historike si Papa Leoni, Brunelesko, Gutenbergu, Erazmi i Roterdamit, Leonardo Da Vinçi, Mikelanxhelo Buonaroti, Servantesi, Shekspiri, Galileu, Koperniku, etj në shekujt XVI- XVII; - të gjykojë dhe vlerësojë rolin e figurave kryesore historike në shekujt XVI- XVII, si, p. sh.: Papa Leoni, Brunelesko, Gutenbergu, Erazmi i Roterdamit, Leonardo Da Vinçi, Mikelanxhelo Buonaroti, Servantesi, Shekspiri, Galileu, Koperniku, dhe ndikimin e tyre në jetën shoqërore, artin dhe kulturën e kësaj periudhe.

2. METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË HISTORISË

Shkolla, familja, shoqëria kërkojnë që nxënësit të formohen si subjekte të lira, krijues, kritikë, aktivë, të komunikojnë lirshëm dhe me kurajë qytetare për të përballuar me sukses sfidat e kohës.

Në këtë kuadër është ndërtuar dhe programi i historisë, i cili nuk kërkon që nxënësit të mbajnë mend dhe të riprodhojnë në mënyrë mekanike ngjarjet historike, por të *krahasojnë, të aktualizojnë, të ngrenë hipoteza, të përshkruajnë dhe të mbajnë qëndrim kritik*, duke vlerësuar opinionet e gjithsecilit.

Metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies së historisë përbëjnë faktorët më kryesorë për një mësimdhënie të suksesshme me në qendër nxënësin, të cilat nxisin

mendimin krijues e kritik.

Metodat që nxisin zhvillimin e aftësive krijuese dhe kritike bazohen në këta elemente:



Një mësimdhënie e mirë, e cila mundëson realizimin e synimeve dhe objektivave të programit, arrihet nëpërmjet alternimit të metodave të larmishme si:


- Metoda për dhënien e njohurive, termave dhe koncepteve të reja historike:

Shpjegimi, kallëzimi, nxitja e mendimeve, intervista, biseda, ilustrimi, krahasimi, ligjërata/leksioni, demonstrimi, ballafaqimi, metoda problemore, debati, diskutimi, loja me role, inserti, ekskursioni mësimor, konkursi etj.

- Metoda për përforcimin dhe zbatimin e njohurive historike si dhe formimin e shkathtësive dhe shprehive:

Kërkimi, hulumtimi, puna me projekte, eksperti, puna në grupe, përzgjedhje, analizë, gjykim, veprimtaritë praktike, ushtrime, paraqitje grafike e informacionit, hartë konceptesh, diagrami i Venit, tabela, puna me burimet alternative historike.

Skema e mëposhtme pasqyron metodat dhe teknikat që kanë në qendër veprimtarinë e nxënësit:



Përzgjedhja e metodave nga mësuesi varet nga përmbajtja e temës mësimore, nga objektivat mësimorë, shkalla e njohurive historike që zotërojnë nxënësit, vendi ku do të zhvillohet mësimi (klasë, kabinet, muze), mjetet mësimore që zotëron mësuesi etj.

Historia, është e mbushur me shumë dukuri dhe ngjarje historike të cilat japin mundësi të përpunohen jo me mënyrën tradicionale sipas ndërtimit strukturor shpjegim-marrje njohurish, por duke përdorur metoda e strategji që motivojnë dhe nxitin te nxënësit ndjenjën e kërkimit e të zgjidhjes së problemit. Këto kërkesa të mësimdhënies bashkëkohore kërkojnë ndryshimin e rolit tradicional të mësuesit. Kalimi përtej shpjegimit tradicional në ***të mësuarit problemor*** që nxit të menduarit kritik, është jo i thjeshtë dhe i lehtë për t'u realizuar, por në histori ky kalim është thelbësor. Kështu, p.sh tematika të tilla si rënia e Perandorisë Romake dhe shkaqet, pasojat e revolucionit industrial, tiparet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, etj, zakonisht shpjegohen nga shkaqe dhe faktorë të shumtë, të cilat nuk mund të trajtohen me metoda tradicionale që nuk kultivojnë të menduarit kritik. Për tematika të tilla rruga më e efektshme do të ishte shtrimi para nxënësve i pyetjeve, shtrimi i situatave problemore, diskutimi i hipotezave, etj.

Pyetjet që u drejtohen nxënësve gjatë një ore mësimi çojnë në kërkime me anën e të cilave synohet të arrihet një njohje e thelluar e njohurive historike. Përmes të pyeturit dhe hipotezave arrihet që nxënësit të mbajnë qëndrim ndaj informacionit të ri që përpunohet. Zakonisht lidhja shkak-pasojë përpunohet dhe realizohet nëpërmjet teknikave të të pyeturit, të tilla si: A ekzistojnë shkaqe të tjera të mundshme që mund të shkaktojnë të njëjtën pasojë? A ka lidhje të qëndrueshme ndërmjet shkakut dhe pasojës? Lidhja shkak-pasojë është e pranishme në të gjitha ngjarjet historike. Ajo përdoret kur kërkohet të dihet më shumë për një situatë të caktuar apo se ç'do të ndodhë nëse do të kishim një situatë të ndryshme nga e para. Kështu, p.sh. për nxënësit nuk do të kishte shumë rëndësi të njiheshin me faktin se Bashkimi Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore vendosi hegjemoninë në vendet e Evropës Lindore, por të jenë në gjendje të shpjegojnë faktorët dhe rrugën e ndjekur nga Bashkimi Sovjetik për vendosjen e kësaj hegjemonie.


Një ndër metodat mjaft të përdorshme që luan rolin e një instrumenti nxitës të shkëmbimit të ideve dhe mendimeve, por që përdoret dhe si mjet vlerësimi nga mësuesi është ***eseja***. Eseja realizohet si detyrë për të sintetizuar njohuritë e marra dhe i shërben reflektimit të nxënësve pas një teme mësimore apo kapitulli, për fakte, njohuri, ngjarje apo dukuri të ndryshme. Ajo nxit aftësitë shprehëse, edukon respektin për idetë dhe argumentet e tjetrit si dhe nxit zhvillimin e aftësive sintetizuese dhe vlerësuese të nxënësit. Në lëndën e historisë është shumë e rëndësishme që nxënësit të mirinstruktohen për mënyrën e ndërtimit dhe hartimit të esesë me qëllim që të përcaktohen drejt raportet midis karakterit përshkrues/

shpjegues/ argumentues dhe vlerësues të saj.

Instrumente të rëndësishme për të kultivuar të menduarit kritik të nxënësit janë **dokumentet historike**, në funksionin e tyre si burime të mirëfillta informacioni dhe si mjete demonstrimi. Burimet e shkruara, në formën e dokumenteve historikë, të ardhura deri në ditët tona, janë të llojeve e karaktereve të ndryshme. Ato janë shkrime historike apo letrare të autorëve të kohës, dokumente zyrtare e shtetërore, ditare, botime të shtypit të kohës, letra, kujtime, etj.

Përmes leximit të dokumentit historik nxënësit vihen përballë një autori, institucioni apo personaliteti të kohëve të shkuara. Ata reagojnë individualisht duke u nisur nga përfytyrimet që ata kanë fituar për atë kohë, duke i ballafaquar me informacionin që jep dokumenti i shkruar po në atë kohë.

Burime historike



Konkretizimi ka veçoritë e veta në lëndën e historisë. Nxënësi mund të perceptojë një monument të së kaluarës historike, objekte, etj. Konkretizimi në histori mund të klasifikohet në grupet e mëposhtme:

- **Konkretizimi lëndor** me objekte e sende natyrore në të cilin bëjnë pjesë monumente të së kaluarës si vendbanimet në shpella, piktura të kohës në mur, mozaikë, shtëpi ku kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme, etj; objekte të së kaluarës historike si veglat e punës, enët e periudhve të ndryshme, monedha, armë të ndryshme, etj.
- **Konkretizimi figurativ** në të cilin përfshihen veprat e pikturës historike, tablotë mësimore historike, ilustrimet, skicat, fotografitë, portretet, karikaturat, maketet, etj., të cilat përdoren në rastin kur është i pamundur vrojtimi i drejtpërdrejtë i sendeve dhe i objekteve.
- **Konkretizimi simbolik** ku realiteti historik paraqitet në mënyrë të përgjithësuar. Ai realizohet me anën të hartave historike, skemave, diagrameve, grafikëve, tabelave, etj.
- **Konkretizimi me mjete teknike**, si: filmat mësimore, CD, enciklopeditë elektronike, etj.

Mjete mësimore që përdoren në lëndën e historisë:

Harta; atlase; muze; arkiva; burime historike; literatura historike; romani historik; biografi; media; site interneti; dokumentar historik; film; pulla; karikatura; monedha; albume; kartolina; foto; piktura; objekte personale; postera; revista; video regjistrator; projektor; kompjuter; CD; flipchart; skeda; lastër, etj.

3.VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i njohurive të nxënësve është një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit. Vlerësimi i nxënësit është një përgjegjësi e rëndësishme dhe kërkon të mbështetet në parametra bashkëkohorë.

Veprimtaria vlerësuese është tepër komplekse, ajo duhet integruar në tërësinë e veprimtarisë mësimore. Në mësimdhënien dhe mësimnxënien e lëndës së historisë *qëllimet e vlerësimit* do të ishin:

- të bëhet përforcimi i mëtejshëm në kujtesën e nxënësve i njohurive historike, koncepteve, fakteve, datave, emrave të personaliteteve dhe figurave historike;
- të zhvillohen te nxënësit aftësitë dhe prirjet për të bërë punë të pavarur, për të operuar me informacionin, për ta përdorur atë në situata konkrete;
- të njohë nxënësit me rezultatet e të nxënit në lëndën e historisë dhe, ajo që është me e rëndësishmja, t'i ndihmojë ata të përmirësojnë të nxënit e mëtejshëm;
- të ndihmojë në përpunimin, kategorizimin dhe kodimin e njohurive historike, me qëllim ruajtjen e tyre në kujtesë për një afat sa më të gjatë;
- të aftësojë nxënësit për të krahasuar njohuritë e tyre të përfuara gjatë procesit të të nxënit, me standardet dhe objektivat e pritshëm të lëndës;
- të motivojë nxënësit për arritje dhe tregues më të suksesshëm;
- t'i japë mësuesit informacion për nivelin e dijeve të nxënësit, për arritjet dhe boshllëqet, me qëllim që mbi këtë bazë ai jo vetëm bën vlerësimin e tyre, por merr dhe masa për të luftuar dobësitë, për ta bërë mësimin sa më të suksesshëm.

Në kushtet e reja të mësimdhënies së historisë, ku punohet me standarde e objektiva lëndorë, strategji e metoda të reja, nuk duhet të përdoren kritere dhe metoda të vjetra vlerësimi, të cilat kultivojnë të riprodhuarit mekanik të përmbajtjeve historike, të mësuarit përmendësh të fakteve, koncepteve, datave dhe ngjarjeve.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi është një proces i cili kalon në tri etapa kryesore :

- ***Kontrolli***, kupton procesin e kërkimit dhe të mbledhjes së informacionit historik (njohuri, dukuri, koncepte etj), me qëllim që të nxirren përfundime për nivelin e të mësuarit dhe të nxënit.

Kontrolli i njohurive, shprehive dhe aftësive të nxënësve në lëndën e historisë është disa llojesh: paraprak, i vijueshëm, periodik dhe përfundimtar. Ai realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: teknikat e të pyeturit, teste të shumëllojshme, punë krijuese, si: hartim referatesh, esesh, intervista, vëzhgime, hartim grafikësh, tabelash etj.

- **Matja** është një proces krahasimi, krahasohet sasia e informacionit të njohur me sasinë e informacionit të panjohur në raport me njohuritë që duhet të përvetësojë nxënësi sipas objektivave të programit. Kur bëjmë matjen e njohurive historike, nxënësve u duhet të analizojnë argumente, dëshmi, të krahasojnë koncepte, dukuri, fakte, të diskutojnë, të debatojnë, të argumentojnë dhe të parashikojnë, duke mbajtur qëndrim personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike. Matja mund të shprehet me pikë, me përqindje ose me një evidencë të thjeshtë etj., krahasuar me një standard apo objektiv të programit lëndor.

Vlerësimi është procesi gjatë të cilit përcaktohen vlerat mbi bazën e informacioneve të grumbulluara nga procesi i matjeve. Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Mësuesi i historisë vlerëson me notë apo me stimul shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, *vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij personal ndaj një ngjarjeje apo*

figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë *përdorimin e burimeve alternative* nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të të tjerëve, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje apo figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Nisur nga qëllimi i realizimit, vlerësimi mund të klasifikohet në vlerësim formues, diagnostikues, përmbledhës, motivues.

Vlerësimi formues, synon marrjen e informacionit mbi atë që ka arritur të përvetësojë nxënësi krahasuar me standardin mësimor. Ky informacion i nevojitet mësuesit për të ndërhyrë dhe ndryshuar mësimdhënien duke siguruar kalimin në objektiva të rinj mësimore vetëm pasi të jenë arritur objektivat mësimorë paraprakë. Në lëndën e historisë përdorimi i vlerësimit formues merr rëndësi të veçantë sepse konceptet janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe nuk mund të vijohet me sukses nëse

nuk është arritur përvetësimi i koncepteve bazë fillestare, kështu p.sh.: nuk mund të vijohet në trajtimin e qytetërimeve antike kur nuk është përvetësuar nga nxënësit qytetërimi në parahistori. Vlerësimi formues ndihmon jo vetëm mësuesin në planifikimin e orës së mësimit, por dhe nxënësin në identifikimin e atyre koncepteve të cilat kërkojnë një punë të mëtejshme për t'u përvetësuar.

Disa metoda dhe teknika për vlerësimin formues në lëndën e historisë:

- Vlerësimi i nxënësve në histori mbi bazën e burimeve historike

Një nga shqetësimet kryesore në mësimin e historisë është grumbullimi i materialeve që duhen, i burimeve historike. Ky është një proces kërkimor i vazhdueshëm i mësuesve dhe nxënësve. Burimet historike nuk shërbejnë vetëm si materiale ilustrimi në orën e mësimit, por mbi bazën e tyre mësuesit e historisë duhet të bëjnë vlerësimin e njohurive dhe të shprehive të nxënësve për tema dhe kapituj. Mbasi materialet burimore janë përzgjedhur me kujdes nga mësuesi, u shpërndahen nxënësve. Mësuesi për çdo material harton pyetjen si dhe vendos përbri pikët që mund të marrin nxënësit. Kërkesat ndërtohen sipas burimeve të shfrytëzuara.

P.sh.

Studio burimin 1:

*A tregon ky burim se udhëheqësit e vendeve fituese ishin të kënaqur me çfarë u arrit në Versajë?
(6 pikë)*

Studio burimin 2 dhe 3:

*A e mbështet burimi 2 mesazhin që jep burimi 3? Jep mendimin tënd duke iu referuar të dyja burimeve.
(8 pikë)*

.....etj.

Vlerësimi diagnostikues, përdoret për aspekte të përvetësimit të njohurive nga nxënësit, për të gjykuar për atë që kanë mësuar dhe nuk

kanë mësuar nxënësit. Ky tip vlerësimi përdoret për të marrë informacion mbi përgatitjen dhe dobësitë e nxënësve në përvetësimin e materialit mësimor, me qëllim që mësuesi të marrë masa për të plotësuar këto dobësi të nxënësve.

Vlerësimi motivues, ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për efikasitetin e të nxënit duke ndihmuar në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies. Ai përbën një ndër format më efektive që mund të përdoret në drejtim të nxitjes së të mësuarit tek nxënësit. Kur përcaktohen objektiva të qartë dhe të saktë nga mësuesit për njësi ore mësimore, nxënësi është në gjendje t'i shohë dhe t'i masë vetë arritjet e i tij, duke nxitur në këtë mënyrë dëshirën e tij për më shumë përparim.

Vlerësimi përmbledhës, bëhet në përputhje me objektivat mësimore në fund të semestrit, vitit ose në fund të studimit të disa kapitujve mësimorë. Ai jep informacion mbi atë çfarë kanë arritur të nxënë dhe të bëjnë nxënësit gjatë periudhës së dhënë kohore; është mirë të parashikohen disa vlerësime përmbledhëse gjatë vitit.

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve bëhet përmes një numri të madh *teknikash vlerësimi*. Ato janë:

1. Vlerësimi me shkrim (testet);
2. Vlerësimi gojor;
3. Vlerësimi me anën e dëgjimit;
4. Vlerësimi praktik;
5. Vlerësimi me anën e pyetësorëve të nxënësve;
6. Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore, punëve në terren.

Është e këshillueshme që informacioni mbi shkallën e nxënies së nxënësve të merret sipas rastit duke përdorur secilën nga teknikat e mësipërme.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i

bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga mini-testet pakminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënit, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Për kurrikulën-bërthamë nxënësi vlerësohet me notat 4-10. Në përfundim të semestrit të parë, për secilin nxënës dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore.

4.SHTOJCË

Modele ore mësimore në lëndën e historisë për realizimin e të cilave janë përdorur metoda ndërvepruese

MODELI 1

Lënda: Histori e qytetërimeve në antikitet dhe mesjetë

Tema: Athina

Klasa: 10

Koha: 45'

Objektivat e orës së mësimi:

Nxënës duhet të jetë i aftë që :

- Të përcaktojë në hartë vendndodhjen e qytet-shtetit të Athinës.
- Të përshkruajë tiparet kryesore të zhvillimit të shoqërisë, ekonomisë, jetës politike e kulturës së Athinës.
- Të evidentojë rolin e reformave të Drakonit, Solonit e Klistenit dhe fillimin e atij procesi ligjor qeverisës që do të njihet si demokraci.
- Të argumentojë, pse me reformat e Klistenit u hodhën bazat e

demokracisë së drejtpërdrejtë.

- Të përshkruajë evolucionin politik të Athinës.
- Të vlerësojë demokracinë antike dhe ndikimin e saj në qytetërimet e mëvonshme.

Koncepte kyç: qytet-shtet, reforma, demokraci, ligje të shkruara, eupatride, ostrakizëm, naukrari, demokraci e drejtpërdrejtë.

Shprehji që zhvillohen: Të interpretuarit, të lexuarit, të kuptuarit, të argumentuarit, të analizuarit.

Metodat e përdorura gjatë orës së mësim:

Brainstorming	5'
Teknika e ndërthurjes	30'
Pesëvargëshi dhe shkrimi i lire	10'

ZHVILLIMI I MESIMIT

Brainstorming është teknikë që ka për qëllim të stimulojë sa më shumë ide.


Brainstorming

Mësuesi u drejtohet nxënësve me pyetjen:

Ç'kuptoni me termin demokraci?

Nxënësit shprehin idetë e tyre për demokracinë.

Ndërkohë, mësuesi i shkruan përgjigjet e nxënësve dërrasën e zezë të strukturuar në këtë mënyrë:



Në fund mësuesi përmbledh mendimet e nxënësve dhe jep përkufizimin e saktë të konceptit demokraci.

Nxënësit më pas ndahen në grupe prej 4 anëtarësh. Ata njihen me veprimtarinë e të nxënësve në bashkëpunim dhe përgjegjësitë që ka secili nxënës për të nxënësve të gjithë materialit. Secili nxënës hap librin dhe lexon temën e mësimit. Gjithashtu, mësuesi u shpërndan nga një fletë të ndryshme eksperti për secilin anëtar grupi.

Teknika e ndërthurjes

Për rreth 15 minuta nxënësit lexojnë në heshtje pjesën “Athina”. Secili nxënës lexon pyetjet në fletën e ekspertit që i është dhënë dhe do t’u përgjigjet atyre mbi bazën e ndarjes në katër pjesë të temës, përgatitur nga mësuesi.

Më pas, nxënësit që kanë të njëjtin numër, do të mbledhen në grupet e ekspertëve dhe do të diskutojnë për rreth 10 minuta pyetjet dhe përgjigjet e tyre. Pjesët e tekstit ku gjenden përgjigjet e nxënësve, do të mbahen shënim, në mënyrë që nxënësit t’u referohen atyre gjatë përgjigjes.

Nxënësit “eksperte” do t’u mësojnë anëtarëve të tjerë të grupit pjesën për të cilën ishin përgjegjës. Raportimi nuk zgjat më tepër se 5 minuta. Nxënësit e tjerë dëgjojnë duke bërë edhe pyetje për sqarime më të plota. Përpara klasës del përfaqësuesi i ekspertëve për të prezantuar pjesën në të cilën ishin përgjegjës. Në fund mësuesi ndërhyr duke bërë plotësimet

apo sqarimet e nevojshme. Më poshtë paraqiten fletët e ekspertëve me pyetjet përkatëse.

FLETA E EKSPERTIT 1

- Përshkruaj veçoritë e zhvillimit ekonomik të Athinës në varësi dhe të mjedisit gjeografik.
- Cili ishte organizimi shoqëror dhe politik i Athinës?
- Shpjegoni shprehjen e Aristotelit: ”Të varfrit ishin bërë skllëvër të të pasurve, jo vetëm ata vete, por edhe fëmijët e gratë e tyre”.
- Ndërtoni skemën e republikës aristokratike në Athinë.

FLETA E EKSPERTIT 2

Teknika e ndërthurjes së nxënësve të lexojë materialin dhe rrit vëmendjen për t’u dhënë përgjigje pyetjeve përkatëse.

Ç’kuptoni me shprehjen: “Ishin vetë arkondët, të cilët, për të parandaluar shpërthimet e tjera të shtresave të ulëta, ulta thirrën Dragonin”?
Ç’përmbanin “ligjet drakoniane”?
Pse “ligjet drakoniane” patën rëndësi?

FLETA E EKSPERTIT 3

- Radhitni reformat e Solonit.
- Pse reformat e Solonit dhanë një shtytje të mëtejshme drejt demokracisë?
- Ku qëndron rëndësia e reformave të tij?
- Cilat qenë të rejat që sollën reformat e Solonit?

FLETA E EKSPERTIT 4

- Radhitni reformat e Klistenit.
- Pse me reformat e Klistenit në Athinë u hodhën bazat e demokracisë së drejtpërdrejtë?
- Ku qëndron rëndësia e reformave të Klistenit?
- Evidentoni karakterin e kufizuar të demokracisë athinase.

Pesëvargëshi

Shkruani një pesëvargësh për Athinën.

Pesëvargëshi është teknikë që shërben për të sintetizuar informacionin sipas
--

Detyrë (Shkrimi i lirë)

Zbërtheni shprehjen e Linkolnit, demokracia është qeveri: “që i përket popullit, del nga populli dhe i shërben atij”.

Shkrimi i lirë është teknikë që e vë nxënësin të shkruajë pa u ndalur për 5 minuta rreth detyrës pa u shqetësuar për drejtshkrimin.

Analiza e orës mësimore nr. 1

Format e punës së organizuar me nxënësit	Cilat qenë format e punës që nxënësit ndoqën gjatë orës mësimore?	<i>Punë individuale dhe në grupe.</i>
Metodat	Cilat qenë metodat që mësuesi zgjodhi për realizimin e objektivave mësimorë?	<i>Mësuesi zgjodhi këto metoda:</i> ▪ brainstorming, ▪ teknika e ndërthurjes, ▪ diskutimi, ▪ shkrimi i lire. Secila metodë i përgjigjej objektivave të kësaj teme mësimore.
Shprehitë e të menduarit	Cilat qenë shprehitë që nxitën këto metoda dhe teknika tek nxënësit? Në cilat veprimtari u përfshinë nxënësit?	<i>Shprehitë komunikative ishin:</i> ▪ të folurit, ▪ të dëgjuarit, ▪ të lexuarit, ▪ të shkruarit. <i>Nxënësit:</i> ▪ diskutuan, ▪ analizuan, ▪ dëgjuan njëri-tjetrin, ▪ reflektuan ndaj pyetjeve dhe kërkesave të mësuesit.

Përparësitë:

- Ndërveprimi, pjesë e mësimdhënies dhe e të nxënit.
- Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi u jep mundësi nxënësve të komunikojnë me njëri-tjetrin.
- Vlerësimi i mendimeve të nxënësve duke zhvilluar aftësitë intelektuale.
- Nxënësit u vunë në rolin e studiuesit, të kërkuesit, të raportuesit, të lexuesit të vëmendshëm.

Kujdes:

Mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm në organizimin e mirë të orës mësimore në drejtim të:

- Përcaktimit të grupeve të punës,
- Menaxhimit të kohës në diskutime,
- Qartësisë së detyrave që u jepen nxënësve,
- Respektimit të rregullave të punës në grup,
- Zbatimit të afateve kohore të veprimtarive për realizimin me sukses të objektivave mësimorë që mësuesi synon të realizojë.

MODELI 2

Lënda: Histori e qytetërimeve në antikitet dhe mesjetë

Veprimtari Praktike: Veprimtaria e Perandorit romak Konstantin.

Klasa: 10

Koha: 45'

Objektivat e orës së mësimi:

Nxënësi duhet të jetë i aftë që:

- të vlerësojë burimin historik si të vetmin mjet për të gjykuar rreth figurës historike të Kostantinit;
- të analizojë portretin e Kostantinit në të gjitha dimensionet (politike, sociale, personale);
- të vlerësojë rolin e figurave historike në zhvillimin e shteteve.

Detyrë shtëpie (Disa orë përpara zhvillimit të veprimtarisë praktike, orientohen nxënësit rreth mbledhjes dhe përpunimit të materialit nga burime alternative historike.

Mjete të nevojshme:

Fotografi me pamje nga gjetjet romake (për krijimin e albumeve, CD, etj); Harta e Gadishullit Apenine.

Burime : Historia Botërore dhe Qytetërimi 2 - Karl Grimberg

Adresa: www.terredelmediterraneo.org/itinerari/s_costantino.htm – 34k; cronologia.leonardo.it/storia/anno306a.htm;

Zhvillimi i orës së mësimit

Hapi i parë (10 min)

Secilit nxënës i jepet letra e parapërgatitur dhe e shumëfishuar nga mësuesi, e cila përfshin gjithë udhëzimet për punën që do të kryejë nxënësi.

Mësuesi shtron para nxënësve këto çështje:

- Cili qe roli i Kostantinit si perandor romak?
- Pse u bë i domosdoshëm aprovimi i Ediktit të Milanit?
- Ku qëndron roli i Kostantinit në triumfin e Krishterimit?
- Identifikoni origjinën e Kostantinit
- Evidentoni veprimtarinë e Perandorit Kostantin në zhvillimet historike të Perandorisë Romake.
- Identifikoni aspekte nga jeta ekonomike, politike, shoqërore, kulturore e vendit tonë për këtë periudhë historike.

Hapi i dytë (8 min)

Punë individuale, secili nxënës plotëson fletën udhëzuese të detyrës që u ka dhënë mësuesi.

Hapi i tretë (10 min)

Nxënësit bashkohen në grupe ekspertësh prej 6 vetësh. Diskutimi në grup i nxit nxënësit të flasin rreth ideve të tyre.

Hapi i katërt (10 min)

Secili grup paraqet punimin e bërë dhe në formën e një paneli prezantohet detyra para klasës duke dhënë shpjegimin përkatës mbi bazën e diskutimit.

Hapi i pestë (7 min)

Grupet e ekspertëve vlerësojnë dhe gjykojnë mbi materialet e njëritjetrit duke nxjerrë përfundimet përkatëse

Veprimtaria praktike u jep mundësi nxënësve të shfaqin aftësitë e tyre krijuese dhe kritike nëpërmjet punës hulumtuese, përzgjedhjes, prezantimit, analizës, gjykimit dhe vlerësimit. Në linjën e parë, "Qytetërimi në parahistori", klasa e 10-të, nxënësi mëson si ta vërë veten në pozitën e një historiani, si një eksplorues dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, si përzgjedhës, gjurmues (kërkues/hetues), vlerësues dhe parashikues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike. Vetëm në këtë linjë ndryshon raporti ndërmjet njohurive të reja dhe veprimtarive praktike, në favor të këtyre të fundit.

MODELI 3

Lënda: Histori e qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore

Tema: Iluminizmi

Klasa: 11

Koha: 45'

Objektivat e orës së mësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë që:

- të përcaktojë konceptin iluminizëm;
- të shpjegojë tiparet e iluminizmit dhe ndihmesën e dhënë;
- të analizojë pikëpamjet e iluministëve dhe rolin e tyre në perspektivën e zhvillimeve shoqërore;
- të evidentojë përhapjen e ideve iluministe në art dhe në kulturë.

Fjalë kyçe: Iluminizëm, të drejta natyrore, pavarësi e pushteteve, bashkëjetesë me tolerancë, barok, rokoko.

Struktura e orës së mësimit:

E	BRAINSTORMING	10'
R	TEKNIKA E PYETJEVE	20'
R	KLLASTER+SHKRIM I LIRE	15'


ZHVILLIMI I MËSIMIT

EVOKIMI(Brainstorming)

Tërheqim vëmendjen e nxënësve duke u thënë:

“Mendoni për një moment sikur jeni në fillim të shek..XVIII. Udhëtimi nëpër Evropë po ju befason,gjërat kanë ndryshuar, njerëzit mendojnë ndryshe (kujtoni: Rilindjen evropiane- Luftërat fetare- Udhëtimet e evropianeve drejt kontinenteve të tjera-Zhvillimet në art e letërsi).

Pra, mësuesi duke u rikujtuar nxënësve informacionet që kanë marrë më parë, vjel mendimet e tyre dhe plotëson në dërrasën e zezë këtë skemë:



Momentet që sapo skicuam ju sollën qytetarëve të Evropës iluminizmin, që do të thotë:

- Ndriçim
- Arsye
- Argument

Kështu, mësuesi ju bëri të ditur nxënësve tri tipare të iluminizmit.

REALIZIMI I KUPTIMIT (Teknika e pyetjeve):

TEKNIKA E

PYETJEVE

NDIHMON

NXËNËSIN TË

PËRQENDRO-

HET DHE TE

QARTËSOHET


DUKE I NXITUR

MENDIME DHE

PËRFYTYRIME.

Mësuesi ndan klasën në grupe me 4 nxënës dhe shpërndan për çdo grup hartën e të pyeturit për temën “Iluminizmi”. Më pas nxënësit do të lexojnë në heshtje tekstin dhe burime informacioni, që do t’i shërbenin si burim për përgjigjet e pyetjeve. N x ë n ë s i t sipas grupeve diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve mbi bazën e një radhe logjike dhe i shënojnë ato në fletore.


HARTA E TE PYETURIT



REFLEKTIMI(KLLASTER)

KLLASTERI ËSHTË
TEKNIKË QË NDËRTHUR
TË LEXUARIT ME TË
SHKRUARIT. AJO KRIJON
MUNDËSI TË LIDHJEVE
TË NJOHURIVE ME
NJËRA-TJETRËN.

Sipas grupeve përkatëse u kërkohet
nxënësve të vazhdojnë punën duke
ndërtuar një kllaster për temën
“Iluminizmi” si më poshtë:



Në përfundim, mësuesi i kërkon të gjitha grupeve së bashku të sistemojnë punët që kanë kryer brenda grupit dhe të krijojnë një përmbledhje ku t'i vendosin të gjitha ato në mënyrë të sistemuar në një tabak letre duke formuluar një stendë të titulluar “Iluminizmi”. Këtë punim nxënësit e sjellin në orën pasardhëse duke e vendosur atë në një kënd të klasës.

DETYRË (Shkrim i lirë)

- Shkruani mendimin tuaj rreth të drejtave dhe përgjegjësiave të individit, duke vënë theksin rreth konceptit “liri”.

Burime ku mund të mbështeten mësuesit në dhënien e informacionit historik:

- Historia Botërore dhe Qytetërimi 1- 12 Karl Grimberg
- Gramatika e qytetërimeve Fernand Braundel
- Didaktika e historisë Qazim Xhelili
- Site interneti : <http://www.nytimes.com/learning/index.html>; <http://www.artic.edu/cleo/Teachfolder/LPMainSearch.html>; exploringhistory.com/philosophy.html - 13k; Lesson Plans - Greek and Roman Land Use Ëhat Ëas the Difference.htm; ëëë.uc.uk.net;

Tabela : Taksonomia konjitive e Blumit

Tre nivelet e arritjeve	Nivelet e Blumit	Foljet përshkruese
Niveli bazë	1.Të njohurit Është riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, rregullave, përkufizimeve dhe shpjegimeve ashtu siç janë dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën e njohjes	Përkufizo, përsërit, përshkruaj me fjalët e tekstit, identifikoj, vër në tabelë, hartoj një listë, emërtoj, riprodhoj etj.
	2. Të kuptuarit Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se TË NJOHURIT	Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, nxirr përfundime, perifrash, rishkruaj, përgjithëso, interpretoj ndryshe, nxirr një përfundim etj
Niveli mesatar	3.Aplikimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.	Ta aplikosh (zbatosh), të shfrytëzosh, të ndryshosh, të njehsosh, të klasifikosh, të provosh , të vësh në dukje, të manipulosh, të përgatit, lidh, tregoj, shpjego, përdor etj.
	4.Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, ç'ka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se në TË KUPTUARIT	Copëtoj, ndaj në pjesë, shpjego përse, diferencoj, shquaj, dalloj, vër në dukje, lidh, seleksionoj etj

Niveli i lartë	5.Sinteza: Është aftësia që formon një të tërë duke bashkuar pjesët. Mund të jetë: komunikim i një plani veprimesh, klasifikim informacioni etj	Kombino, harto, krijo, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompozohet, jep mendime, përmirëso, organizo, planifiko, risistemo, të shkruash, të tregosh, të prodhosh, të hartosh, të transmetosh, të krijosh, të propozosh, të planifikosh, të prodhosh, të modifikosh, të specifikosh, të kombinosh, të organizosh, të sintetizosh, të klasifikosh, të përfundosh, të zhvillosh, të modifikosh, të ndërtosh etj.
	6.Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimi i komunikimeve gjyquese etj	Krahëso, konkludo vër në kontrast, kritiko, përshkruaj, shpjego, justifikohet, interpreto lidh, përmbledh, bëj një evidencë etj.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)**

LËNDA: GJEOGRAFI

TIRANË, 2010

PËRMBAJTJA

Qëllimi i udhëzuesit

1.Rëndësia e gjeografisë në kurrikulën e re të gjimnazit

1.1.Synimet e kurrikulës së re

1.2.Zhvillimi i aftësive

1.3.Fusha dhe përmbajtja

1.4.Mundësitë kurrikulare për integrimin e Gjeografisë me lëndët e tjera

1.5.Objektivat e arritjes

1.6.Objektivat specifikë të arritjes në kurrikulën bërthamë të lëndës Gjeografi .

2.Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës

3.Vlerësimi i nxënësit

4.Shtojcë

Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi kurrikular i lëndës Gjeografi është një material ndihmës për përdoruesit e kurrikulës dhe veçanërisht për mësuesit e gjimnazit të cilët zhvillojnë lëndën e Gjeografisë. Ky udhëzues ndihmon mësuesit në zbatimin e programeve mësimore të kësaj lënde dhe sugjeron metoda të suksesshme të mësimdhënies dhe të nxënit.

Udhëzuesi shërben si nxitës i përmirësimit të përvojave të deritanishme të mësimdhënies. Ai i fton mësuesit të mendojnë rreth të nxënit aktiv, kurrikulës së hapur dhe fleksibël, lidhjes ndërlëndore, duke i lënë vendin e duhur si lirisë akademike të tyre, ashtu dhe krijimtariisë dhe artit të të mësuarit. Në kushtet e përdorimit të teksteve alternativë, ky udhëzues nuk i shërben punës së mësuesit me një tekst, ai përpiqet të qëndrojë mbi to duke i dhënë peshë dhe vlerë asaj çka planifikon dhe organizon çdo ditë mësuesi në lëndën e tij, me nxënësit dhe mjedisin ku operon.

Duke shpresuar që ky udhëzues të bëhet një libër tryeze për mësuesit e kësaj lënde në gjimnaz, mirëpresim dhe falenderojmë çdo përdorues të tij që bën sugjerime në drejtim të përmirësimit të tij.

1.RËNDËSIA E GJEOGRAFISË NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

Gjeografia si lëndë sjell një kontribut të shquar në përmbushjen e objektivave të përgjithshëm të kurrikulës kombëtare për gjimnazin. Kurrikula e gjeografisë krijon mundësi për:



Nxënës të suksesshëm

Si një lëndë e rëndësishme për jetën e nxënësve, përvojat personale dhe të ardhmen e tyre, i motivon nxënësit të jenë të suksesshëm dhe të tërhiqen nga studimi i kësaj lënde. Gjeografia u krijon nxënësve hapësira të nxëni përmes përjasjeve të saj, përfshirë punën në terren dhe diskutimin e çështjeve aktuale. Një ndër qëllimet qendrore të gjeografisë në këtë nivel shkollimi është të zhvillojë, përmes koncepteve kryesore, kuptimin e ideve të mëdha dhe ngjarjeve që po transformojnë botën. Në këtë mënyrë, nxënësit aftësohen të bëhen të suksesshëm, të aftë të mund të kuptojnë botën rreth e qark tyre.



Individë me besim te vetja

Shumëllojshmëria e tematikave të bazuara në kërkimin gjeografik ndërton tek nxënësit aftësinë dhe besimin për të zhvilluar aftësitë kërkuese në mënyrë efektive, vetëm ose me të tjerët. Një ndër synimet e kësaj kurrikule, të zhvillojë nxënës me besim të cilët janë të hapur ndaj frymëzimit që ofron bota natyrore dhe humane, është një aspekt themelor i mësimdhënies së gjeografisë. Kjo lëndë u krijon nxënësve mundësi të shprehin idetë e tyre rreth vendeve dhe ngjarjeve në kontekst global, rajonal e lokal. Në këtë mënyrë gjeografia siguron një mjedis në të cilin nxënësit mund të eksplorojnë vlerat dhe besimet e tyre. Lënda i pajis nxënësit me aftësi për të shqyrtuar vlefshmërinë e asaj që lexojnë përmes analizave. Eksplorimi dhe diskutimi i një shumëllojshmërie burimesh dhe çështjesh u krijon nxënësve mundësinë të shqyrtojnë situatat dhe dilemat, i ndihmon ata të bëjnë zgjedhje të drejta.

Aftësi për jetën

Gjeografia kontribuon dukshëm në mirëqënien ekonomike afatgjatë të rinjve përmes zhvillimit të aftësive hapësinore dhe komunikuese, të cilat janë thelbësore për shumë profesione. Ajo i inkurajon nxënësit të përshtaten dhe të gjejnë zgjidhje të informuara për çështje të botës së sotme. Ajo i inkurajon nxënësit të vlerësojnë nevojën për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e mjedisor. Këto aftësi të transferueshme u shërbejnë për të nxënit e tyre gjatë gjithë jetës. Aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe për t'u ngritur mbi faktet dhe të dhënat është një ndër cilësitë më domethënëse që u mundësojnë gjeografëve të punësohen në një sërë sektorësh.

Kontribut pozitiv

Gjeografia i frymëzon nxënësit të mendojnë për vendin e tyre, vlerat e tyre dhe përgjegjësitë e tyre ndaj njerëzve të tjerë dhe ndaj mjedisit. Nxënësit mendojnë për rolin e tyre si qytetarë. Ato përcaktojnë qëndrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën si kjo mund të ndikojë veprimet dhe zgjedhjet e tyre. Nxënësit shqyrtojnë impaktin social, mjedisor dhe ekonomik të asaj që bëjnë individualisht apo kolektivisht. Ata kuptojnë që të marrësh përgjegjësi për çështje lokale apo globale do të thotë të kontribuosh pozitivisht në shoqëri.

Me synim përmirësimin e cilësisë së procesit të të nxënit dhe të mësimdhënies, kurrikula e lëndës së gjeografisë:

 është ndërtuar duke marrë në konsideratë veçoritë konjitive, psikologjike e sociale të nxënësve dhe ofron mundësi të të nxënit dinamik;

 bazohet në kërkimin – i aftëson nxënësit të drejtojnë vetë kërkimin, të bëjnë vëzhgime shkencore, të ofrojnë hipoteza;

 përdor perspektivën hapësinore, të dhënat dhe teknologjitë e

reja – nxënësit përdorin hartat e ndryshme, imazhet satelitore të orbitës së Tokës, të dhëna dhe mjete që mbledhin, vlerësojnë dhe përpunojnë;

 krijon mundësi për punë në terren nga nxënësit – nxënësit kryejnë vëzhgime në oborrin e shkollës, në territorin ku banojnë;

 krijon mundësi për zhvillimin e aftësive në matematikë, gjuhë etj;

 shërben si mjet për zhvillimin profesional të mësuesve.

Filozofia dhe përmbajtja e mësimit të gjeografisë në gjimnaz përshkruhen në dokumentet e rëndësishme kurrikulare: standardet e shkencave shoqërore dhe programi i gjeografisë për kurrikulën bërthamë të gjimnazit.

Të dyja këto dokumente të rëndësishme kurrikulare për mesimdhënien /mësimnxënien e gjeografisë në gjimnaz, reflektojnë dhe zbërthejnë në mënyrë të detajuar kërkesat e dokumentit bazë për kurrikulën e gjimnazit, “Korniza kurrikulare e gjimnazit“.

1.1.SYNIMET E KURRIKULËS SË GJEOGRAFISË

Gjeografia shkollore lidhet ngushtë me zhvillimet e mëdha të shkencës së gjeografisë, e cila e ka ndryshuar tërësisht objektin dhe thelbin formues të saj, duke u cilësuar gjithnjë e më tepër si: „studim njohës, aplikativ dhe kritik i mjedisit fizik dhe human „.

Qëllimi i përgjithshëm i të mësuarit të gjeografisë shkollore është:

„Formimi i qytetarëve të ardhshëm për një shoqëri demokratike të zhvilluar, të lirë e të pavarur, të ndërgjegjshëm e me shpirt kritik, të aftë për të bashkëjetuar me mjedisin e tyre dhe për ta ndryshuar atë në mënyrë krijuese duke vështuar nga e ardhmja“.

Nga ky synim i përgjithshëm derivojnë dhe objektivat e përgjithshëm të lëndës për të gjithë ciklin e gjimnazit:

 Të zhvillojë tek të rinjtë njohje dhe kuptim të vendit ku jetojnë, të vendeve të tjera, njerëzve dhe mënyrës si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;

 Të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të realizuar studimin gjeografik, p.sh. kërkimin gjeografik, punën me hartën dhe punën në terren;

 Të stimulojë interesin dhe kurajon për të vlerësuar botën rreth nesh;

 Të ndërgjegjësojë të rinjtë për njohjen dhe respektimin e diversitetit të komuniteteve dhe kulturave në botë;

 Të edukojë vlerësimin për mjedisin, duke rritur shkallën e përgjegjësisë për kujdesin ndaj planetit;

 Të ofrojë një sërë aftësish dhe teknikash për vëzhgim, përzgjedhje, analizë dhe prezantim të dhënash;

 Të zhvillojë aftësitë për të përdorur informacionin gjeografik në kryerjen e gjykimeve dhe marrjen e vendimeve.

Konceptet

Vendin më të rëndësishëm në përmbajtjen e lëndës së gjeografisë e zënë konceptet gjeografike, meqenëse konsiderohen si njësitë bazë të njohurive. Krijimi i tyre vjen si pasojë e të menduarit logjik dhe ndonëse konceptet gjeografike formohen duke u mbështetur në faktet gjeografike, ato nuk janë një shumë e thjeshtë, por përgjithësim i tyre. Çdo mësues, gjatë përgatitjes së tij, duhet të përcaktojë konceptet që kërkon të rrënjosë te nxënësit në orë të ndryshme të mësimi. Kjo e lehtëson atë njëkohësisht për të zgjedhur përmbajtjen kryesore të materialit të tekstit sipas temës që do të zhvillojë.

Disa ndër konceptet kryesore me të cilat operon lënda e gjeografisë në klasën e 11^{-të} dhe të 12^{-të} të gjimnazit janë:

- rajonet gjeografike
- kriteret e rajonizimit
- temat e gjeografisë
- tipet e rajoneve
- modelet e zhvillimit
- globalizimi
- dinamikat e popullsisë dhe migrimi

- urbanizimi
- procesi dhe impakti i turizmit
- konfliktet etnike, fetare
- zhvillimi i qëndrueshëm
- shkretirizim, shpyllëzim, erozion, ndotje
- burime natyrore
- trashëgimi natyrore
- etj.

Struktura

Kurrikula e re e gjeografisë për gjimnazin është konceptuar në **kurrikul bërthamë** dhe **kurrikul me zgjedhje të detyruar**. Në kurrikulën bërthamë të gjeografisë bëjnë pjesë konceptet, njohuritë, aftësitë bazë, të detyrueshme dhe të mjaftueshme për të gjithë nxënësit e Shqipërisë, për këtë cikël shkollimi. Kurrikula me zgjedhje të detyruar e gjeografisë mbështetet në kurrikulën bërthamë, por zgjerohet dhe thellohet më shumë se ajo. Këtë kurrikul nuk janë të detyruar ta zgjedhin të gjithë nxënësit, por vetëm ata që e shikojnë si mjet dhe mundësi për shkollimin e mëtejshëm, për punësim apo dhe për interesat e kënaqësitë e tyre.

Kurrikula bërthamë e gjeografisë është parashikuar të zhvillohet në dy vite: „Gjeografia Rajonale e Botës“ në klasën e 11^{-të} të gjimnazit dhe “Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare” në klasën e 12^{-të} të gjimnazit.

Programi i lëndës “**Gjeografia Rajonale e Botës**” për klasën e 11^{-të} të gjimnazit, ka në fokusin e tij studimin mbi bazë **rajoni** të aspekteve fizike, mjedisore, kulturore, ekonomike, historike dhe politike të botës.

Programi i lëndës “**Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare**” për klasën e 12^{-të} të gjimnazit, trajton në mënyrë komplekse problemet gjeografike të hapësirës shqiptare nga pikëpamja rajonale.

Të dy këto programe, së bashku me konceptet dhe aftësitë e gjeografisë fizike që nxënësi merr në lëndën Shkenca e Tokës në klasën e 10^{-të} të gjimnazit, mbyllin ciklin e njohurive dhe aftësive gjeografike bazë, të detyrueshme që konsiderohen si të mjaftueshme për nxënësit e këtij cikli shkollimi.

Kurrikula me zgjedhje të detyruar e gjeografisë zhvillohet në klasën e 12^{-të} në kuadrin e lëndës “Gjeografia e problemeve globale” e cila trajton çështje të ndryshme ekonomike, sociale, politike dhe mjedisore botërore në këndvështrimin global. Me fokus dimensionin hapësinor të zhvillimeve globale, lënda synon t’i orientojë nxënësit drejt një “gjeografie çështjesh dhe problematikash” (lokale, rajonale, globale). Duke qenë se lënda “Gjeografia e problemeve globale” është lëndë me zgjedhje, programi mundëson për nxënësit hapësira përfshirjeje e thellimi në fushat që ai dëshiron e ka interes dhe të cilat, në njëfarë mënyre, përbëjnë disa ndër sfidat më të mëdha që ne si shoqëri e shekullit të 21 do të përballojmë: “Si do t’i përgjigjet shoqëria sfidës së ngrohjes globale? Si do të zgjidhen dhe parandalohen konfliktet gjeopolitike? Si mund t’i përdorim në mënyrë sa më efektive burimet natyrore të kufizuara? Si mund t’i projektojmë qytetet për të qenë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore dhe për një cilësi më të mirë të jetës? e të tjera si këto.

Kurrikula e gjeografisë është hartuar mbi bazën e objektivave dhe përcakton konceptet kryesore (njohuritë, aftësitë, qëndrimet) që synojnë këto objektiva. Kjo mënyrë e re e parashtrimit të përmbajtjes lëndore dhe e përcaktimit të orëve mësimore në bazë problematike u jep më shumë liri mësuesve, të cilët, duke u nisur nga kushtet konkrete (nxënësit, pajisjet etj.), mund të zgjedhin njohuritë, shprehjet të parashikuara për t’u përvetësuar nga nxënësit sipas tematikave përkatëse.

Shpërndarja e orëve në planin semestral e vjetor është në kompetencën e mësuesve. Në programin analitik mësuesit janë të lirë të planifikojnë shpërndarjen e orëve për temat e veçanta, por pa cënuar arritjen e objektivave lëndore. Rikonceptimi i përmbajtjes lëndore dhe organizimi i saj sipas kësaj strukture kurrikulare do ta ballafaqojë mësuesin me një detyrë më të vështirë por mjaft stimuluese për të. Me këtë program të ri mësuesit do të kenë mundësi më të mëdha për të përpunuar, administruar, verifikuar dhe vlerësuar punën e tyre, por tashmë, duke i patur më parë të qarta objektivat ku synojnë të arrijnë dhe qëllimet finale, nën drejtimin e të cilave ata do të ushtrojnë tërë veprimtaritë didaktike në klasë dhe jashtë saj.

* * *

Gjeografia Rajonale e Botës - Klasa e 11-të

Programi i lëndës ***Gjeografia Rajonale e Botës*** realizohet në 36 orë mësimore vjetore (1 orë mësimore/javë x 36 javë), prej të cilave afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e ***njohurive të***

reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për **përpunimin e njohurive** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Nga pikëpamja strukturore, ky program përcjell elementë të rinj të planifikimit dhe programimit kurrikular. Këto elementë ndikojnë në rritjen e shkallës së fleksibilitetit të zbatimit të këtij programi.

Programi bërthamë ***Gjeografia Rajonale e Botës*** për gjimnazin është strukturuar në një linjë e cila realizohet përmes 11 blloqeve tematike që vijnë njëri pas tjetrit. Kjo nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Nr.	Linja	Bloku tematik	Nr.orëve
I.	Rajonet	I.1. Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve. I.2. Evropa - Karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale. I.3. Amerika e Veriut I.4. Amerika Qendrore I.5. Amerika e Jugut I.6. Afrika Nën-Sahariane I.7. Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore I.8. Azia Jugore I.9. Azia Lindore I.10. Azia Juglindore I.11. Australia, Oqeania	36

Renditja e blloqeve lihet në dëshirë të zbatuesve të programit, të cilët duhet të ndjekin logjikën e vijueshmërisë së zbatimit të objektivave të programit brenda klasës.

Mësues/i-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë në një bllok tematik kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit paraqesin një përvetësim të kënaqshëm, e rëndësishme është të respektohet sasia e

orëve vjetore të lëndës.

Përpunimi i njohurive përmban:

- Punët praktike;
- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Projektin kurrikular lëndor;
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Gjatë këtyre orëve mësuesit mund të nxisin diskutimet e nxënësve për tematika të veçanta në varësi të specifikave të rajoneve, si p.sh:

për rajonin e Evropës, diskutimin: Popujt që bëjnë diferencën.

për Evropën Juglindore: Mundësitë e integritit të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit Perëndimor në BE.

për rajonin e Amerikës Veriore: Dygjuhësia në Kanada.

për rajonin e Amerikës Qendrore: Vlerësimi i klimës si element i rëndësishëm i turizmit.

për Amerikën Jugore: Amazona, perspektiva dhe probleme.

për Afrikën: Lufta për të drejtat e njeriut.

për Azinë Lindore: Artet marciale.

për Australi-Oqeaninë: Aborigjenët.

Meqenëse veprimtaritë praktike janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 20% e orëve të përgjithshme të planifikuara për klasë sugjerohet t'u lihen këtyre

veprimtarive. Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë **detyra tematike** (si p.sh. të realizojnë një detyrë tematike mbi mjedisin dhe problemet mjekësore që shoqërojnë Afrikën Nënshahiane përmes hulumtimit në Internet, enciklopedi, materiale të tjera burimore etj); **projekte kurrikulare** (si p.sh. të realizojnë në grup një projekt që paraqet ndryshimet politike që ka pësuar Federata Ruse pas rënies së murit të Berlinit e deri sot etj); **të zgjidhin situata problemore nga jeta** (p.sh. të argumentojnë qëndrimin e tyre pro ose kundër globalizmit) etj.

* * *

Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare - Klasa e 12 -të

Programi i lëndës *Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare* realizohet në 68 orë mësimore vjetore (2 orë mësimore/javë x 34 javë), prej të cilave afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e **njohurive të reja lëndore** dhe **30%** e tyre janë për **përpunimin e njohurive** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Ky program është strukturuar në 5 linja.

Linja 1: Vendndodhja gjeografike

Linja 2: Sistemet fizike

Linja 3: Sistemet humane

Linja 4: Ndërveprimi njeri/mjedis

Linja 5: Rajonet

Nr.	Linja	Bloku tematik	Nr.orëve/linjë
I.	Vendndodhja gjeografike	I.1. Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	3

II.	Sistemet fizike	II.1. Diversiteti i mjediseve dhe peizazheve të trevave shqiptare	9
III.	Sistemet humane	III.1. Organizimi administrativ i trevave shqiptare III.2. Popullsia dhe vendbanimet III.3. Ekonomia e trevave shqiptare	12
IV.	Ndërveprimi njeri/mjedis	IV.1. Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare	6
V.	Rajonet	V.1. Rajonet gjeografike të trevave shqiptare V.2. Republika e Shqipërisë V.3. Rajoni Perëndimor V.4. Rajoni Verior dhe Verilindor V.5. Rajoni Juglindor V.6. Rajoni Jugor V.7. Republika e Kosovës V.8. Trevat shqiptare në Serbi V.9. Trevat shqiptare në Maqedoninë perëndimore V.10. Trevat shqiptare në Mal të Zi V.11. Trevat shqiptare në Greqi	38
Totali			68

Punët praktike përbëjnë një pjesë integrale të kësaj lënde. Ato janë ilustrim praktik i njohurive të fituara nga nxënësit por njëkohësisht i shërbejnë dhe zhvillimit të një sërë aftësive që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave, (*p.sh. të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikorë, grafikë etj; të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë*) etj. Kjo lëndë krijon mundësi që nxënësit të zhvillojnë disa teknika matematikore, veçanërisht ato të shoqëruara me vlerësimin dhe manipulimin e të dhënave statistikore, ndërtimin e grafikëve etj. Meqenëse punët praktike janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 8% e orëve të përgjithshme të planifikuara në klasë, u lihen këtyre veprimtarive.

Gjithashtu, gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohej mundësia të punojnë **detyra tematike** (*si p.sh. të vlerësojë përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare, duke i parë dhe trajtuar ato në kushtet e integritetit rajonal dhe evropian*); **projekte kurrikulare** (*si p.sh. të realizojë një projekt, individual ose në grup, mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë*) etj. Për realizimin e tyre, nxënësit kanë mundësi të përdorin teknologjinë, në mënyrë të veçantë pajisjet dhe kompjuterët.

Formati i programit

Lënda e gjeografisë, sikurse çdo lëndë në planin mësimor të gjimnazit, ka një kod të prezantuar në kopertinën e programit i cili përfaqëson vendin që zë në këtë plan mësimor kjo lëndë brenda fushës së shkencave shoqërore. Për klasën e 11^{-të} ky kod është si më poshtë:

Fusha: Shkencat shoqërore
Lënda: Gjeografi
Kodi: 8.3.11.B

ndërsa për klasën e 12^{-të}:

Fusha: Shkencat shoqërore
Lënda: Gjeografi
Kodi: 8.3.12.B

Përmbajtja e programit është organizuar brenda këtyre rubrikave:

1. Të përgjithshme
2. Synimi i lëndës
3. Objektivat e përgjithshëm
4. Objektivat e linjave
5. Kërkesat e gjeografisë ndaj lëndëve të tjera
6. Kërkesa për zbatimin e programit

Përmbajtja

Gjeografia Rajonale e Botës - klasa e 11-të

Kjo lëndë synon që, nxënësit duke analizuar shpërndarjen hapësinore, të aftësohen për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre. Kjo u krijon nxënësve mundësinë të kuptojnë marrëdhëniet komplekse që ekzistojnë ndërmjet mjediseve fizike e njerëzore të rajoneve të ndryshme. Lënda ka për qëllim të evidentojë jo vetëm njohuritë mbi kushtet natyrore të rajoneve të ndryshme, karakteristikat shoqërore dhe ekonomike, por dhe kushtet e ndryshme të jetesës së njerëzve në shkallë vendi, rajoni dhe globi.

Vështirimi rajonal i popullsisë, i kulturave, i feve, i zhvillimeve ekonomike etj, ndihmon nxënësit për të kuptuar e vlerësuar drejt kulturat dhe mënyrat e ndryshme të jetesës e të zhvillimit në botë. Përmes këtij studimi, nxënësi analizon dhe përcakton raportin e duhur dhe lidhjet midis nivelit lokal, rajonal dhe atij global.

Bota e sotme është një botë e ndërlidhur e rrugëve dhe tregjeve, turizmit dhe televizionit, një “fshat global”. Ndarja e botës në hapësira gjeografike vendos një kornizë të gjerë globale, e cila na çon në një koncept të rëndësishëm organizimi në gjeografi: koncepti rajonal.

Hapësirat gjeografike mbështeten në grup-kriteresh hapësinore:

- ato janë njësitë më të mëdha në të cilat ndahet bota e banuar;
- janë rrjedhojë e ndërveprimit të shoqërive njerëzore dhe mjediseve natyrore;
- përfaqësojnë përqëndrimet më të mëdha të shoqërisë njerëzore në botën e sotme.

Rajonet janë instrumente shkencorë që na lejojnë të bëjmë përgjithësime hapësinore të cilat mbështeten në kritere artificiale dhe të cilat vendosen me qëllim konturimin e tyre. Rajonet janë konstrukte intelektuale, por ato nuk janë abstraksione; ato ekzistojnë në botën reale dhe zënë një vend të caktuar në sipërfaqen e tokës. Jo të gjithë kufijtë e rajoneve mund të jenë të qartë dhe specifikisht të përcaktuar. Është kjo arsyeja që ndërmjet rajoneve shfaqen hapësira tokësore transitive, p.sh. në Afrikë zona e tranzicionit është e shprehur qartë: ajo ndodhet ndërmjet dy hapësirave gjeografike - hapësirës së Afrikës nënsahariane dhe asaj të Azisë perëndimore/Afrikës veriore.

Lënda gjithashtu krijon mundësi eksplorimi ndaj tendencave të reja të globalizmit dhe multikulturalizmit dhe mundësinë e konceptimit të raportit midis tyre. Përmes kuptimit të idesë së rajonit, nxënësit mund të zbatojnë njohuritë gjeografike, aftësitë dhe perspektivat për zgjidhjen e problemeve ashtu sikurse për marrjen e vendimeve.

Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare - klasa e 12^{-të}

Ky program synon formimin e koncepteve shkencore tek nxënësit mbi veçoritë gjeografike të natyrës shqiptare dhe vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore, mbi potencialet natyrore dhe njerëzore për zhvillimin ekonomik dhe turistik, mbi problemet gjeografike të sistemeve humane shqiptare: popullsia dhe ekonomia, të shtrira në kohë e hapësirë, mbi bashkëveprimin e ndërsjellë ndërmjet sistemeve natyrore dhe humane, në të gjitha trevat shqiptare. Ai vendos në plan krahasues rajonet me njëri-tjetrin duke synuar të zhvillojë tek nxënësit aftësi të analizës e vlerësimit të tipareve natyrore, demografike, ekonomike e kulturore për çdo rajon dhe njësi gjeografike. Të gjitha trevat shqiptare: Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi trajtohen sipas konceptimit rajonal. Kjo mënyrë trajtimi u jep mundësi nxënësve që t'i njohin të gjitha trevat shqiptare në Ballkan; shkaqet historike të copëtimit; veçoritë natyrore, sociale dhe ekonomike të tyre; shkallën jo të njëjtë të zhvillimit dhe të emancipimit dhe faktorët që i kanë kushtëzuar ato; perspektivat e zhvillimit të tyre në kuadrin e bashkëpunimit midis trevave shqiptare dhe më gjerë në shkallë rajonale, evropiane dhe globale.

Në linjën **Vendndodhja gjeografike** prezantohet një tablo e qartë mbi hapësirën që zënë trevat shqiptare në Ballkan, në Evropë dhe më gjerë. Kjo linjë synon të formojë tek nxënësit koncepte të qarta mbi rëndësinë e

pozitës së trevave shqiptare si në aspektin natyror dhe në atë gjeopolitik. Në këtë mënyrë ata aftësohen të bëjnë analiza krahasuese të ndryshimeve të hartës politike të trevave shqiptare.

Linja **Sistemet fizike** trajton peizazhet e larmishme që ofrojnë trevat shqiptare, ndërtimin gjeologjik dhe relievin e faktorët që ndikojnë në formimin e tij, pasuritë klimatike dhe hidrografike, bota e gjallë e tyre etj, të cilët krijojnë atë diversitet mjaft të spikatur të mjedisëve të trevave shqiptare. Përmes analizës dhe vlerësimit, nxënësit propozojnë rrugëzgjidhje për problemet e shkallës së lartë të degradimit dhe shkretirizimit të peizazheve, një ndër problemet më shqetësuese të mjedisit sot në këto treva.

Në linjën **Sistemet humane**, nxënës/i-ja analizon gjendjen dhe ndikimin e faktorëve ekonomik, social, politik e kulturorë mbi fizionominë dhe dinamikën e popullsisë shqiptare, ekonomisë e sektorëve të saj si dhe ndikimin e organizimit të sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare në zhvillimin e integrimin rajonal dhe evropian të tyre.

Prezantimi i vlerave unike natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, ndikimi i shoqërisë njerëzore në cilësinë e mjedisëve gjeografikë dhe shfrytëzimin e resurseve, përbëjnë piketat kryesore ku fokusohet analiza dhe të nxëniet e nxënësve në linjën **Ndëveprimi njeri/mjedis**. Në këtë mënyrë, nxënësit aftësohen të identifikojnë strategjitë alternative që i përgjigjen politikave të veçanta dhe programeve për përdorimin e burimeve dhe menaxhimin e tyre. Ata jo vetëm njohin dhe evidentojnë potencialet turistike të trevave shqiptare, por parashikojnë mundësitë e mirëmenaxhimit të tyre.

Linja **Rajonet** u krijon nxënësve hapësirë të analizojnë dhe vlerësojnë për çdo rajon tiparet specifike natyrore, demografike, ekonomike, kulturore e sociale, duke i vendosur kështu në plan krahasues me njëri – tjetrin. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë ndikimin e veçorive fizike dhe humane në proceset dhe fizionominë e rajoneve dhe nënrajoneve të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare.

Vend të rëndësishëm në programin e ri zënë trajtimet e problemeve të mjedisit, të cilat janë analizuar për çdo përbërës, si mjedis gjeografik në tërësi dhe sipas rajoneve të veçanta, duke vënë theksin mbi shkaqet e dëmtimit, të ndotjes dhe degradimit të mjedisit, mbi pasojat e këtij dëmtimi, mbi mundësitë dhe rrugët e mbrojtjes së mjedisit, mbi përgjegjësitë e gjithsecilit për mbrojtjen e mjedisit ku ai jeton dhe punon.

1.2.Zhvillimi i aftësive

Korniza kurrikulare e gjimnazit vendos si detyrim të të gjitha lëndëve që të ndihmojnë në zhvillimin e këtyre aftësive bazë tek nxënësit:

- aftësia e përdorimit të matematikës,
- aftësia e komunikimit,
- aftësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK-ut),
- aftësia e mendimit kritik,
- aftësia e mendimit krijues,
- aftësia e zgjidhjes së problemit,
- aftësia e përpunimit dhe përdorimit të informacionit,
- aftësia e qëndrimit etik e social.

Nëse ne do t'i referohemi programeve të gjeografisë për klasat 11-12^{te} të gjimnazit, do të vëmë re se në tërësinë e tyre, krahas kërkesave për zhvillimin e aftësive specifike të fushës/lëndës si p.sh. aftësive të orientimit në hartë, të punës në terren etj, këto programe shtrojnë një sërë kërkesash për mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjeografisë, zbatimi i të cilave kontribuon në zhvillimin të nxënësit të aftësive bazë të listuara më sipër. Gjeografia është një rrugë e njohjes, e përvetësimit të njohurive dhe kuptimit të botës që na rrethon. Programi i kësaj lënde vendos theksin të formimi dhe përdorimi i aftësive pasi kjo gjë u krijon nxënësve mundësinë të zhvillojnë të nxënit aktiv. Ajo që pritet nga nxënësit në studimin e kësaj lënde është zbatimi i aftësive të të menduarit kritik dhe krijues, aftësive hulumtuese dhe të zgjidhjes së problemit, komunikimit efektiv të informacionit.

Aftësi të përdorimit të matematikës

Aftësitë e përdorimit të matematikës kanë të bëjnë me zhvillimin e njohurive, aftësive dhe vlerësimeve të ideve, teknikave dhe zbatimeve matematike. Përpunimi i të dhënave statistikore që lidhen me treguesit ekonomik, lëvizjet e numrit të popullsisë, treguesit e motit etj, kërkon

zbatimin e njohurive dhe veprimeve matematikore. Kështu p.sh. që objektivi “Nxënësi/ja të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikorë, grafikë etj.” të përmbushet nga nxënësit, kjo kërkon që ata të jenë të aftë të ndërtojnë dhe të lexojnë grafikë të llojeve të ndryshme apo të interpretojnë tregues të ndryshëm statistikorë.

Aftësi të kërkimit gjeografik dhe punës në terren

Detyrat e ndryshme që parashikon lënda e gjeografisë, punët praktike, projektet kurrikulare sigurojnë mundësi për investigim në mjedisin ku nxënësit jetojnë dhe përtej. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave nxënësit mbledhin, analizojnë, prezantojnë të dhëna, interpretojnë vëzhgimet e tyre, matin, regjistrojnë dhe vlerësojnë informacionin. Veprimtaria kërkuese e nxënësve lidhet ngushtë me të mësuarit problemor i cili kërkon që nxënësit të gjejnë lidhjet e ndërsjellta, shkaqet dhe pasojat, ligjet dhe ligjësitë gjeografike.

Aftësi të punës me hartën dhe imazhet

Përvoja e mësimdhënies së gjeografisë tregon që hartat mund të konsiderohen si një libër i hapur i mbushur me informacion të shumëllojshëm gjeografik. Njohja dhe zotërimi i saj është një proces mësimor i përditshëm dhe gjithëvjeter si dhe një aktivitet që pason nga klasa në klasë. Mësuesi nuk duhet të synojë të zhvillojë te nxënësit vetëm aftësinë e nxënësve për të njohur dhe lexuar hartën, për t’u orientuar shpejt kur ai vihet para detyrës të gjejë një objekt të caktuar. Është e domosdoshme që nxënësit të aftësohen të analizojnë informacionin e marrë nga harta dhe të arrijnë në përfundime shkencore të kërkuara.

Aftësi të të menduarit kritik dhe krijues

Të menduarit kritik dhe krijues ndihmon në rritjen e shkallës së arsytimit dhe në zgjidhjen e problemeve. Ai u jep mundësinë nxënësve që të shfaqin origjinalitetin e tyre dhe të zhvillojnë prirjet e veta krijuese. Ai synon të aftësojë nxënësin:

 për të mbështetur me argumente dhe fakte, përfundimet, përgjithësimet dhe bindjet e tij;

 për të mbajtur ose për të krijuar qëndrime të pavarura, të mbështetura me argumente ndaj gjykimeve dhe qëndrimeve të tjerëve, ndaj informacioneve në përgjithësi dhe atyre mediatike në veçanti;

 për të marrë parasysh, pa paragjykime, argumentet e të tjerëve;

 për të shqyrtuar alternativat “pro” dhe “kundër” për një çështje të caktuar;

 për të dalluar faktet nga interpretimet e tyre;

 për të përdorur metoda të larmishme për identifikimin e strukturave të informacionit dhe të ideve, p.sh. listat, rrjetet, hierarkitë, matricat, diagramet operative, grafikët, hartat etj.;

 për të shpjeguar lidhjet ndërmjet së tërës dhe pjesëve të saj përbërëse;

 për të zhvilluar një linjë arsyetimi të bazuar në fakte/përfundime/parashikime;

 për të dalluar dhe për të pranuar kufizimet e tyre;

 për të shprehur, nëpërmjet një larmie formash, anët origjinale të personalitetit të tij në shkollë, komunitet dhe punë;

 për të pranuar dhe për të kërkuar ide e rrugëzgjdhje të reja;

 për të mirëpritur ide dhe përvoja të reja të të tjerëve;

 për të ndërmarrë me kurajë plane afatgjata, mbi bazën e analizës së mundësive, të rreziqeve etj.

Aftësi të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

Për të zhvilluar mendimin gjeografik nxënësit sigurojnë dhe përdorin burime informacioni, mbledhin të dhëna, i përpunojnë dhe prezantojnë ato përmes përdorimit të softëve të ndryshme (Ëord, Poëer point, internet broëser/e-mail, atlase elektronike, enciklopedi elektronike,

sistemi informativ gjeografik (GIS), kamerave dixhitale, etj).

Aftësi të bashkëpunimit me të tjerët

Gjeografia ofron një kontekst të larmishëm për zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit, si p.sh:

-  linkurajon punën në ekip përmes punës në terren;
-  nxit studimin në grup përmes detyrave në grup apo projekteve e eseve.

Aftësi të përdorimit dhe të përpunimit të informacionit

Përdorimi dhe përpunimi i informacionit ndihmon nxënësit të bëhen më të efektshëm në një mjedis të tejmbushur me informacion. Për këtë arsye, programi i gjeografisë synon aftësimin e nxënësit:

-  për të siguruar informacione nga burime të larmishme;
-  për të përdorur teknika e forma të ndryshme, me qëllim përfundimin e informacioneve të shkruara, si: përdorimi i pasqyrës së lëndës, i fjalorthëve, i përmbledhjeve në fund të blloqeve tematikë etj.;
-  për të përdorur strategji të ndryshme për të analizuar, për të përpunuar dhe për të interpretuar informacione;
-  për të përzgjedhur burimet e ndryshme të informacionit në përshtatje me qëllimin;
-  për të vlerësuar seriozitetin dhe besueshmërinë e burimeve, duke përdorur kritere, si: autorësia, lidhja, aktualiteti, anshmëria, përvoja e autorit;
-  për të regjistruar, për të organizuar, për të përmbledhur, për të bashkërenduar dhe për të komunikuar informacionet;

1.3.Fusha dhe përmbajtja

Gjeografia është një shkencë sa natyrore, aq edhe shoqërore, pasi në fushën e gjeografisë hyjnë studimi i objekteve dhe dukurive natyrore (gjeografia fizike), por dhe studimi i objekteve dhe dukurive shoqërore (gjeografia ekonomike dhe e popullsisë). Prandaj, për nga gjerësia dhe shumëllojshmëria e synimeve të të mësuarit, gjeografia zë një ndër vendet kryesore midis lëndëve të tjera shkollore.

Në kornizën kurrikulare të gjimnazit gjeografia zë vend si lëndë në fushën e shkencave shoqërore duke luajtur një rol të rëndësishëm në përmbushjen e standardeve të fushës, bashkë me lëndët e tjera si historia, ekonomia dhe qytetaria. Standardet njëhsojnë kërkesat e përbashkëta për zhvillimin e kurrikulave lëndore përkatëse në lidhje me vështirimin historik të zhvillimit të ideve shkencore, zbatimin e rrugës shkencore të njohjes në mësimdhënien-mësimnxënien e lëndëve, lidhjen e mësimi të këtyre lëndëve me teknologjinë dhe matematikën, studimin e gjeografisë në perspektivën personale dhe mjedisore.

Programi i gjeografisë për gjimnazin, sikurse dhe programet e tjera të lëndëve të shkencave shoqërore, zbërthen këto standarde në kërkesa lëndore. Njohuritë nga gjeografia i ndihmojnë nxënësit të adresojnë ndikimin kulturor, ekonomik, social dhe qytetar të të jetuarit në mjedise të ndryshme.

1.4.MUNDËSITË KURRIKULARE PËR INTEGRIMIN E GJEOGRAFISË ME LËNDËT E TJERA

Integrimi i gjeografisë brenda fushës dhe midis fushave kurrikulare

Mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së Gjeografisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve por, duke ritheksuar lidhjen e mësimi të kësaj lënde me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e nxënësve për këtë lëndë.

Lënda e gjeografisë është një nga lëndët bazë të shkencave shoqërore. Njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e shkencave

shoqërore dhe në lëndët e tjera integrohen mjaft mirë me ato të Gjeografisë. Realizimi i integrimit ndërlëndor është ndër detyrat më të vështira, për arsye se çdo lëndë zë një vend të caktuar në planin mësimor të shkollës dhe ka ndërtimin e vet logjik, dhe kjo përcakton radhën e të mësuarit të temave e të kapitujve të lëndëve të ndryshme. Kjo sjell më pas që ndonjë koncept i lëndëve të tjera të merret më përpara se në lëndën e gjeografisë. Për këtë shkak është e domosdoshme të njihet përmbajtja e lëndëve të tjera nga mësuesit e gjeografisë.

Integrimi brenda fushës

Gjeografia duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera brenda fushës së shkencave shoqërore. Lënda e gjeografisë dhe lëndët e tjera të fushës si qytetaria, ekonomia, historia, duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

- Gjeografia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj.
- Lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e gjeografisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë e motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Gjeografia dhe Qytetaria

Lënda e gjeografisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët një sërë konceptesh, si p.sh. mjedis, rend ekonomiko-shoqëror, marrëdhënie njeri-mjedis, marrëdhënie ndërshtetërore, globalizëm, përfaqësimi, liria etj, por dhe një sërë aftësish si p.sh. përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria si dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.



Gjeografia dhe Historia

Lënda e gjeografisë dhe ajo e historisë kanë të përbashkët një sërë konceptesh, si p.sh. bashkësia, ndërvarësia, të drejtat e njeriut, bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj. Përveç kësaj lidhjet e gjeografisë me historinë janë të ngushta për faktin se veçoritë e sotme të gjeografisë së popullsisë dhe të ekonomisë në mjaft raste nuk mund të kuptohen pa njohur të kaluarën historike të rajoneve ose vendeve të ndryshme. Po kështu lidhja e gjeografisë me historinë e vendit tonë përmban vlera të konsiderueshme në realizmin e programit të Gjeografisë së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare.

Lidhjet brenda lëndore të gjeografisë duhen parë edhe në aspektin e lidhjes midis programit të gjeografisë së klasës së 11^{-te} dhe klasës së 12^{-te}. Konceptet bazë të rajonizimit (ç’është rajoni, kriteret e klasifikimit të rajoneve etj) të trajtuara në Gjeografinë rajonale të botës janë të rëndësishme për të kuptuar dhe trajtuar ndarjen rajonale gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe të trevave të tjera shqiptare.

Integrimi me fushat e tjera kurrikulare

Përveç lidhjes dhe integrimit të gjeografisë me lëndët brenda fushës, si element i domosdoshëm për ta parë dhe studiuar botën në mënyrë globale, gjeografia ka nevojë për njohuri dhe aftësi që i zhvillojnë lëndët e tjera jashtë fushës së shkencave shoqërore. Mësuesi duhet të jetë i mirëinformuar paraprakisht, pasi ai ndihmohet për strukturimin e mësimdhënies dhe arritjen e objektivave mësimorë të programit të gjeografisë.

Gjuha

Gjuha është themelore për të nxënin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësit përzgjedhin strategjitë e përshtatshme gjuhësore dhe proceset për të ekspluar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e tyre shkencor dhe proceset. Me lëndën e *gjuhës* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e eseve, gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve mediatike, të shkruarin, të lexuarin dhe komunikimin e informacioneve të gjeografisë. Aftësitë e analizave kritike dhe logjike dhe të menduarit reflektiv rreth ideve shkencore mbështeten në përdorimin e fjalorit gjeografik. Nxënësit të cilët shprehin një ide shkencore në formë të

ndryshme gjuhësore thellojnë të kuptuarin e tyre konceptual dhe zgjerojnë aftësitë e tyre në komunikimin e njohurive të të tjerëve.

***Shembull:** Në programin e gjeografisë së klasës së 11^{-të}, nxënësit përgatisin një ese vlerësuese për raportin që ekziston midis globalizimit dhe veçorive kulturore të vendeve apo rajoneve të ndryshme gjeografike sot në botë. Po kështu, në programin e gjeografisë së klasës së 12-të, nxënësit realizojnë një detyrë kërkimore mbi zonat e mbrojtura natyrore, pasurinë e tyre, tërheqjen e turistëve drejt tyre, ndikimin e zhvillimit të turizmit mbi to. Kjo kërkon që ata më parë të kenë njohuri mbi mënyrën e përgatitjes së një eseje dhe për llojet e ndryshme të saj.*

Matematika

Duhet bërë lidhje të qarta ndërmjet gjeografisë dhe matematikës. Në gjeografi nxënësit zbatojnë matematikën përmes përdorimit të numrave, masave, gjatësisë dhe kohës, interpretimit të të dhënave dhe përdorimit të rrugëve grafike, simboleve, tabelave për prezantimin e informacionit.

***Shembull:** Nxënësit analizojnë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikor, grafik etj. Kjo kërkon që ata të përdorin njohuritë e marra në matematikë mbi veprimet me thyesa, ndërtimin e grafikëve etj.*

Sipas mënyrës së ndërtimit, grafikët ndahen në:

- Grafikë me anë figurash gjeometrike, të cilat quhen dhe diagrame;
- Grafikë me anë hartash gjeometrike (kartograme dhe kartodiagrame);
- Grafikë me anë figurash natyrore ose simbole.
- ***Grafikë me anë figurash gjeometrike, të cilat quhen dhe diagrame:***
 - ◆ Diagramet lineare, paraqesin dinamikën e dukurisë në mënyrë të pandërprerë, duke dhënë dhe vazhdimësinë e procesit;
 - ◆ Diagramet me kolona vertikale prezantojnë të njëjtën dinamikë sikurse diagramet linerare;
 - ◆ Diagramet që paraqesin strukturën e dukurive, ndërtohen zakonisht si rrihtë të ndarë në pjesë, në sektorë.
- ***Grafikë me anë hartash gjeometrike (kartograme dhe kartodiagrame):***

- ◆ Kartogramet janë formë e paraqitjes grafike me anë të hartave;
- ◆ Kartodiagrami bashkërendon kartogramin me diagramin, p.sh. në hartën e popullsisë krahas shpërndarjes së popullsisë sipas rretheve (që saktësohet me ngjyrat e përdorura), në çdo rreth vendoset një diagram rrethor që paraqet strukturën e popullsisë qytet-fshat.
- ***Grafikë me anë figurash natyrore ose simbole:***
Në grupin e tretë të grafikëve futen ata me figura natyrore e simbole të cilat përdoren që të tërheqin më shumë vëmendjen e nxënësve.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të mësuarit e lëndës së gjeografisë në realizimin e detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit.

Nxënësit mund të përdorin ëord-processor në shkrimin e materialeve dhe punëve praktike në lëndën e gjeografisë, zbatojnë hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdorin PoëerPoint për prezantimin e një raporti, materiali informues, projekti kërkimor përmes paraqitjes në slide (p.sh., një projekt (individual ose në grup) mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë) apo kërkojnë në Internet (të dhëna p.sh., për rajonet më të mëdha të gjuhëve në Evropë dhe hartën e shpërndarjes së tyre), informacion (p.sh., tornadot dhe pasojat), harta (fizike, ekonomike, turistike, etj), imazhe satelitore.

Mësuesi i gjeografisë, sikurse dhe të gjithë mësuesit e tjerë të shkollës, duhet të përpiqet t'u japë jetë në shkollë të gjitha rrugëve integruese të kurrikulës. Kjo sepse:

- Programet e integruara mundësojnë kalimin nga një kuptim sipërfaqësor i ngjarjeve dhe dukurive të shumta të izoluara në lëndët e veçanta, në një depërtim më të thellë në përgjithësi të tyre, çka hap rrugë drejt kuptimit të vërtetë të këtyre ngjarjeve dhe dukurive.
- Programet e integruara sigurojnë për nxënësit një vizion të

njëhsuar të njohurive, çka motivon dhe zhvillon aftësitë e tyre për të perceptuar e zgjidhur më mirë situata të reja në jetën bashkëkohore.

- Kurrikula e integruar, ashtu si dhe kërkimi shkencor, ka si objekt probleme konkrete praktike në lidhje domethënëse, për t'u fokusuar në fusha të gjera studimi. Në këtë mënyrë kurrikula e integruar shqyrton mësimdhënien dhe nxënien në mënyrë holistike dhe reflekton botën e vërtetë ndërvepruese.
- Përmes kurrikulës së integruar, nxënësi kupton, ndjek dhe përfiton nga zhvillimet e sotme tepër të shpejta të shkencave aplikative. Kjo rrit së tepërmi interesin dhe angazhimin e nxënësve për të kuptuar përmbajtjen e mësimin dhe për t'u thelluar në të.
- Mësimi i integruar përmes studimit dhe zgjidhjes së problemeve brenda dhe përgjatë përmbajtjes së lëndëve, si dhe në jetën jashtë shkollore, mundëson që nxënësit të arsyetojnë në një kuptim më të thellë dhe më të gjerë rreth informacioneve shkencore.
- Veprimtaria e integruar mësimore kërkon pjesëmarrje në projekte, realizimi i të cilave bëhet përmes punëve të frytshme kolegjiale, ku çdo pjesëtar luan një rol aktiv.
- Mësimi i integruar bëhet motivues për të nxënësit mbasi i lë mjaft hapësira të nxënësit zbulues. Gjatë të nxënësit zbulues atmosfera e klasës nxit konkurimin dhe bashkëpunimin, të gjithë pjesëtarët e grupit punojnë për një qëllim të vetëm duke shkëmbyer mes tyre materialet dhe përgjegjësitë. Ky bashkëveprim është i pëlqyeshëm nga nxënësit dhe bëhet pjesë e procesit të të nxënësit.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten kërkesat e gjeografisë në të dy klasat e gjimnazit, klasa e 11^{-të} dhe e 12^{-të} ndaj lëndëve të tjera.

KËRKESA TË LËNDËS GJEOGRAFIA RAJONALE E BOTËS NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjeografia	Matematika
- Temat lidhur me lëvizjet demografike, rajonet social-ekonomike, zhvillimi i sektorëve të ekonomisë.	Nxënës/i- ja: - të mbledhë, përpunojë dhe interpretojë të dhënat statistikore matematikisht dhe grafikisht (tabela, grafikë, diagrama etj).
Gjeografia	TIK
- Në punët praktike, punën me projekte, në një pjesë të madhe temash.	Nxënës/i- ja: - të përdorë programet bazë (Ëord, Poëer Point, Exel etj), që i duhen për përgatitjen dhe prezantimin e punëve të pavarura dhe me projekte; - të kërkojë në Internet (të dhëna, informacion, harta tematike, fizike, imazhe satelitore etj).
Gjeografia	Qytetaria
- Rajonet kulturorë - Rajonet politikë	Nxënës/i-ja: - të shpjegojë kulturën dhe elementët e saj; - të analizojë bashkëpunimin, konfliktin dhe rrugët e zgjidhjes së tij; - të shpjegojë konceptet shtet, komb, kombësi, etni, demokraci, globalizëm.
Gjeografia	Ekonomia
- Rajonet social-ekonomik, BE	Nxënës/i-ja: - të shpjegojë konceptet ekonomi tregu, prodhim i përgjithshëm, bashkim ekonomik, bashkim doganor, integrim, papunësi, inflacion, GDP.
Gjeografia	Historia
- Ndryshimet shoqërore, historike, kulturore, politike të rajoneve.	Nxënës/i-ja: - të përshkruajë kthesat e mëdha historike që kanë ndikuar fort në zhvillimin politik, social e ekonomik të rajoneve dhe vendeve në botë.

Gjeografia	Gjuha shqipe
- Për të gjithë blloqet tematikë	Nxënës/i-ja: - të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit; - të përdorë aftësitë e komunikimit; - të përgatisë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese; - të përzgjedhë informacionin e duhur në një vëllim të caktuar; - të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një detyrë tematike.

KËRKESAT E LËNDËS GJEOGRAFIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE E TREVAVE TË TJERA SHQIPTARE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjeografia	Matematika
- Temat lidhur me lëvizjet demografike, rajonet social-ekonomike, zhvillimi i sektorëve të ekonomisë.	Nxënës/i-ja: - të mbledhë të dhënat statistikore, t'i përpunojë dhe interpretojë ato matematikisht dhe grafikisht (tabela, grafikë, diagrame etj).
Gjeografia	TIK
- Në punët praktike, punën me projekte, në një pjesë të madhe temash.	Nxënës/i-ja: - të përdorë programet bazë (ëord, Poëer Point, Exel etj), që i duhen për përgatitjen dhe prezantimin e punëve të pavarura dhe projekteve; - të kërkojë në Internet (të dhëna, informacion, harta tematike, fizike, imazhe satelitore etj).
Gjeografia	Historia

- Harta politike e trevave shqiptare - Organizimi administrativ i trevave shqiptare - Popullimi i trevave shqiptare - Trevat shqiptare në Kosovë	Nxënës/i-ja: - të shpjegojë vendimet e Kongresit të Berlinit. - të përshkruajë vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër; - të njohë rezultatet e shpalljes së pavarësisë; - të shpjegojë ngjarjet e luftës në Kosovë deri në shpalljen e shtetit të pavarur. - të përshkruajë organizimin e Mbretërisë Ilire në bashkësi federative; - të përshkruajë organizimin e territorit shqiptar nën pushtimin romak ; - të interpretojë ndarjen e trevave shqiptare në Perandorinë Bizantine në “thema”, organizimin e trevave shqiptare në mesjetë. - të argumentojë lashtësinë e popullit shqiptar; - të analizojë pushtimin osman dhe pasojat; - të përshkruajë Luftën e Dytë Botërore dhe pasojat e saj. - të përshkruajë historinë e shkëputjes së Kosovës nga trojet shqiptare deri në shpalljen e republikës.
Gjeografia	Gjuha shqipe
- Për të gjithë blloqet tematikë	Nxënës/i-ja: - të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit; - të përdorë aftësitë e komunikimit; - të përgatisë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese; - të përzgjedhë informacionin e duhur në një vëllim të caktuar; - të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një detyrë tematike.

1.5.OBJEKTIVAT E ARRITJES

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh., objektiv: “Të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore” kërkon që të gjithë nxënësve t'u jepet mundësia të analizojnë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

P.sh., objektiv: “Të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore” kërkon që të gjithë nxënësve t'u jepet mundësia të analizojnë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të këtij koncepti.

Një nivel arritjeje është identifikimi i modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Një nivel më i lartë se ky është përshkrimi i modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Një nivel edhe më i lartë do të ishte analiza e modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, diferencat dhe të përbashkëtat.

Objektivat e programit realizohen edhe nëpërmjet veprimtarive praktike dhe projekteve. Për të arritur objektivat, nxënësit duhet të bëjnë lidhjen ndërmjet përvojave konkrete dhe koncepteve abstrakte. Mësuesit duhet t'i nxitin nxënësit të eksplorojnë, të kryejnë vëzhgime dhe punë në terren, dhe të përdorin teknologjinë gjatë studimit të gjeografisë.

Objektivat që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit me anë të teknologjive të komunikimit dhe informimit, nuk kanë për qëllim vetëm mbledhjen dhe renditjen e informacionit të kërkuar, por ndërveprimin aktiv të nxënësit me këto teknologji në procesin e të nxënit.

Kujdes i veçantë duhet treguar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive intelektuale dhe sociale të nxënësve, si ato të debatimit, diskutimit, punës në grup etj.

Objektivat e arritjeve

Lidhur me *objektivat e arritjeve*, termi “arritje” u fut në literaturën pedagogjike shqiptare në vitet ’90 të shekullit të kaluar për të përshtatur në shqip termin “*performance*” (anglisht dhe frengjisht), i cili përdoret për të treguar ato *dije, shprehje dhe qëndrime që nxënësi i demonstroi (i shfaq) në formën e veprimtarive dhe sjelljeve të ndryshme që ai kryen, të cilat janë të vëzhgueshme nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë, madje, shpesh herë, edhe të matshme*. Objektivat e arritjeve (performancës) janë e njëjta gjë me objektivat e sjelljes ose të veprimit. Një objektivi i programit mund të jetë i niveleve të ndryshme taksonomike, p.sh. nëse programi kërkon që nxënësi të krahasojë këtë me atë, ky objektivi është i nivelit bazë. Objektivat e programit janë të niveleve të ndryshme, në fushën e njohjes, të aftësive dhe qëndrimeve. Niveli i të nxënit të pritshëm rritet kur zhvendosemi nga të njohurit, në të kuptuarit dhe më pas në zbatim, analizë, sintezë dhe vlerësim.¹

Në tabelën e mëposhtme është bërë një ndarje e objektivave të programit sipas linjave dhe blloqeve tematike në tre nivelet e reduktuara të taksonomisë së Blumit (Bazë - njohje dhe kuptim; Mesatar - zbatim dhe analizë; I lartë - sintezë dhe vlerësim). Kjo për t’i ardhur në ndihmë mësuesit në përcaktimin e niveleve të arritjeve të nxënësve nisur nga objektivat e programit.

Në Shtojcë gjeni tabelën e taksonomisë konjitive të Blumit

Gjeografia Rajonale e Botës - Klasa e 11-të

Linja: Rajonet

Bloku tematik: Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të përshkruajë objektin e studimit të kësaj lënde, përmbajtjen dhe vendin e saj në kuadër të gjeografisë; - të dallojë ndërlidhjen e gjeografisë rajonale me disiplina të tjera; - të identifikojë tipet dhe llojet kryesore të rajoneve të botës; - të grumbullojë informacione nga burime të ndryshme rreth tipeve e llojeve të rajoneve; - të përshkruajë rolin dhe rëndësinë që luajnë në rajone të ndryshme organizmat ndërkombëtarë (p.sh. OKB, UNICEF etj); - të plotësojë hartat skicë (fiziko-gjeografike) të makrorajoneve të botës.
Niveli mesatar	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të identifikojë kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe të klasifikimit të rajoneve të ndryshme sipas llojeve apo tipeve të tyre; - të grumbullojë dhe përdorë informacione nga burime të ndryshme rreth tipeve e llojeve të rajoneve; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve kulturore botërore (qeverisja, etniciteti, gjuha, sistemi ekonomik); - të grumbullojë informacione nga burime të ndryshme (enciklopedi, Internet, materiale të tjera burimore etj) mbi rajonet më të mëdha të gjuhëve në Evropë dhe hartën e shpërndarjes së tyre; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve ekonomike përmes shembujve tip.

Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të analizojë temat bazë në gjeografi, si: pozicioni, rajoni, marrëdhëniet njeri-mjedis dhe proceset; - të analizojë kuptimin e koncepteve taksonomike të niveleve të ndryshme si makro-rajon, rajon etj; - të analizojë e vlerësojë proceset e sotme integruese dhe marrëdhëniet në nivele të ndryshme: lokale, rajonale e globale; - të vlerësojë tendencat e sotme globalizuese, problemet në këtë proces; - të argumentojë qëndrimet pro dhe kundra ndaj këtyre proceseve; - të vlerësojë nivelet e problemet e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre; - të analizojë rajonet kulturore të botës së sotme përmes shembujve; -të vlerësojë përmes një eseje raportin që ekziston midis globalizimit dhe veçorive kulturore të vendeve apo rajoneve të ndryshme gjeografike sot në botë; - të realizojë në grup një CD apo videokasetë që prezanton fizionominë (veçoritë fiziko-gjeografike, popullsinë, ekonominë, kulturën etj.) e një makrorajoni apo rajoni gjeografik.
----------------	--

Bloku tematik: Evropa - Karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të vlerësojë rolin e pozitës gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme rajonale të Evropës; - të evidentojë rajonet kryesore të Evropës (Evropa Perëndimore, Qendrore, ishullore,Veriore, Mesdhetare, Lindore); - të identifikojë problemet e sotme rajonale të Evropës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre.
-------------	---

Niveli mesatar	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të vlerësojë zhvillimin historiko-territorial rajonal të Evropës; - të interpretojë historikun e karakteristikat e formimit, zhvillimit e zgjerimit të BE; - të diskutojë mbi ndryshimet politike që ka pësuar Federata Ruse pas rënies së murit të Berlinit e deri sot.
Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i-ja: - Të analizojë veçoritë specifike rajonale natyrore e humane të Evropës; - të realizojë në grup një projekt kërkimor mbi rolin që ka Bashkimi Evropian në bashkëveprimin ekonomik, kulturor, politik rajonal; - të vlerësojë makrorajonin rus, proceset dhe problematikat e sotme të perspektivës rajonale e globale.

Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare - Klasa e 12-të

Linja: Rajonet gjeografikë

Bloku tematik: Rajonet gjeografikë të trevave shqiptare

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të identifikojë kriteret e përcaktimit të rajoneve gjeografike të trevave shqiptare, ndarjen rajonale të tyre dhe tipat e rajoneve.
--------------------	---

Bloku tematik: Republika e Shqipërisë

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të identifikojë kriteret e përcaktimit të rajoneve gjeografike të trevave shqiptare, ndarjen rajonale dhe tipat e rajoneve; - të përshkruajë veçoritë kryesore natyrore të secilit rajon dhe potencialet natyrore për zhvillim; - të evidentojë karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; - të evidentojë tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të kufizuar të Rajonit Verior-Verilindor; - të dallojë veçoritë natyrore, demografike e ekonomike të Rajonit Juglindor; - të evidentojë pasuritë e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Juglindor.
Niveli mesatar	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të analizojë tiparet specifike natyrore, demografike dhe ekonomike që dallojnë Republikën e Shqipërisë nga trevat e tjera shqiptare dhe faktorët e diferencimit të saj rajonal; rajonet gjeografikë; - të analizojë urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; - të krahasojë hartat ekonomike të zhvillimit të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme; - të analizojë tendencën e ndryshimeve demografike të Rajonit Verior- Verilindor me problematikat që e shoqërojnë; - të analizojë tiparet e përgjithshme natyrore dhe humane që dallojnë Rajonin Jugor nga rajonet e tjera.

Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian; - të vlerësojë diversitetin e hapësirave të prodhimit bujqësor e industrial, sektorit terciar, rrjetin e transportit dhe rolin e tij në prirjen e organizmit të ri hapësinor të Rajonit Perëndimor; - të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor për qëllime turistike, shkencore etj; - të parashikojë mundësitë e perspektivës së zhvillimit të Rajonit Perëndimor; - të realizojë në grup një projekt mbi veçoritë e urbanizimit të Rajonit Perëndimor dhe pasojat e tij; - të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor për qëllime turistike etj; - të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë; - të realizojë një projekt (individual ose në grup) mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë;
----------------	--

Blloku tematik: Republika e Kosovës

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të përshkruajë Republikën e Kosovës si një rajon gjeografik me kufi të qartë natyror dhe politik, veçori specifike fiziko-gjeografike, demografike dhe ekonomike; - të evidentojë diferencimin rajonal dhe tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor dhe Lindor të Kosovës.
-------------	--

Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian; - të zhvillojë një projekt mbi mundësitë e ardhshme të integritimit politik dhe ekonomik të Kosovës në Evropë.
-----------------------	---

Bloku tematik: Trevat shqiptare në Serbi

Niveli bazë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të identifikojë trevat shqiptare në Serbi (Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën), duke vlerësuar statusin politik, veçoritë specifike natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre.
--------------------	---

Bloku tematik: Trevat shqiptare në Maqedoninë perëndimore

Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i -ja: - Të vlerësojë statusin politik të trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore me tiparet e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike që i dallojnë ato nga trevat e tjera shqiptare.
-----------------------	--

Bloku tematik: Trevat shqiptare në Mal të Zi

Niveli i lartë	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të vlerësojë statusin politik dhe rëndësinë e pozitës gjeografike dhe gjeopolitike të trevave shqiptare në Mal të Zi, veçoritë e tyre natyrore, demografike dhe ekonomike.
-----------------------	--

Bloku tematik: Trevat shqiptare në Greqi

Niveli mesatar	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - T analizojë kushtet specifike të trevave shqiptare në Greqi me vlerat e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre.
-----------------------	--

1.6.OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË ARRITJES NË KURRIKULËN BËRTHAMË TË LËNDËS GJEOGRAFI

Mësues të ndryshëm duhet të kuptojnë të njëjtën gjë nëpërmjet të njëjtave terma. Me fjalë të tjera, objektivi duhet të përcaktohet, mundësisht, me një kuptim të vetëm. *Objektivat e arritjeve të një kapitulli, përbëjnë bashkësinë e të gjitha objektivave specifike të hartuara për të gjitha objektet e kapitullit, ose linjës, të ndarë në tre nivele, duke u nisur nga objektivat e programit, ose nga standardet (nëse ka të tilla për lëndën).*

Mësuesi duhet të hartojë objektiva specifike në tre nivele kundrejt objektivave të programit. Përsa i përket hierarkisë së arritjeve të nxënësve, do të përdorim tri nivelet: niveli **bazë** (më i ulët) i arritjeve, niveli **mesatar** dhe niveli i **lartë**. Ndarja në nivele e objektivave të arritjeve është më e vështirë se edhe vetë formulimi i objektivave. Objektivat e kapitujve në program mund të mos ndjekin renditjen e temave të mësimi, prandaj mësuesi duhet të bëjë një rishpërndarje të objektivave sipas temave.

Gjatë mësimdhënies, çdo objektivi i programit degëzohet në disa objektiva të ndërmjetëm, ose **nënoobjektiva**, të cilat përshkruajnë arritjet hap pas hapi të nxënësit, deri te përmbushja e objektivit të degëzuar. Kështu, për shembull që nxënësi të bëhet i aftë të interpretojë shkaqet e degradimit

dhe ndotjes së mjedisit, ai duhet të bëhet i aftë të përkufizojë mjedisin, ndotjen e mjedisit, të listojë disa nga shkaqet e ndotjes së mjedisit dhe së fundmi t'i interpretojë ato. Këta objektiva që përshkruajnë arritjet hap pas hapi të nxënësit njihen si objektiva specifike. Një objektiv specifik është objektiv veprimi, objektiv veprimtarie, objektiv sjelljeje. Ai është objektiv i të nxënësit, sepse si çdo objektiv tjetër, ai përshkruan se çfarë do të jetë i aftë të bëjë nxënësi dhe jo se çfarë ka ndërmend, apo se çfarë do të bëjë mësuesi në orën e mësimit (kjo e fundit ka të bëjë me qëllimet).

Kur mësuesit hartojnë **objektivat specifike** (për **objekte** të caktuara mësimore), arritja e **dukshme** bëhet e përcaktuar plotësisht, madje tani tregohen edhe **kushtet** në të cilat ajo pritet të shfaqet, si dhe **kriteret** e saktësisë së përmbushjes (plotësimi) të arritjes së synuar.

Shembull: Në përfundim të orës së mësimit, nxënësi do të jetë i aftë:

të identifikojë vendet ballkanike duke treguar në hartë 5 prej karakteristikave të përgjithshme fiziko-gjeografike të relievit.

1. **Veprimtaria e vëzhgueshme** : të identifikojë
2. **Objekti (produkti)**: vendet ballkanike
3. **Kushtet**: duke treguar në hartë
4. **Kriteret** : 5 prej karakteristikave të përgjithshme fiziko-gjeografike të relievit.

Në shembujt e mëposhtëm të objektivave të sjelljes, VEPRIMTARIA dhe OBJEKTI (PRODUKTI) janë dalluar me shkronja të theksuara, KUSHTET janë me shkronja korsive, kurse KRITERI është mbyllur në kllapë të rrumbullakët.

Shembuj:

Nxënësit të jenë të aftë:

a. **Të thonë përmendësh emrat (e 10) qyteteve kryesore të Shqipërisë (pa ndërprerje).**

VEPRIMTARIA- “Të thonë”

OBJEKTI (PRODUKTI) : “ emrat e 10 qyteteve kryesore të Shqipërisë“

KUSHTI: “*përmendësh*”.

KRITERI: 10 kryesorët, pa ndërprerje.

b. *Në një hartë pa emra të identifikojnë* (vetëm katër kryesorët,) **lumenjtë e Shqipërisë**, të përshkruara në tekstin mësimor.

c. **Të shpjegojnë me gojë** (saktë dhe në mënyrë të përmbledhur) **shkaqet e lëvizjeve të popullsisë në Shqipëri**, duke u mbështetur në *tekstin mësimor* (për një kohë prej 5 minutash).

d. **Të shpjegojë saktë me fjalët e tij rolin e Shqipërisë në zgjidhjen e problemeve rajonale.**

Më poshtë po japim disa shembuj të formulimit të objektivave specifike të arritjes nisur nga objektivat e programit të lëndës Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare.

Objektivat specifike

Linja: Rajonet gjeografike

Blloku tematik: Rajonet gjeografike të trevave shqiptare

Objektivat e programit: - Të vlerësojë diversitetin e hapësirave të prodhimit bujqësor e industrial, sektorit terciar, rrjetin e transportit dhe rolin e tij në prirjen e organizmit të ri hapësinor të Rajonit Perëndimor; - të realizojë në grup një projekt mbi veçoritë e urbanizimit të Rajonit Perëndimor dhe pasojat e tij; - të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe europian; - të vlerësojë statusin politik të trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi; - të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë.	Objektivat specifikë: - Të përshkruajë diversitetin e hapësirave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në Rajonin Perëndimor; - të analizojë veçoritë natyrore të rajonit si faktor pozitiv në zhvillimin e ekonomisë; - të vlerësojë diversitetin e këtyre hapësirave për zhvillimin aktual dhe në perspektivë të rajonit; - Të identifikojë veçoritë demografike të Rajonit Perëndimor (shtimi i numrit të popullsisë, tiparet strukturore të popullsisë së rajonit); - të analizojë faktorët që kanë çuar në rritjen e numrit të popullsisë, ndryshimet e strukturës moshore, gjinore etj; - të realizojë në grup një projekt mbi veçoritë e urbanizimit të Rajonit Perëndimor dhe pasojat e tij; - të evidentojë potencialet natyrore dhe humane të Kosovës - të shpjegojë se si ndikojnë këto potenciale në integrimin rajonal dhe europian; - të argumentojë se si mund të orientohet zhvillimi i ardhshëm ekonomik i Kosovës nëpërmjet potencialeve që paraqet; - të evidentojë përqindjen e pakicave kombëtare shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi; - të analizojë statusin politik të tyre aktualisht; - të gjykojë duke u bazuar në argumentat e dhëna, statusin aktual të tyre ; - të identifikojë llojet e transportit në Rajonin Juglindor - të analizojë zhvillimin e transportit automobilistik dhe hekurudhor të rajonit; - të parashikojë mundësitë e zhvillimit të llojeve të ndryshme të transportit në këtë rajon; - të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të rajonit, duke vlerësuar rolin e tij në integrimin rajonal me shtetet fqinjë dhe më gjerë.
---	--

2.METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Në pragun e një reforme kurrikulare e rëndësishme është që ndryshimet e pritshme, në përbërës të caktuar të saj, të përfshijnë edhe problemet e të mësuarit dhe të të nxënësve. Suksesi në shkollë kërkon një proces mësimor aktiv, të rinovuar në përmbajtje e në formë, gjë që gjen shprehjen konkrete në përdorimin e metodave, strategjive e teknikave mësimore bashkëkohore *ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse*.

Metodat e të mësuarit shikohen jo vetëm si një proces didaktik, që pasurohen gjithnjë me elementë të rinj, por edhe që duhet të zbatohen në mënyrë krijuese. Gjatë orëve të ndryshme të mësimin, metodat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre. Kështu ndodh me shpjegimin e bisedën, me metodën problemore e kërkimore etj. Prandaj vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por edhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj. Ndër to mund të theksojmë:

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi fillon në çastin kur nxënësit drejtojnë pyetje dhe kur një nxënës përgjigjet për atë që ka thënë një nxënës tjetër. Pra kjo metodë është një përzierje e shpjegimeve mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre.

Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, fenomeneve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e gjeografisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit te nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Diskutimi duhet parë si një metodë që përdoret për të realizuar një veprimtari me të gjithë klasën, si një diskutim i vërtetë, me pjesëmarrjen ndëraktive të të gjithë nxënësve dhe me fokus jo rrëfimin dhe dëgjimin e

mësimi të riprodhuar por mbi bazën e hetimit dhe të zbulimit. I parë në këtë mënyrë, diskutimi karakterizohet nga:

- Eksplorimi i ideve, koncepteve dhe çështjeve;
- Avancimi mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve duke përparuar në mënyrë graduale;
- Ndërveprimi midis të gjithë pjesëmarrësve;
- Zhvendosje e lidhshirë mes pjesëmarrësve;
- Të pyeturit, shkëmbimi, ndryshimi, hamendësimi nga ana e të gjithë pjesëmarrësve;
- Pjesëmarrje e nxënësve në vendimmarrje;
- Ngritja e hipotezave dhe zgjidhja e problemeve.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i-ja mund të zhvillojë me nxënësit diskutime për tema të cilat mund të pikënisin nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Kështu p.sh në lëndën e Gjeografisë Rajonale të Botës, mësuesit mund të nxisin diskutimet e nxënësve për tematika të veçanta në varësi të specifikave të rajoneve, si p.sh:

për rajonin e Evropës, diskutimin: Popujt që bëjnë diferencën.

për Evropën Juglindore: Mundësitë e integritetit të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit Perëndimor në BE.

për rajonin e Amerikës Veriore: Dygjuhësia në Kanada.

për rajonin e Amerikës Qendrore: Vlerësimi i klimës si element i rëndësishëm i turizmit.

për Amerikën Jugore: Amazona, perspektiva dhe problemet.

për Afrikën: Lufta për të drejtat e njeriut.

për Azinë Lindore: Artet marciale.

për Australi-Oqeaninë: Aborigjenët.

Vrojtimi është një metodë që e vë nxënësin në rolin e vëzhguesit, duke kërkuar që ai të vrojtojë dhe të mbajë shënim për gjithçka që ndodh gjatë procesit të vëzhgimit, ose të fotografojë raste të veçanta gjatë vëzhgimit, të përpunojë dhe të publikojë përfundimet.

Kjo është një metodë shumë e përdorshme në aktivitetet e ndryshme për vëzhgimin e proceseve dhe dukurive të ndryshme gjeografike. Për

shembull, nëse nxënësit do të vrojtojnë fenomenin e erozionit nga forcat e jashtme, atëherë kërkohet një farë kohe, një aparat fotografik për të fiksuar raste tipike etj.

Për të realizuar këtë metodë kalohet në hapat e mëposhtëm:

- Parapërgatitja. Ky hap ka të bëjë me paraqitjen para nxënësve të dukurisë që do të vëzhgohet, njohjen me qëllimin, kohën dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve dhe dokumentimin.
- Mbledhja e të dhënave dhe fakteve gjatë vrojtimit. Për këtë nxënësit përdorin teknika dhe mjete të ndryshme.
- Përpunimi i të dhënave. Sipas udhëzimeve të mësuesit nxënësit përpunojnë të dhënat duke përgatitur tabela, montimin e fotove, bëjnë paraqitje grafike etj.
- Raportimin e përfundimeve. Nxënësit raportojnë në klasë dhe shpallin përfundimet e vrojtimit që kanë kryer. Ky moment mund të bëhet dhe më gjerë se sa me klasën, në nivel shkolle apo dhe të publikohen në shtyp.

Vlera të mëdha për formimin e koncepteve të drejta gjeografike kanë vëzhgimet në terren, pasi në këtë mënyrë realizohet lidhja ndërmjet koncepteve abstrakte që nxënësit marrin me objektet gjeografike të vrojtuar. Sa më të shumta të jenë vëzhgimet në terren, aq më të pasura e më të qëndrueshme do të jenë përfytyrimet që krijohen.

Zgjidhja e problemit Procesi i hulumtimit, si në jetën reale, ashtu dhe në mësimin e gjeografisë, realizohet nëpërmjet një sërë formash të zgjidhjes së problemit. Kjo metodë është një nga metodat e njohura që synon zgjidhjen e një problemi apo të një çështjeje të caktuar që lidhet me problematikën që trajtohet në shkollë, duke e studiuar atë. Problemi i marrë në shqyrtim mund të jetë kompleks që kërkon aftësi të mëdha dhe kurajo për të arritur deri në zgjidhjen e tij, ose mund të jetë i thjeshtë saqë zgjidhja mund të jetë pothuajse automatike. Por, në secilin rast, veprimtaritë për zgjidhjen e problemit janë ato që kërkojnë të menduar të thellë dhe kërkim për të shkuar drejt zgjidhjes së problemit.

Përgjithësisht, çdo veprimtari të nxëni, në të cilën nxënësit i duhet të kërkojë, të hulumtojë ose të mendojë për përgjigjet, është një veprimtari e realizuar me metodën e zgjidhjes së problemit. Megjithatë, as mësuesi dhe as nxënësit nuk mund të quajnë një veprimtari si zgjidhje e problemit në qoftë se përgjigjet mund të gjenden nga një proces i thjeshtë njohjeje dhe kujtese.

Në përgjithësi procesi vijon si më poshtë:

1. Identifikimi dhe njohja e problemit i cili mund të lindë dhe të fillojë si rastësisht ose i sugjeruar dhe shtruar për zgjidhje nga ana e mësuesit. Njohja e nxënësve me problemin dhe rënia dakord për të bërë diçka për ta zgjidhur apo dhënë një përgjigje.
1. Kërkimi i momenteve kyç që të çojnë drejt zgjidhjes së problemit.
 - a. Të menduarit e zgjidhjeve të mundshme (hipotezave) ose të trajtimeve të ndryshme që duhen marrë parasysh në zgjidhjen e problemit.
 - b. Testimi i zgjidhjeve apo trajtimeve të mundshme kundrejt kriterëve që do t'i ndihmojnë nxënësit t'i vlerësojnë ato ashtu siç duhet.
1. Reagimi apo kundërshtimi ndaj zgjidhjeve apo trajtimeve të mundshme që nuk i përgjigjen kërkesave të dhëna dhe përpjekja për të tjera derisa të gjendet ajo më e përshtatshme. Mësuesi në dhënien e konkluzioneve, pranon zgjidhjen apo trajtimin që duket më i përshtatshëm ose mund të testojë të gjithë hipotezat e dhëna për të gjetur atë më të mirën.

Aftësia e nxënësve për të zgjidhur një problem, veçanërisht të një natyre akademike, nuk duket se është e natyrshme për ta. Aftësia në zgjidhjen e problemeve është një zotësi që mund të mësohet, kështu që duhet mësuar. Në qoftë se mësuesi i vëzhgon nxënësit me kujdes në çdo hap të procesit të zgjidhjes së problemit, atëherë ai do të ketë mundësi jo vetëm të ndihmojë nxënësit në zgjidhjen e problemit, por gjithashtu do t'i ndihmojë ata të përmirësojnë teknikat që njohin kur zbatojnë këtë metodë. Nxënësit kanë nevojë për ndihmë në gjetjen e pyetjeve që duhen drejtuar për të pyetur dhe hetuar. Kështu, përmbajtja e gjeografisë së popullsisë dhe asaj të ekonomisë është mjaft e përshtatshme për të përdorur metodën e shtjellimit problemor. Në këto pjesë mësuesi mund të shtrojë dhe të shqyrtojë probleme që lidhen me zhvillimin demografik, me perspektivat e zhvillimit të industrisë, bujqësisë, transportit, turizmit etj.

Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave ***problemore, gjysmë kërkimore dhe kërkimore, si mësimi zbulues, projekti mësimor***. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta etj. Nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë:

- ***detyra tematike*** (si p.sh. të realizojnë një detyrë tematike mbi

mjedisin dhe problemet mjekësore që shoqërojnë Afrikën Nën-Sahariane përmes hulumtimit në Internet, enciklopedi, materiale të tjera burimore etj) - Gjeografia Rajonale e Botës; (të vlerësojë përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare, duke i parë dhe trajtuar ato në kushtet e integritetit rajonal dhe evropian) - Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare;

*- **projekte kurrikulare** (si p.sh. të realizojë në grup një projekt që paraqet ndryshimet politike që ka pësuar Federata Ruse pas rënies së murit të Berlinit e deri sot etj) - Gjeografia Rajonale e Botës; **të zgjidhin situata problemore nga jeta** (p.sh. të argumentojnë qëndrimin e tyre pro ose kundër globalizmit), - Gjeografia Rajonale e Botës; (të realizojë një projekt, individual ose në grup, mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë) - Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare etj.*

Projektet kurrikulare vlerësohen si metoda tepër pretenduese, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vërtetimi, studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku.

Projekti, si rregull, ka dy përbërës thelbësorë:

1. Një çështje, një qëllim ose një problem për ndjekje, i cili shërben për të organizuar rreth tij dhe për t'i dhënë shtytjen e duhur veprimtarive të ndryshme. Çështjet janë tërësi problemesh të lidhura ndërmjet tyre që kanë ndikim në një bashkësi shumë të gjerë dhe që kërkojnë zgjidhje afatgjatë dhe të integruar.

2. Një produkt përfundimtar ose një shumicë paraqitjesh në formën e një serie zgjidhjesh.

Modeli i një projekti kurrikular: lënda „Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare“ - klasa e 12-të

Tema e projektit: Ndryshimi i hartës politike të trevave shqiptare

Kohëzgjatja: 1 - 2 orë

Vendi i zhvillimit: Në klasë

Mjetet e nevojshme: Harta të ndryshme politike të trevave shqiptare, laps plumbi, lapsa me ngjyra, gomë, vizore, fletore shënimesh.

Mënyra e realizimit: Nxënësit ndahen në katër grupe disa ditë para se të zhvillohet projekti në klasë. Grupet angazhohen të gjejnë nga burime të ndryshme informacioni, harta politike të periudhave të ndryshme kohore. Grupet bëjnë hartat skicë në tabakë (fleta) të bardhë.

Grupi I-rë skicon hartën politike gjatë periudhës së antikitetit.

Grupi II-të skicon hartën politike të periudhës së mesjetës.

Grupi III-të skicon hartën politike të vitit 1878.

Grupi IV-t skicon hartën politike të vitit 1913.

Nxënësit e secilit grup vendosin në tabelën e zezë hartat e skicuara prej tyre dhe fillojnë diskutimet mbi disa çështje kryesore, të tilla si:

- ➔ Pjesët përbërëse të trevave shqiptare: Shqipëria, Kosova dhe trevat e tjera shqiptare në Mal të Zi, ish RJ të Maqedonisë dhe Greqi.
- ➔ Vendi dhe roli i trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe dhe Europë.
- ➔ Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e hartës politike të trevave shqiptare.
- ➔ Pasojat e ndarjes përfundimtare (v. 1913) të kufijve të trevave shqiptare.

Në fund nxënësit shkruajnë përfundimet e nxjerra në fletoren e shënimeve.

Mjetet mësimore

Mjetet që përdoren në lëndën e gjeografisë, janë të llojeve të ndryshme, sepse edhe gjeografia është një shkencë me objekt mjaft të gjerë. Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në lëndën e gjeografisë ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe e bëjnë mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Tablotë, fotografitë, filmat dokumentarë, diagramat, skicat në dërrasën e zezë, koleksionet (p.sh. të mineraleve, dherave, gurëve etj), janë disa ndër mjetet mësimore ilustruese që luajnë një rol të rëndësishëm në mësimdhënien e kësaj lënde.

Për këto arsye mjetet didaktike që përdoren në procesin e të mësuarit të gjeografisë i kemi përmbledhur në tre grupe të mëdha:

1. Mjete të shtypura, si hartat (që janë të llojeve të ndryshme), atlaset, albumet, tablotë, fotografitë, skicat, diagramat, vjetarë statistikorë, manualë të të dhënave të elementeve klimatike, hidrografike, floristikë, zoologjikë, demografike etj.

2. Mjete audiovizuale, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD, aparat fotografik etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë dukurish gjeografike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv.

3. Objektet natyrore janë mjete shumë efikase për të konkretizuar njohuritë e lëndës së gjeografisë. Në këtë grup futen koleksionet e ndryshme që krijohen me material të mbledhur nga natyra, si gurë, minerale, drurë, apo produkte industriale, bujqësorë etj.

3.VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nivelit dhe cilësisë së arritjes së objektivave të përmbajtjes lëndore nga nxënësit është element i rëndësishëm i procesit të të mësuarit të gjeografisë. Kjo lëndë për vetë natyrën e gjerë të përmbajtjes së saj dhe karakterin e saj ndërdisiplinor, mundëson shumë forma vlerësimi. Verifikimi i shkallës së përgatitjes së nxënësve duhet bërë përmes përdorimit të burimeve të ndryshme të njohurive si hartat, grafikët, skicat etj.

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon zgjedhjen e formave dhe të teknikave bashkëkohore të vlerësimit për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësues/i-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e organizimit të vlerësimit në këtë lëndë mund të jenë:

- **Vlerësimi individual** (p.sh. i një nxënësi, me gojë ose me shkrim);
- **Vlerësimi në grup** (grupi 5-6 nxënës, ose më shumë apo më pak, kur nxënësi realizon një projekt apo detyrë kërkimore, si p.sh. kur realizon në grup projektin kërkimor mbi rolin që ka BE në bashkëveprimin ekonomik, kulturor; politik rajonal);
- **Vlerësimi i gjithë klasës;**
- **Vlerësimi i një detyre**, për të cilën është arritur një marrëveshje midis mësuesit dhe nxënësit/nxënësve (p.sh. nëse plotëson pagabime hartën skicë të Evropës, vlerësohesh me notë maksimale);
- **Vlerësimi në çift ose vetvlerësim** (p.sh. shoku i bankës vlerëson detyrën apo përgjigjen e shokut dhe anasjelltas, apo nxënësi vlerëson veten për realizimin e detyrës, përgjigjes ose testit);
- **Vlerësimi i portofolit (dosjes) së nxënësit** (d.m.th. i një grupi detyrash të pavarura, të kryera dhe të mbajtura shënim nga ai).

Për nga periodiciteti, vlerësimi i nxënësve mund të jetë:

- **sistematik** (për çdo temë mësimore);
- **periodik** (në përfundim të çdo kapitulli);
- **semestral dhe vjetor**.

Ai mund të jetë përmbledhës ose formativ, i planifikuar që në fillim të vitit ose i rastësishëm, në varësi të problemeve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. Vlerësimi mund të jetë gojor, me shkrim ose i ndërthurur. Këto forma vlerësimi duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi me gojë përveç kontrollit të përvetësimit të njohurive i shërben zhvillimit të disa aftësive të domosdoshme për jetën si aftësia e të shprehurit, të komunikuarit para një auditori etj. Kjo lëndë nuk e kushtëzon mësuesin të jetë strikt në vlerësimin e nxënësve në çdo orë mësimi, por i krijon mundësi mësuesit të vlerësojë nxënësin në vijueshmëri, në ecurinë e tij. Kjo mënyrë e të vlerësuarit të nxënësit me gojë në disa orë mësimi i ndihmon nxënësit të çlirohen nga emocionet dhe mësuesin të vlerësojë drejt dhe saktë njohuritë e nxënësve.

Vlerësimi me shkrim përfshin një mori formash të cilat në një masë të konsiderueshme janë specifike për secilën lëndë. Ai mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: *veprimtarisë praktike*,

testimit, eseve, projekteve etj. Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit. Mësuesi duhet sistematikisht t'i japë mundësinë çdo nxënësi që të vlerësohet për parashtrimet e tij me shkrim, madje të vlerësohet duke shërbyer si një nxitës për t'i aftësuar më tej në komunikimin me shkrim. Vetë komunikimi me shkrim shkon përtej kufirit tradicional, “me letër dhe stilolaps” dhe përfshin gjithashtu parashtrimet në trajtë elektronike.

Meqenëse kjo lëndë parashikon detyra e projekte të cilat synojnë, përveç të tjerave, zhvillimin e aftësive të komunikimit e bashkëpunimit, pjesë e vlerësimit të këtyre detyrave janë dhe prezantimet. Prezantimet mund të paraqiten në forma nga më të ndryshmet, në varësi të tematikës. Ato mund të përdoren për vlerësim përmblledhës në fund të një njësie, kapitulli, si dhe mund të shoqërojnë një raport të shkruar si pjesë e një projekti të madh. Nëse prezantimi bëhet për një çështje të gjerë, ajo mund të ndahet në nënçështje me grupe brenda klasës. Në këtë mënyrë, mësues/i-ja mund të përdorë vlerësimet sipas grupeve. *P.sh. në rast se tema që trajtohet është “specifikat e bimësisë së rajonit të Amerikës Qendrore”, ajo mund të ndahet në një sërë nënçështjesh, duke i dhënë çdo grupi fushën e tij të ekspertizës. P.sh.: disa nënçështje mund të jenë: shtrirja gjeografike e bimësisë, llojet kryesore, ndikimi i aktivitetit njerëzor etj.* Këto prezantime mund të jenë pjesë e portofolit të nxënësit, në formë të shkruar apo elektronike.

Mjaft të efektshme për matjen e rezultateve të arritjeve të nxënësve janë edhe *testimet* të cilat mund të bëhen në fund të kapitujve, semestrit ose vitit shkollor. Kjo kategori përfshin ato teknika vlerësimi të cilat përdoren në situata të strukturuar për të matur njohuritë e nxënësve. Testet janë pjesë e rëndësishme e vlerësimit të njohurive të nxënësve.

Pyetjet e mira kanë rëndësi të veçantë për mësimdhënien dhe vlerësimin efektiv. Pyetjet në teste mund të jenë të formateve të ndryshme. P.sh.:

- **Pyetje me përgjigje të zgjeruar:** si p.sh. « Pse ndryshoi harta politike e Ballkanit pas vitit 1990?

- **Pyetje me alternativa:** si p.sh. «Afrika është kontinenti ku janë formuar shumë ujëvara . Kjo është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e:

- A) ekzistencës së maleve në skajet e kontinentit
- B) uljes së menjëhershme të territorit
- C) pranisë së shumë lumenjve
- D) ekzistencës së rrafshnaltave

- **Pyetje me përgjigje të shkurtër**, si p.sh. “Nënrajonet e Rajonit Verior – Verilindor të Shqipërisë janë _____ dhe _____”.
- **Pyetje me kombinime**, si p.sh. lidh me shigjetë:

Kollona A

Kollona B

Liqeni i Prespës

Karstik

Liqeni i Ohrit

Akullnajor

Liqenet e Dumresë

Barazhi

Liqeni i Fierzës

Artificial

Liqenet e Lurës

Bregdetar

Tektonik

- **Pyetje “E vërtetë-E gabuar”,** si p.sh. “Lumi i Semanit formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin”

- *Pyetje “E vërtetë-E gabuar”*, si p.sh. “Lumi i Semanit

formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin”

- | | | |
|---|-----------|----------|
| - | E vërtetë | E gabuar |
|---|-----------|----------|

Përcaktimi i blloqeve të përmbajtjeve lëndore që do të kontrollohen, sasia dhe niveli taksonomik i pyetjeve, sistemi i pikëzimit dhe mënyra e konvertimit në notë për çdo test vendosen nga mësuesit. Vlerësimi nuk mund të mbështetet vetëm në atë me shkrim, pasi nxënësit kanë stile të ndryshme të të nxënit.

4.SHTOJCË

Tabela Nr 1 : Taksonomia konjitive e Blumit

Tre nivelet e arritjeve	Nivelet e Blumit	Foljet përshkruese
Niveli bazë	1.Të njohurit Është riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, rregullave, përkufizimeve dhe shpjegimeve ashtu siç janë dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën e njohjes.	Përkufizo, përsërit, përshkruaj me fjalët e tekstit, identifikoj, vër në tabelë, hartoj një listë, emërtoj, riprodho etj.
	2. Të kuptuarit Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se TË NJOHURIT.	Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, nxirr përfundime, perifrizzo, rishkruaj, përgjithëso, interpretoj ndryshe, nxirr një përfundim etj.
Niveli mesatar	3.Aplikimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.	Ta aplikosh (zbatosh), të shfrytëzosh, të ndryshosh, të njehsosh, të klasifikosh, të provosh , të vësh në dukje, të manipulosh, të përgatit, lidh, trego, shpjego, përdor etj.
	4.Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, çka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se në TË KUPTUARIT.	Copëtoj, ndaj në pjesë, shpjego përse, diferencoj, shquaj, dallo, ver në dukje, lidh, seleksionoj etj.

Niveli i lartë	5.Sinteza: Është aftësia që formon një të tërë duke bashkuar pjesët. Mund të jetë: komunikim i një plani veprimesh, klasifikim informacioni etj.	Kombino, harto, krijo, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompoz, jep mendime, përmirëso, organizo, planifiko, risistemo , të shkruash, të tregosh, të prodhosh, të hartosh, të transmetosh, të krijosh, të propozosh, të planifikosh, të prodhosh, të modifikosh, të specifikosh, të kombinosh, të organizosh, të sintetizosh, të klasifikosh, të përfundosh, të zhvillosh, të modifikosh, të ndërtosh etj.
	6.Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimi i komunikimeve gjykuese etj	Krahaso, konkludo vër në kontrast, kritiko, përshkruaj, shpjego, justifiko, interpreto lidh, përmblihdh, bëj një evidencë etj.

Model i zbërthimit të përmbajtjes së një blloku tematik të shprehur në objektiva, në tema mësimore:

Blloku tematik	Objektiva	Temat mësimore
Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i-ja: - Të përshkruajë objektin e studimit të kësaj lënde, vendin që ajo zë në studimet gjeografike dhe rëndësinë e studimit të saj; - të bëjë dallimin (të diferencojë) në përbërjen e trevave shqiptare (Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, në Maqedoni, në Greqi dhe në Malin e Zi); - të analizojë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe, Evropë dhe më gjerë; - të vlerësojë rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare; - të analizojë ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; - të realizojë një projekt kërkimor me karakter krahasues mbi ndryshimet në kohë, të hartës politike të trevave shqiptare.	Hyrje: Objekti i studimit të Gjeografisë së Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare Përbërja dhe rëndësia e pozitës gjeografike Ndryshimi në kohë dhe hapësirë i hartës politike të trevave shqiptare Projekt: Ndryshimi i hartës politike të trevave shqiptare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: EKONOMI
PËR KLASËN e 12^{të}

TIRANË, PRILL 2010

PËRMBAJTJA

- 1. Rëndësia e lëndës së ekonomisë në kurrikulën e re të gjimnazit**
 - 1.1 Synimet e kurrikulës së re të ekonomisë**
 - 1.2 Zhvillimi i aftësive**
 - 1.3 Fusha dhe përmbajtja**
 - 1.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e lëndës së ekonomisë me lëndët e tjera**
 - 1.5 Objektivat e arritjes për klasën e 12-të**
 - 1.6 Objektivat specifike të arritjes në kurrikulën e lëndës së ekonomisë**
- 2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës së ekonomisë**
- 3. Vlerësimi i nxënësit**

1. RËNDËSIA E LËNDËSË EKONOMISË NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

Nxënësit maturantë e studiojnë ekonominë si lëndë për herë të parë, por ata janë familjarizuar me probleme ekonomike. Ata kanë marrë disa nocione ekonomike në lëndët e tjera shoqërore, nëpërmjet mediave, apo kanë dëgjuar të flitet mbi disa çështje ekonomike si: papunësia, inflacioni, pagat, çmimet, taksat, interesat bankare, etj. Ato, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Në lëndën e ekonomisë nxënësi do të përfitojë njohuri shkencore ekonomike dhe aftësi për interpretimin dhe zbatimin e tyre, sipas rastit. Nëpërmjet procedurave konkrete nxënësit ushtrojnë veprimtaritë praktike dhe kuptojnë se ato janë aspekt i qëndrimit të njerëzve.

Kurrikula bazë fokusohet tek bazat ekonomike, që janë të domosdoshme për të interpretuar ngjarjet ekonomike dhe ndryshimet në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkohë që individët dhe komunitetet bëjnë përpjekje që të adaptojnë ndryshime strukturore në shoqëri, të vëna në lëvizje nga ndikimet e ndryshimeve teknologjike dhe konkurrenca e bashkëpunimi ndërkombëtar.

Nxënësit do të përdorin metodën *deduktive* dhe induktive të analizës ekonomike. Nëpërmjet deduksionit ata do të zbresin nga kuptimet, rregulli i përgjithshëm në dukuritë konkrete, më të detajuara. Ata kuptojnë se një përgjithësim, rregull (deduksion), një ligj ekonomik përmban një set çështjesh ekonomike, të cilat mund të analizohen rast pas rasti. P.sh, arsyetohet se ngritja e çmimit të naftës do të shkaktonte një ulje të përgjithshme të kërkesës për këtë produkt nga konsumatorët. Analiza rast pas rasti, i mundëson për të kuptuar në se ky pohim i përgjithshëm është i vërtetë për çdo rast. Po kështu mund të arsyetohet mbi krizën e përgjithshme ekonomike, duke analizuar pasqyrimin e rregullit të përgjithshëm, në aspekte të veçanta.

Duke përdorur metodën e analizës *induktive* në lëndën e ekonomisë kalohet nga arsyetimet e rasteve të shkëputura në përgjithësimin ekonomik. Mbi bazën e analizës së të dhënave ekonomike, fillimisht formulohet një hipotezë. Nëpërmjet vëzhgimit të sjelljeve të shumë konsumatorëve, të cilët reduktojnë kërkesën për një produkt, në se çmimi për të rritet, mund të arrihet në përfundimin se kjo ka ardhur si rrjedhojë e ngritjes së çmimeve,

sikurse ndodh p.sh me perimet në sezonin e dimrit. Ndërkohë nxënësit kuptojnë lidhjen ekonomike ndërmjet rasteve dhe rregullit të përgjithshëm, të kërkesës me ofertën, të përcaktimit të çmimit, e kështu me radhë.

Është shumë e rëndësishme që nxënësit të marrin vendime në jetën e tyre, të jenë pjesëmarrës aktivë në një ekonomi globale, anëtarë produktiv të forcës së punës dhe qytetarë të përgjegjshëm, si dhe promotorë të sistemit të sipërmarrjes së lirë.

Mendimi ekonomik ose “mënyra ekonomike e të menduarit” është një produkt themelor, që përfitohet nga studimi i lëndës së ekonomisë. Nëpërmjet të menduarit kritik nxënësit përgatiten që të analizojnë dhe të peshojnë jo vetëm efektet afatshkurtra të vendimmarrjeve të tyre, por edhe efektet afatgjatë, dhe po të ishte e mundur edhe rrjedhojat ekonomike që sjellin vendimmarrjet. Lënda e ekonomisë u ofron nxënësve një kuadër jetësor brenda të cilit nxënësit mund të marrin vendime ekonomike personale, të analizojnë çështje dhe politika publike aktuale dhe të kuptojnë marrëdhëniet komplekse midis sistemeve kulturore, politike dhe ekonomike.

Realizimi i përmbajtjes së lëndës, konkretizohet me shembuj, ilustrime dhe nëpërmjet ushtrimit praktik të nxënësve në rolin e tyre si prodhues, si shitës të produkteve, si taksapagues, si zotërues burimesh materiale, si votues, ata delegojnë kompetencat, si konsumatorë, si kursimtarë dhe investitorë. Kështu, nxënësit aftësohen për të punuar në grup, për të ndërmarrë veprimtari nxitëse, fokusohen në situata konkrete, trajtojnë koncepte, fakte dhe situata ekonomike, bëjnë analiza dhe arrijnë në përfundime konkrete.

1.1. SYNYMET E KURRIKULËS SË RE TË EKONOMISË

Siç është përcaktuar edhe në programet përkatëse të ekonomisë, synohet që çdo nxënës të përvetësojë nocionet bazë ekonomike dhe të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe të mbajnë qëndrime konkrete në lidhje me to.

Lënda e *ekonomisë bërthamë* synon që nxënësit ;

- duke përdorur arsyetimin ekonomik dhe konceptin e burimeve

të kufizuara, të bëjnë zgjedhjet ekonomike, që përfshijnë kostot oportune dhe të marrin vendime të rëndësishme për jetën e tyre.

- duke kuptuar instrumentet nxitëse të sistemeve të ndryshme ekonomike, të aftësohen të fitojnë një kuptim më të mirë se si sistemet ekonomike funksionojnë.
- të ndërgjegjësohen se ne të gjithë jemi pjesë e një ekonomie botërore dhe kjo kërkon që ata të ekzaminojnë bashkëveprimin dhe ndërvlerësinë në marrëdhëniet ekonomike, që rezultojnë nga këmbimi dhe tregtia.

Lënda e ekonomisë së avancuar synon që nxënësit ;

- duke zbrërthyer më thellë konceptet ekonomike dhe duke studiuar ndërlidhjen midis tyre, të kenë një kuptim më të plotë të qëllimeve kryesore sociale, të cilat shërbejnë për të vlerësuar performancën dhe politikat ekonomike.
- të marrin vendime të rëndësishme dhe efektive ekonomike duke zëvendësuar gjykimin emocional me analizën ekonomike dhe të argumentuar.
- duke marrë një kuadër konceptual, ndërlidhës dhe argumentues, të organizojnë të kuptuarin e tyre ekonomik dhe të ekspozojnë një mënyrë të menduari sistematik, argumentues dhe objektiv .

Lënda e ekonomisë me zgjedhje synon që nxënësit ;

- të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e kurrikulës bërthamë të ekonomisë me një orientim të qartë nga tregu.
- të identifikojnë njohuritë dhe shprehjet ekonomike bazë, që janë të nevojshme për çeljen e një biznesi.
- të zhvillojë njohuri, aftësi dhe qëndrime në lidhje me organizimin, funksionimin dhe sipërmarrjen e një biznesi.

Përvetësimi i njohurive ekonomike vjen në mënyrë graduale dhe zhvillohet në mënyrë të sinkronizuar me procesin e krijimit të aftësive të nevojshme të nxënësve, ndërgjegjësimit mbi rolin e tyre si agentë ekonomikë, si politikë-bërës dhe vendim-marrës aktivë të çështjeve ekonomike.

Përfitimi i njohurive në lëndën e ekonomisë do t'i ndihmojë

nxënësit që të zhvillojnë aftësitë e tyre për të interpretuar problematikën ekonomike në situata të reja, të zhvillojnë përkushtimin e vazhdueshëm në trajtimin e çështjeve ekonomike dhe të pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e qytetarisë, si edhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësinë për të ndjekur problematikën ekonomike në perspektiva të reja të zhvillimit shoqëror.

➤ **Parimet e kurrikulës së ekonomisë**

Programi i kurrikulës bërthamë të lëndës së ekonomisë, ashtu si dhe programet e tjera të kurrikulës bërthamë, janë pjesë përbërëse e kurrikulës së re të gjimnazit. Përvetësimi i primeve të përgjithshme të mendimit ekonomik synon krijimin e njohurive të nxënësit, të shprehive dhe qëndrimeve të vlerave ekonomike që janë në përshtatje me kërkesat e kornizës kurrikulare kombëtare.

Ndër parimet kryesore të zhvillimit kurrikular, në këtë kontekst dhe i programit të ekonomisë është *konceptimi i gjerë*. Çka nënkupton se lënda e ekonomisë do të përcillet tek nxënësi nëpërmjet dokumenteve të shkruara, sikurse është dhe programi lëndor, duke përdorur metoda të përshtatshme didaktike.

Konceptet ekonomike, janë një komponent i programit dhe synojnë formimin e nxënësit me nocionet ekonomike bazë, në këtë nivel shkollimi. Sipas kërkesave të pedagogjisë bashkëkohore, konceptet dhe idetë ekonomike shtjellohen dhe zbatohen, në përshtatje me *mjedisin fizik dhe social* të të nxënësit, duke përdorur *metoda* dhe praktika bashkëkohore të mësimdhënie/nxënies konstruktiviste. Çka nënkupton stimulimin e nxënësit për të mësuar dhe vetëmësuar, bashkëveprimin efikas në procesin mësimor dhe vlerësimin bashkëkohor të njohurive e aftësive ekonomike.

Programi gjithashtu, parashtron nevojën e sigurimit të *koherencës dhe integritetit* të njohurive ekonomike, duke bërë përgatitjen *hap pas hapi* të nxënësit për jetën ekonomike dhe botën e punës.

Nëpërmjet trajtimit të lëndës njohuri për ekonominë synohet që nxënësi të përfitojë konceptet bazë mbi ekonominë, strukturat dhe sistemet ekonomike dhe vendin e ekonomisë në shoqëri. Nëpërmjet këtij procesi nxënësi njihet me *funksionimin e jetës ekonomike të shoqërisë*, me *burimet ekonomike* të vendit, që janë të kufizuara, me rëndësinë që ka vendimmarrja e efektshme për shfrytëzimin racional të burimeve ekonomike, për rritjen e nivelit ekonomik dhe avantazhet që krijohen për plotësimin në rritje të nevojave dhe kërkesave të individëve dhe të shoqërisë.

Aftësitë bazë ekonomike që nxënësit marrin në shkollë, realizohen në përshtatje me kërkesat e pedagogjisë së re, që e vë *nxënësit në qendër të procesit mësimor*, duke i mundësuar ata që të menaxhojnë procesin e vetë nxënies, për të përfituar njohuri dhe aftësi ekonomike, për të ndërtuar pyetje konkrete, për të kënaqur kureshtjen e tyre dhe, mbi këtë bazë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë *gjatë gjithë jetës*.

Ndër kërkesat e programit janë edhe përpunimi i aftësive individuale dhe të *punës në grup*. Duke u fokusuar në situata konkrete nxënësit të ndërmarrin veprimtari nxitëse, të trajtojnë koncepte, fakte dhe situata ekonomike, të bëjnë analiza dhe të arrijnë në përfundime konkrete.

Konkretizimi i përmbajtjes lëndore do të realizohet nëpërmjet *shembujve*, ilustrimeve dhe ushtrimit praktik të nxënësve në rolin e tyre si prodhues, si shitës të produkteve, si taksapagues, si zotërues burimesh materiale, si votues që delegojnë kompetencat, si konsumator, si kursimtarë dhe investitor.

Përvojat e fituara në ekonomi u krijojnë nxënësve mundësinë për të kuptuar, eksploruar, analizuar, përmbledhur dhe vlerësuar lidhjet ndërmjet koncepteve, strukturave dhe sistemeve ekonomike, funksionimin e tyre, zhvillimet e sotme teknologjike, *impaktin* që kanë në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përkatës. Çka i mundëson për të zhvilluar karrierën dhe të ardhmen e tyre.

Zhvillimi efikas i kësaj lënde do t'i mundësojë për të ndjekur zhvillimet ekonomike, që kryhen me ritme të shpejta e në mënyrë të pandërprerë, në botën e sotme të *dixhitalizuar* dhe për të arritur në vendimmarrje të drejta ekonomike, në kontekstin e situatave reale.

➤ **Konceptet**

Hartimi dhe shtjellimi i programit lëndor është bërë mbi bazën e koncepteve *ekonomike*. Nxënësit duhet të konceptojnë thellë parimin filozofik se kuptimi dhe shqyrtimi i një dukurie ekonomike (si dhe në çdo fushë tjetër) nis me krijimin e koncepteve të drejta mbi to. Nëse ata do të kenë konceptime të vagullta, moskuptime, keqkuptime konceptuale, nuk do të mund të arrijnë në analiza dhe përfundime të sakta. Konceptet lëndore janë përzgjedhur në përshtatje me nivelin e shkollimit dhe të nevojës që kanë nxënësit për edukim ekonomik. Çdo koncept përfaqëson një kuptim, prandaj dhe ka shumë rëndësi që nëpërmjet tyre të kapet dukuria ekonomike dhe të shtjellohet lidhja e dukurive me njëra-tjetrën, të bëhet trajtimi i koncepteve në situatën konkrete, nga njeri mësim në tjetrin. Më

poshtë po japim konceptet ekonomike, sipas linjave përkatëse.

Në linjën e parë - Ekonomia e tregut, prezantohen këta terma dhe koncepte kryesore:

Pamjaftueshmëria, kosto oportune, faktorët e prodhimit, sistem ekonomik, pronë private, sistem çmimesh, konkurrencë, aftësi sipërmarrëse, fitim, fluksi i qarkullimit ekonomik, treg, çmim, kërkesë, ofertë, ligji i kërkesës, ligji i ofertës, çmim ekuilibër, sasi ekuilibër, elasticitet i kërkesës, elasticitet i ofertës, çmim tavan, çmim dysHEME, konsumator, buxhet personal, kredi, sipërmarrje, biznes individual, ortakëri, korporatë, aksion, obligacion, bilanc, pasqyrë e rezultateve financiare, kosto fikse, kosto variabël, kosto marginale, kosto mesatare, kosto totale, produkt i përgjithshëm fizik, marginal, mesatar, ligji i të ardhurave zbritëse, strukturë tregu, konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol, oferta e punës, kërkesa e punës, paga, renta, interesi.

Në linjën e dytë- Ekonomia kombëtare, prezantohen këta terma dhe koncepte kryesore:

Buxhet i qeverisë, *eksternalitet*, taksa, taksë përpjesëtimore, taksë regressive, taksë progresive, taksa direkte, taksa indirekte, parimi i aftësisë për të paguar, parimi i përfitimit, deficit buxhetor, borxh publik, para, ofertë monetare, emetim i parasë, bankë tregtare, GDP, GDP reale, GDP nominale, GDP për frymë, inflacion, deflacion, cikël biznesi, rënie ekonomike, rritje ekonomike, krizë, piku, pika më e ulët, fuqi punëtore, papunësi ciklike, papunësi sezonale, papunësi *friksionale*, papunësi strukturore, politikë fiskale, politike monetare, rezervë monetare, operacion i tregut të hapur, normë e rezervës së detyrueshme.

Në linjën e tretë: Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, prezantohen këta terma dhe koncepte kryesore:

Tregti, import, eksport, përparësi absolute, përparësi relative, tregti e lirë, proteksionizëm, tarifa mbi importin, kuota mbi importin, barriera administrative, kurs këmbimi valutor, bilanc tregtar, bilanci i pagesave, integrim ekonomik, zonë e lirë, bashkim ekonomik, bashkim ekonomik evropian.

Natyrisht që konceptet më lartë nuk qëndrojnë në vetvete. Ato përdoren në situata të ndryshme dhe veprojnë në përbërje të konceptimeve më të gjera ekonomike.

➤ **Struktura e programit**

Kurrikula e re e ekonomisë do të zhvillohet mbi bazën e programit të *kurrikulës bërthamë*, programit *avancimi i lëndës ekonomi* dhe programit *ekonomi me zgjedhje të detyruar*.

Në programin e *kurrikulës bërthamë të ekonomisë* përfshihen konceptet, njohuritë, aftësitë ekonomike bazë, që janë të mjaftueshme për formimin ekonomik bazë dhe të detyrueshme për të gjithë nxënësit e gjimnazit.

Programi i *avancuar i lëndës ekonomi* zgjeron dhe thellon përmbajtjen e kurrikulës bërthamë, duke i ardhur në ndihmë kontingjentit të nxënësve që duan të zhvillojnë më tej formimin akademik. Këtë program nuk janë të detyruar që ta zgjedhin të gjithë nxënësit, por vetëm ata që e shikojnë si mjet dhe mundësi për shkollimin e mëtejshëm, si dhe për të realizuar interesat e kënaqësitë e tyre.

Përveç këtyre programeve, në kuadrin e kurrikulës së re, është ndërtuar edhe një program tjetër për lëndën e ekonomisë, ai i *kurrikulës me zgjedhje*, i cili ka si objekt të plotësojë interesat e atyre nxënësve që kërkojnë aftësi dhe shprehje ekonomike dhe që u shërben për punësim.

Lënda e ekonomisë (bërthama) zhvillohet në bazë të standardeve lëndore dhe standardeve të fushës së shkencave shoqërore. Shkencat sociale na ndihmojnë për eksplorimin e jetës dhe veprimtarisë së shoqërisë njerëzore në sensin pozitiv, duke përdorur metoda të shkencave natyrore. Çka i shërben integritetit të fushave në kuadrin e kurrikulës së shkollës, duke realizuar formimin akademik të nxënësve.

Standardet e fushës së lëndëve shoqërore, për pasojë edhe ato të ekonomisë, grupohen në standarde të përmbajtjes dhe në standarde të proceseve. Standardet e përmbajtjes përcaktojnë lëndën e nevojshme që duhet të përfitojë nxënësi për të arritur edukimin ekonomik. Ndërsa standardet e proceseve kanë të bëjnë me mënyrat e shtjellimit dhe të përcjelljes së kësaj lënde të nxënësi dhe me zhvillimin e rolit aktiv të nxënësit. Nëpërmjet përcaktimit të standardeve dhe zhvillimit të lëndës mbi bazën e tyre tërhiqet vëmendja e mësimeve/nxënies për të zhvilluar aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, si dhe integritetit të lëndëve shoqërore brenda fushës së lëndëve shoqërore.

Standardet e shkencave shoqërore përcaktojnë kriteret bazë mbi të cilat zhvillohen lëndët shoqërore. Mbi bazën e këtyre standardeve janë përcaktuar:

- përmbajtja lëndore e integruar e fushës dhe e çdo lënde në veçanti

- njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet të manifestojë nxënësi në përfundim të një cikli shkollimi
- metodat e vlerësimit efikas për arritjet në përvetësimin e lëndëve shoqërore.

Standardi i lëndës së ekonomisë përcakton se: Nxënësi/ja duhet të fitojë aftësitë e të arsyetuarit ekonomik.

- Ai duhet të kuptojë që për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve ekonomike njerëzit duhet të bëjnë zgjedhje që shoqërohen me kosto oportune; se mbajtja e një qëndrimi rreth përdorimit të burimeve, produkteve dhe shpërndarja e mallrave dhe shërbimeve ndikohet nga sistemet e ndryshme ekonomike;
- nxënësi kupton rezultatet e tregtisë, shkëmbimit dhe ndërvarësinë ndërmjet individëve, rolin e tyre në familje, në biznese, në sektorët ekonomik dhe në shoqëri;
- nëpërmjet veprimtarive mësimore fiton aftësi për të qenë pjesëmarrës aktiv në situata të ndryshme jetësore, si konsumator, prodhues, kursyes, taksapagues, apo tregtues.

Programi përmbledh problemet kryesore makro dhe mikroekonomike si dhe probleme kryesore të ekonomisë botërore që do ta ndihmojnë nxënësin të orientohej në jetën ekonomike dhe të marrë vendime ekonomike të mençura që do t'i sjellin përfitime në planin afatshkurtër dhe afatgjatë. Ky program është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit e klasës së 12-të të gjimnazit, duke synuar studimin dhe përvetësimin e të gjitha njohurive ekonomike që përmban ai.

Programi krijon hapësira që i japin mundësi nxënësit për t'u përfshirë në ato fusha ku ai dëshiron të thellohet.

Programi bërthamë i lëndës “Ekonomi” do të zhvillohet në 68 orë mësimore vjetore.

Në program, afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30% e tyre janë për përpunim njohurish nëpërmjet veprimtarive praktike, përsëritjeve dhe testeve.

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t'i ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me sugjerim rastesh për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e ekonomisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit. Veprimtaritë

praktike e bëjnë programin dhe lëndën e ekonomisë më përvetësuese dhe më tërheqëse për nxënësin, duke e bërë atë aktorin kryesor në orën e mësimit.

Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohen njohuritë teorike të marra gjatë lëndës me jetën dhe problemet praktike të nxënësve si dhe të ekonomisë shqiptare.

Programi ka natyrë tematike dhe është strukturuar në linja dhe nënlinja, që vijnë njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera ekonomike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zbërthimin e këtyre tematikave (linjave) në kapituj (nën linja).

Programi i lëndës së ekonomisë është strukturuar në 3 linja që vijnë njëra pas tjetrës, secila linjë ka nënlinjat përkatëse.

Linja	Klasa	O r ë t p ë r linjë	Blloku tematik (Sipas nënlinjave)
1.Ekonomia e tregut	12	41	1.1 Çfarë studion ekonomia? (7 orë) •Çfarë është ekonomia dhe faktorët e prodhimit •Problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike •Shtyllat e sipërmarrjes së lirë •Skema e qarkullimit të aktivitetit ekonomik 1.2 Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut (8 orë) Kërkesa Oferta Ekuilibri i tregut Kontrolli i çmimeve nga forcat jo të tregut 1.3 Konsumatori në ekonominë e tregut (3 orë) •Konsumatori, burimet e të ardhurave dhe kursimi •Buxheti vetjak, planifikimi i tij 1.4 Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij (8 orë) •Sipërmarrësi, biznesi i vogël dhe roli ekonomik i tij •Format e organizimit të biznesit •Burimet financiare të biznesit •Tregu i letrave me vlerë •Kontabiliteti i biznesit 1.5 Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës (5 orë) •Prodhimi •Kostoja •Të ardhurat e firmës 1.6. Si konkurrojnë firmat (6 orë) •Konkurrenca e plotë •Konkurrenca monopoliste •Monopoli dhe oligopoli 1.7 Tregjet e faktorëve të prodhimit (4 orë) •Tregu i punës. •Aspekte të tjera në tregun e punës •Tregu i kapitalit dhe tokës

2. Ekonomia kombëtare	12	22	2.1 Qeveria dhe ekonomia (7 orë) • Roli i qeverisë në ekonomi • Buxheti i qeverisë • Taksat dhe llojet e tyre • Deficiti buxhetor dhe borxhi kombëtar 2.2 Paraja dhe institucionet monetare (4 orë) • Paraja, format dhe oferta e parasë • Bankat tregtare dhe roli i tyre si ndërmjetës financiar • Banka qendrore. 2.3 Treguesit kryesor makroekonomik (8 orë) • Produkti i brendshëm bruto • Inflacioni • Cikli i biznesit • Papunësia, matja dhe format e saj. 2.4 Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike (3 orë) • Politika monetare • Politika fiskale
3. Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare	12	5	3.1 Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare (5 orë) • Tregtia ndërmjet vendeve dhe përfitimet e saj • Tregtia e lirë dhe politika proteksioniste • Kursi i këmbimit valutor dhe bilanci i pagesave

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë, duke respektuar sasinë e orëve vjetore

që janë planifikuar për lëndën. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të ngadalësojë, kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të përparojë, kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

➤ **Formati i programit**

Lënda “Ekonomi”, ashtu si dhe çdo lëndë tjetër, ka një kod në planin mësimor të gjimnazit. Kodi është shkruar në kopertinën e programit dhe tregon vendin që ekonomia zë në planin mësimor, brenda fushës së shkencave shoqërore:

Fusha: Shkencat shoqërore

Lënda: Ekonomi

Kodi: 8. 4. 12. B

Përmbajtja e programit është organizuar brenda këtyre rubrikave:

- Hyrje.
- Synimi i lëndës.
- Objektivat e përgjithshëm.
- Objektivat sipas linjave.
- Kërkesat e ekonomisë ndaj lëndëve të tjera.
- Kërkesa për zbatimin e programit.
- Vlerësimi.

Të gjitha rubrikat japin një panoramë të qartë të zhvillimit të përmbajtjes së kësaj lënde.

1.2. ZHVILLIMI I AFTËSIVE

Aftësitë që mund të përfitohen në lëndën e ekonomisë mund të klasifikohen në aftësitë e të menduarit dhe strategjitë e të menduarit. Zhvillimi i tyre e mundëson nxënësin të praktikojë aftësitë e të menduarit ekonomik, duke zhvilluar format e të të menduarit mjeshtror.

Aftësitë e të menduarit përfshijnë aftësitë për të mbledhur, interpretuar, organizuar, analizuar, vlerësuar dhe sintetizuar

informacionin.

Strategjitë e të menduarit përfshijnë përpunimin e informacionit, ndërsa nxënësit përfshihen në zgjidhjen e problemit, vendimmarrjen, hulumtimin dhe konceptualizimin.

Për të zhvilluar aftësitë dhe strategjitë e të mësuarit në këtë lëndë duhet:

- të përdorë edhe burime të tjera informacioni, krahas informacionit të marrë nga teksti i ekonomisë
- të sigurohet lidhja ndërlëndore, brenda shkencave shoqërore dhe në tërësi
- të trajtohen probleme ekonomike që ndeshen në jetën e përditshme
- të kombinohet puna në klasë me veprimtaritë në njësitë ekonomike
- të zhvillohen aftësitë e të menduarit shkencor
- të zhvillon aftësitë e të menduarit kritik
- të zhvillohen aftësitë komunikuese
- të zhvillohen aftësitë organizuese dhe vetëmenaxhuese të nxënësve
- të zhvillohen aftësitë për të punuar në grup
- të zhvillohen aftësinë për të prezantuar gjetjet
- të zhvillohen aftësitë e tij në përshtatje me standardet intelektuale të qartësisë, saktësisë, logjikës, domethënies, thellësisë, gjerësisë, përligjjes, të përmirësimit dhe vetëvlerësimit
- të vlerësohet rregullisht puna e tij dhe të sistemohet, duke përdorur portofolin e tij.

Më poshtë ofrohen shpjegime se si në lëndën e ekonomisë mund të organizohen aftësitë dhe strategjitë e të menduarit.

Nxënësi, gjatë zhvillimit të kurrikulës së ekonomisë duhet të fitojnë këto aftësi:

1. Për të mbledhur informacion.

Për këtë nxënësi duhet të jenë i aftë:

- Të identifikojë burime të ndryshme informacioni (gazeta, revista, harta, diagrame, fjalor, etj.)
- Të interpretojë avantazhet dhe kufizimet e burimeve të ndryshme të informacionit
- Të identifikojë tipat dhe llojet e informacionit të nevojshëm, duke kuptuar qëllimin për të cilën është përdorur informacioni
- Të lokalizojë informacionin e marrë nga burimet e printuara ose jo të printuara (elementet kryesore, idetë kryesore dhe elementet mbështetës)
- Të organizojë në mënyrë të rregullt, të saktë informacionin e mbledhur.

2. Për të përdorur informacionin:

Për këtë nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të klasifikojë dhe kategorizojë të dhënat duke i vendosur në mënyrë kronologjike dhe logjike si dhe duke identifikuar dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet tyre
- Të vlerësojë të dhënat, duke dalluar opinionet nga faktet
- Të bëjë deduktime nga të dhënat e përgjithshme
- Të bëjë përgjithësime, bazuar në të dhëna të veçanta

3. Për të prezantuar informacion:

Për këtë nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Ta parashtojë në mënyrë efikase, duke respektuar kohën që ka në dispozicion.
- Të përdorë mjete të ndryshme vizuale, që e mundësojnë për të ndarë idetë me të tjerët.
- Të shkruajë në një mënyrë shpjeguese, duke u bazuar në mendime të qarta
- Të njohë dhe të përdorë mjete jo verbale komunikimi

4. Për të marrë pjesë dhe ndërvepruar në grup.

Për këtë nxënësi duhet të jenë i aftë:

- Të ndërveprojë nëpërmjet qëndrimit pozitive, duke marrë në konsideratë se të tjerët mund të kenë këndvështrime të ndryshme
- Të marrë pjesë në planifikimin dhe diskutimin në grup, duke ndjekur procedurat demokratike që ndihmojnë vendimmarrjet efikase në grup
- Të marrë përgjegjësi, duke realizuar detyrat individuale ose të grupit
- Të përcaktojë çështjet bazë për të cilat do të bashkëpunohet
- Të krijojë hipoteza ose alternativa të ndryshme duke u bazuar në setin e të dhënave.

Por gjithashtu është shumë e rëndësishme të theksohet se në lëndën e ekonomisë nxënësit duhet të praktikohen në pranimin e kundërshtive dhe zgjidhjen e konflikteve për çështje të ndryshme. Për këtë qëllim nxënësit duhet të realizojnë hapat e mëposhtëm të një procesi të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së konflikteve/ problemeve:

1. Nxënësi të përcaktojë ose të identifikojë problemin
2. Të ngrejë hipoteza dhe të hulumtojë të dhënat
3. Të marrë vendime bazuar në hapin e dytë
4. Të njohë vlerat e diversitetit të mendimeve
5. Të ripërcaktojë artikulin apo vendimin duke u përpjekur të riparojë konfliktin në vlera.

Nxënësit duhet të ndihmohen të kuptojnë që ndërsa një problem mund të zgjidhet duke vepruar në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër, zgjidhja e tij mund të krijojë një problem të ri. Ky kuptim duhet të inkurajojë nxënësit të peshojnë me kujdes zgjidhjet alternative.

Aftësitë e trajtuara më sipër duhet të aplikohen në zgjidhjen e konflikteve, zgjidhjen e problemeve, duke përsosur vendimmarrjen. Nxënësve duhet t'u krijohet mundësi që aftësitë e mësipërme t'i përdorin për:

1. Të identifikuar problemin/et duke:

- parashtruar pyetje (lidhur me problemin), të tilla si: kush?, çfarë?, kur?, ku?, si? dhe pse?
- identifikuar aspekte të ndryshme të problemit
- përdorur aftësi të menduari të analizës, sintezës dhe vlerësimit

2. Të zgjidhur problemin e parashtruar nga mësuesi ose të identifikuar prej vetë nxënësve duke:

- shkruar një fjali ose paragraf ku të deklarojë problemin
- shkruar një seri pyetjesh që do të shërbejnë si orientim për zgjidhjen e problemit
- zhvilluar një plan për zgjidhjen e problemit
- ripërcaktuar problemin origjinal ose identifikuar një problem të ri, nëse është e nevojshme.

3. T'u përfshirë në zgjidhjen e problemit duke:

- mos qenë thjesht dhe vetëm pjesë e problemit por edhe e kurimit të tij
- marrë pjesë në planifikimin dhe diskutimin në grup, sipas procedurave demokratike të vendimmarrjes

1.3 FUSHA DHE PËRMBAJTJA

➤ Fusha

Lënda e ekonomisë bën pjesë në grupin e shkencave shoqërore, së bashku me lëndën e historisë, gjeografisë, qytetarisë, aftësimit për jetën.

Kjo lëndë merret me studimin e qëndrimeve njerëzore, se si ata bëjnë zgjedhjet për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre, në përshtatje me burimet dhe mundësitë e kufizuara që zotërojnë.

➤ Përmbajtja

Programi i Lëndës së Ekonomisë trajton probleme kryesore mikroekonomike, makroekonomike si dhe ato të tregtisë ndërkombëtare. Programi studion parimet, konceptet, aspektet më të rëndësishme të jetës

ekonomike shoqërore si pamjaftueshmëria, kosto oportune, zgjedhjet, sistemet ekonomike, çmimi, kërkesa, oferta, tregu, roli i qeverisë në një ekonomi tregu, tregtia midis vendeve etj.

Ky program është hartuar mbi bazën e objektivave, të cilat përcaktojnë konceptet kryesore (njohuri, aftësi, qëndrime) që synojnë këto objektiva. Njohuritë e reja dhe përpunimi i tyre shprehen nëpërmjet objektivave të programit.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka parashtrohet tek objektivat.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore jetësore etj.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisje ngjarje aktuale ose thjesht kureshtjen e nxënësve.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- *aftësive të përgjithshme*, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjes problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- *aftësive të posaçme lëndore*, si: forcimi i personalitetit; edukimi i karrierës; aftësia për të vendosur dhe përshkruar në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike; aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak–pasojë; aftësia për të hetuar, interpretuar dhe parashikuar ngjarje historike; aftësia krijuese për shkrimin e një eseje apo referati, duke sjellë një opinion dhe qëndrim të vetin; aftësi krahasuese për krahasimin dhe renditjen e veçorive të ngjarjeve historike brenda të njëjtës periudhë apo periudhave të ndryshme; aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor; aftësi për komunikimin e saktë të njohurive, opinioneve, mendimeve, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.;
- *formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etik-social etj., gjatë punës me grupe të vogla nxënësish.

Përmbajtja e programit është e ndërtuar përmes 3 linjave bazë të cilat kërkojnë të aftësojnë nxënësit jo vetëm të përvetësojnë koncepte, parimet kryesore ekonomike, por edhe të përdorin atë për të kuptuar dhe vlerësuar vendimet e të sotmes dhe perspektivës.

Çdo linjë ka përmbajtjet si më poshtë:

Linja 1: Ekonomia e tregut

Kjo linjë fokusohet në krijimin e koncepteve të nxënësi dhe arsyetimeve ekonomike mbi vendimmarrjen në kushtet e burimeve të kufizuara ekonomike. Nëpërmjet kuptimit dhe analizës së këtij fakti, krijohet një kuptim i qartë ekonomik mbi idenë se të gjitha zgjedhjet ekonomike shoqërohen me një kosto.

Nxënësit njihen me veprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës që ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu ata njihen e diskutojnë për parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave, financimi i tyre si dhe nivelet e konkurrencës së tregut.

Linja2: Ekonomia kombëtare

Aktivitetet ekonomike të qeverisë ndikojnë në mirëqenien tonë të përditshme. Njohja me rolin dhe funksionet që ka një qeveri në ekonominë e tregut dhe identifikimi e analiza e problemeve të ndryshme si papunësia, inflacioni, rënia ekonomike, do të ndihmojë nxënësit që të kuptojnë më mirë realitetin makroekonomik si dhe politikat fiskale apo monetare që ndiqen për stabilitetin e ekonomisë. Në këtë linjë nxënësit mësojnë gjithashtu përmbajtjen, funksionet dhe format e parasë në një ekonomi monetare si dhe rolin e bankave tregtare dhe të Bankës Qendrore.

Linja3: Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare

Vendet dhe ekonomitë e tyre po ndërveprojnë dhe ndërliken gjithnjë e më shumë me njëra-tjetrën, duke pasur përfitime të ndërsjella. Kështu ne mund të konsumojmë produkte industriale dhe bujqësore që nuk prodhohen në vendin tonë. Po ashtu, burimet natyrore nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha vendet e botës. Kuptimi mbi tregtinë e lirë shërben edhe për të rritur konkurrencën, për zbatimin e metodave eficiente të prodhimit, për të ulur çmimet dhe rritur standardet e jetës së qytetarëve. Disa mallra që nuk shiten në vend i drejtohen tregjeve ndërkombëtare. Tregtia ndërkombëtare zgjeron kontaktet dhe zhvillon marrëdhëniet ndërmjet vendeve. Në këtë kontekst zhvillohet kursi i këmbimit valutor dhe politikat proteksioniste. Shtjellimi i problematikës ekonomike ndërkombëtare do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë më mirë ndërvarësinë globale ndërmjet vendeve.

1.4 . MUNDËSITË KURRIKULARE PËR INTEGRIMIN E LËNDËS SË EKONOMISË ME LËNDËT E TJERA

Njohuritë në lëndën e ekonomisë janë të integruara me njohuri që nxënësit marrin në lëndët e matematikës, historisë, gjeografisë etj. Kështu që përvetësimi i njohurive të kësaj lënde kërkon të integrohet me njohuritë e marra në lëndët e tjera. Më poshtë jepet tabela e integritimit ndërlëndor.

KËRKESAT NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Ekonomia	1. Matematika
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja: - Të gjejë dhe të interpretojë ekuacionin e vijës në plan. - Të interpretojë pozicionet e ndryshme të drejtëzës në plan, në varësi të koeficientit këndor. - Të llogaritë dhe përdorë përqindjen në raste të ndryshme. - Të jetë i aftë për të llogaritur mesataren. - Të bëjë përlllogaritjen e përpjesëtimeve. - Të jetë i aftë për të llogaritur indekset në raste të ndryshme. - Të interpretojë tabela, grafikë e diagrame.
Ekonomia	2. Gjuha shqipe
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja: - Të analizojë dhe interpretojë tekste të ndryshme. - Të shprehë opinione, të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe të debatojë në lidhje me probleme të ndryshme. - Të zhvillojë dialog, të dëgjojë me vëmendje. - Të bëjë prezantime duke përdorur teknika të ndryshme.
Ekonomia	3. TIK

Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja: - Të përdorë pajisje <i>Input/Autput-i</i>, CD, DVD, USB, disketa. - Të përdorë programe të ndryshme për punë të pavarura, për të krijuar tabela e paraqitje grafike dhe për të bërë prezantime të ndryshme (Uord, Excel, Pouer Point) etj. - Të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, Internetin etj. Për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. Të përdorë Internetin dhe kërkimin në Internet për të gjetur materiale që do të shërbejnë për diskutime dhe analiza të ndryshme.
Ekonomia	4. Gjuhët e huaja (Anglisht dhe Frëngjisht)
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja - Të zotërojnë fjalorin e domosdoshëm të përgjithshëm për të kuptuar dhe përkthyer materiale me përmbajtje ekonomike. - Të shfrytëzojnë fjalorin terminologjik në gjuhë të huaj si: biznes (business), sipërmarrje (enterprise), konsumator (consumer), treg (market), kërkesë (demand), ofertë (supply), papunësi (unemployment), inflacion (inflation), konkurrencë (competition), bankë (bank), kosto (cost), çmim (price), pamjaftueshmëri (scarcity) etj.
Ekonomia	5. Historia

Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja Të përshkruajë koncepte bazë si: pronë private, sistem ekonomik, monopol, korporatë, buxhet qeveritar etj. Të përdorë njohuritë për periudha dhe ngjarje të ndryshme historike në ndihmë të shpjegimit të ndikimit që kanë pasur ato në ekonomi.
Ekonomia	6. Gjeografia
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja Të përshkruajë koncepte bazë të tilla si: burime natyrore, burime njerëzore, eksport, import, papunësi etj. Të shpjegojë fenomenet e emigrimit dhe të migrimit dhe ta përdorë në funksion të tregut të punës. Të shfrytëzojë mjete mësimore si hartat, globin etj.

1.5 . OBJEKTIVAT E ARRITJES PËR KLASËN E 12-TË

Objektivat e përgjithshme të programit të ekonomisë janë si më poshtë.
Në përfundim të këtij programi nxënës/i-ja duhet të:

- të shpjegojë se si problemet ekonomike bazë, përbëjnë një sistem ekonomik, nëpërmjet të cilit u jepet zgjidhje problemeve dhe çështjeve të burimeve ekonomike, shpërndarjes së të ardhurave, stabilitetit dhe rritjes ekonomike;
- të klasifikojë sistemet ekonomike mbi bazën e zgjidhjes që shoqëria u jep çështjeve ekonomike bazë;
- të shpjegojë natyrën dhe veprimtarinë e sistemeve të ndryshme ekonomike;
- të identifikojë natyrën dhe tipat e sistemeve ekonomike bazuar

- në konceptet e nxitjes ekonomike, ndërhyrjes dhe rregullimeve të qeverisë në politikën e tregut;
- të shpjegojë ndërveprimin e forcave të tregut në përcaktimin e çmimeve të mallrave dhe faktorëve të prodhimit;
 - të trajtojë marrëdhëniet ndërmjet kushteve ekonomike dhe politikave të qeverisë;
 - të identifikojë faktorët që çojnë në stabilitet apo destabilitet ekonomik;
 - të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë, punës, dhe konkurrencës në sistemin e sipërmarrjes së lirë;
 - të shpjegojë rolin e financimit dhe investimit në suksesin apo dështimin e një biznesi, organizimin e bizneseve, strukturën e tregut dhe institucionet financiare që operojnë në një ekonomi tregu;
 - të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet papunësisë, inflacionit, politikave monetare dhe fiskale dhe efektet e tyre në ekonomi;
 - të interpretojë se si burimet dhe të ardhurat ekonomike shpërndahen përmes mekanizmit të çmimeve dhe politikave të qeverisjes;
 - të përvetësojë konceptet ekonomike bazë që shërbejnë për të matur performancën ekonomike dhe për të shpjeguar fenomenet ekonomike dhe si funksionon jeta ekonomike dhe përse mendimi ekonomik është i rëndësishëm për çdo individ;
 - të shpjegojë se shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve nxit ndërvlerësinë dhe zhvillimin ekonomik midis vendeve;
 - të tregojë mendimin kritik dhe aftësinë vendimmarrëse;
 - të zotërojë terminologjinë bazë që përdorin ekonomistët.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që t’i realizojnë ato. Realizimi i objektivave në kapituj ose në tema dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Kështu, për shembull, nëse programi i lëndës “Ekonomi” kërkon që nxënësi/ja të jetë i/e aftë të shpjegojë ndërveprimin e forcave të tregut në përcaktimin e çmimeve të mallrave dhe faktorëve të prodhimit, kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia të realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e një objektivi nxënësit duhet t’i jepet detyra, koha dhe mundësi të tjera që të mbledhë fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre.

Objektivat nuk duhet të mbeten abstrakt, të pa realizueshëm e të pa matshëm.

Nëse një mësues/ese nuk e bën këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Natyrisht që një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objektivi nga nxënës/i-ja, duke ju përmbajtur përshkallëzimit, si më poshtë:

- Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual).
- Aftësia për të shpjeguar dhe për të krahasuar (nivel mesatar intelektual).
- Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).

Për shembull, programi kërkon që nxënës/i-ja të jetë i/e aftë:

Të përcaktojë çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë të dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt.

Ky objektiv mund të arrihet në disa nivele:

Niveli bazë: të identifikojë çmimin dhe sasinë e ekuilibrit të kërkuar dhe ofruar kur është dhënë kërkesa dhe oferta.

Niveli mesatar: të bëjë dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar apo të ofruar të një produkti dhe një ndryshimi në kërkesë apo ofertë të këtij produkti.

Niveli lartë: të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër.

Programi realizohet edhe nëpërmjet zbatimit të kërkesave didaktike. Mësuesi duhet të njohë dhe të kërkojë zbatimin e kërkesave bazë, si:

- Nxënës/i-ja dallon kundërshtitë në pikëpamje.
- Nxënës/i-ja shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
- Nxënës/i-ja krijon qëndrimin e tij/saj për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve të ndryshme nga të vetat.

Së pari, mësues/i-ja duhet t'i krijojë çdo nxënës/i-eje mundësinë të shprehë arritjet e tij/saj në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësues/i-ja nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënës/i-eje që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij/asaj, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.

Së dyti, mësues/i-ja duhet të vlerësojë nxënësi/in-en për nivelin e arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij/asaj të gjitha mundësitë që të shprehë aftësitë e veta.

Kujdes i veçantë duhet treguar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive intelektuale dhe sociale të nxënësve, si ato të debatit, diskutimit, punës në grup etj. Kështu, mësuesi mund të japë si detyrë pyetje me nivele të ndryshme vështirësie, në përputhje me interesat e nxënësve, të cilat mund të shërbejnë si pikënisje për diskutim dhe debat në klasë. Për ta bërë debatin në praktikë dhe me interes shpesh herë duhet të sjellin në klasë probleme ekonomike të komunitetit ku jetojnë.

➤ **Më poshtë jepen objektivat e diferencuara, sipas niveleve të arritjeve të nxënësve:**

LINJA 1

Linja	Ekonomia e tregut
Nënlinja	Objektivat

1.1.Çfarë studion ekonomia?	Niveli bazë Niveli i mesëm Niveli i lartë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja: ▪ Të përkufizojë konceptet pamjaftueshmëri, kosto oportune, sistem ekonomik ▪ Të japë shembull personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj ▪ Të përshkruajë veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë ▪ Të përshkruajë rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë ▪ Të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim. ▪ Të shpjegojë konceptin pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar kosto oportune të saj ▪ Të shpjegojë se si i shpërndan burimet sistemi i ekonomisë së tregut ▪ Të shpjegojë fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut. ▪ Të interpretojë një kurbë të mundësive të prodhimit ▪ Të analizojë dhe vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor. ▪ Të analizojë se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor.
------------------------------------	--	---

1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	Niveli bazë Niveli i mesëm Niveli i lartë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja: ▪ Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre ▪ Të përgatisë një buxhet personal ▪ Të shpjegojë arsyet pse njerëzit kursejnë ▪ Të krahasojë metodat e ndryshme të kursimit ▪ Të shpjegojë avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi ▪ Të analizojë faktorët që ndikojnë në masën e kursimit
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	Niveli bazë Niveli i mesëm Niveli i lartë	Në përfundim të klasës 12 nxënësi/sja: ▪ Të shpjegojë se si tregu i lirë inkurajon sipërmarrjen. ▪ Të listojë format kryesore të organizimit të biznesit. ▪ Të dallojë burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit. ▪ Të gjykojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit. ▪ Të gjykojë mbi disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen. ▪ Të shpjegojë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit. ▪ Të dallojë ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit. ▪ Të analizojë/vlerësojë dallimet dhe të përbashkëtat organizative midis firmave individuale, firmave me ortakë dhe korporatave. ▪ Të analizojë një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.

1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	Niveli bazë	Ne përfundim të klasës 12 nxënësi/sja: ▪ Të bëjë dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël. ▪ Të llogarisë koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale. ▪ Të interpretojë grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale ▪ Të llogarisë produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar. ▪ Të zbulojnë veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit.
1.6. Struktura e tregut	Niveli bazë	Në përfundim të klasës 12 nxënësi/sja: ▪ Të interpretojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut. ▪ Të identifikojë nivelin konkurrencës së tregjeve në ekonomi. ▪ Të shpjegojë karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol. ▪ Të diskutojë raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve. ▪ Të krahasojë strukturat e ndryshme të tregjeve ▪ Të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin.
1.7 Tregjet e faktorëve të prodhimit	Niveli bazë	Në përfundim të klasës 12 nxënësi/sja: ▪ Të interpretojë ofertën për punë dhe kërkesën për punë. ▪ Të shpjegojë se si kërkesa dhe oferta për punë/kapital/tokë përcaktojnë çmimin e punës, kapitalit dhe tokës. ▪ Të vlerësojë shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.

LINJA 2

Linja		Ekonomia kombëtare
Nënlinja		Objektivat
2. 1. Qeveria dhe ekonomia	Niveli bazë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja: ▪ Të identifikojë dhe shpjegojë funksionin e qeverisë në një ekonomi tregu. ▪ Të përshkruajë disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin e qeverisë
	Niveli i mesëm	▪ Të përshkruajë disa propozime për të ulur deficitin buxhetor. ▪ Të shpjegojë pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve. ▪ Të shpjegojë arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm.
	Niveli i lartë	▪ Të krahasojë tipat e ndryshme të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale. ▪ Të interpretojë konceptet e deficitit buxhetor e borxhit publik dhe lidhjen e tyre. ▪ Të shpjegojë ndikimit e taksimit dhe vendimmarrjet e qeverisë për politika sociale ndaj subjekteve të veçanta. ▪ Të analizojë përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor.

2.2. Paraja dhe institucionet financiare	Niveli bazë Niveli i mesëm Niveli i lartë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja: ▪ Të identifikojë tipat e parasë në qarkullim, në vendin tonë. ▪ Të interpretojë konceptin e parasë, karakteristikat dhe funksionet e saj në një ekonomi monetare. ▪ Të përshkruajë organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë. ▪ Të shpjegojë ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si pranuese depozitash dhe dhënese huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare.
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik	Niveli bazë Niveli i mesëm Niveli i lartë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja: ▪ Të përcaktojë treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë ▪ Të bëjë dallimin midis GDP reale dhe GDP nominale. ▪ Të japë kuptimin mbi inflacionin, deflacionin. ▪ Të shpjegojë konceptin e forcës punëtore ▪ Të shpjegojë konceptin e GDP dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP ▪ Të përshkruajë metodat e matjes së GDP ▪ Të dallojë inflacionin e shkaktuar nga kostoja prej inflacionit të shkaktuar nga kërkesa ▪ Të dallojë format kryesore të papunësisë ▪ Të analizoje kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante. ▪ Të shpjegojë ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit ▪ Të analizojë fazat kryesore të ciklit të biznesit

2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	Niveli bazë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja:
	Niveli i mesëm	▪ Të përshkruajë mjetet e politikës fiskale ▪ Të përshkruajë mjetet e politikës monetare ▪ Të shpjegojë se politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria ▪ Të shpjegojë ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare ▪ Të dallojë instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale
	Niveli i lartë	▪ Të shpjegojë efektet direkte dhe indirekte të politikës fiskale ▪ Të identifikojë rrugët në të cilat politika monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit.

LINJA 3

Linja		Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare
Nënlinja		Objektivat
3.1 Tregtia ndërkombëtare	Niveli bazë	Në përfundim të klasës 12-të nxënësi/sja:
	Niveli i mesëm	▪ Të shpjegojë konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese ▪ Të përshkruajë disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare ▪ Të shpjegojë pse luhaten kurset e këmbimit valutor. ▪ Të japë në mënyrë të përmblëdhur argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë ▪ Të bëjë dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar
	Niveli i lartë	▪ Të argumentojë përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbëjnë midis tyre ▪ Të analizojë përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj.

1.6. OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË ARRITJES NË KURRIKULËN E LËNDËS SË EKONOMISË

Objektivat e arritjeve të një kapitulli, përbëjnë bashkësinë e të gjitha objektivave specifike të hartuara për të gjitha objektivat e kapitullit ose linjës, nënlinjës, të ndara në tre nivele duke u nisur nga objektivat e programit.

Objektivat e programit janë më të përgjithshme se ato të linjave/nënlinjave dhe këto të fundit përsëri janë disi të përgjithshme dhe shtrihet nevoja për detajimin në objektiva më specifike.

Një objektiv i programit mund të jetë i niveleve të ndryshme. Kështu, nëse programi kërkon që nxënësit të krahasojë një dukuri ekonomike me një tjetër, ky objektiv është i nivelit baze. Për një përcaktim më të saktë të arritjeve na duhet që edhe në këtë nivel të diferencohen tre përshkallëzime arritjesh. Pra të përcaktohen tre objektiva specifike, me tre hapa arritjesh.

Gjatë degëzimit në nivele mbahet parasysh fakti që arritja që kërkohet nga nxënësi, sipas objektivave të programit përbën arritjen maksimale që kërkohet prej tij (për të cilën nxënësi do të vlerësohet me notën maksimale po që se i plotëson kriteret përkatëse)

Na duhet të theksojmë se mësuesi duhet t'i rreshtojë objektivat specifike sipas renditjes së objektivave të linjës/nënlinjës, kurse për ta pasur më të lehtë për përdorim në mësim sugjerohet t'i rendisë sipas temave. Po kaq e rëndësishme është të theksohet se mësuesi do të formulojë objektiva specifike të mbështetur në objektivat e programit dhe jo në materialin e tekstit sepse teksti mund të ketë edhe pjesë të tepërta, suplementare, përkundrejt orientimeve të programit.

Nëse teksti mund të paraqes mangësi në realizimin e objektivave të programit, atëherë mësuesi duhet të punojë për t'i plotësuar ato.

Formulimi i një objektivit specifik ka një strukturë të përcaktuar që jepet në mënyrë standarde. Për këtë qëllim ka disa rregulla të sakta dhe kritere që mësuesi duhet të mbajë parasysh gjatë hartimit të tij.

Objektivi specifik, siç u trajtua dhe më lartë është degëzim i një objektivit të përgjithshëm.

Për zbatimin e tij ndiqen katër hapa, apo procese, që janë:

- Adresa
- Detyra
- Mënyra
- Kushti `

Adresa – Tregon se me cilën pjesë të lëndës, kapitullit, lidhet objektivi. P.sh.

- Në fund të klasës së 12-të në lëndën e ekonomisë nxënësi.....
- Në fund të kapitullit “Ç’është ekonomia” nxënësi.....
- Në fund të temës/orës së mësimit “Kërkesa dhe faktorët që ndikojnë në kërkesë”, nxënësi.....

Detyra – Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e objektivit specifik. Në këtë pjesë përshkruhet se çfarë duhet të jetë i aftë (në gjendje) të bëjë nxënësi.

Ka rëndësi të theksohet se kjo pjesë nuk duhet të mungojë asnjëherë.

P.sh:

- të përkufizojë koston oportune
- të shpjegojë se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallit dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre
- të vlerësojë shkallën me të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.

Kur shkruhet detyra që nxënësi duhet të jetë i aftë të bëjë..., është shumë e rëndësishme që kjo detyrë të jetë e matshme dhe të përmbajë një detyrë jo dy. Kështu p.sh nuk duhet që, në këtë nivel t’i kërkohej nxënësit që të përkufizojë edhe koston oportune edhe pamjaftueshmërinë.

Mënyra - Kjo pjesë e objektivit tregon mënyrën si do të kryhet detyra. Mënyrat e realizimit të detyrës mund të jenë nga më të ndryshme. Përcaktimi i një mënyre, nënkupton se ka dhe mënyra të tjera të realizimit të detyrës. Nëse ekziston vetëm një mënyrë e realizimit të detyrës, atëherë alternativa e mënyrave të tjera nuk mund të jetë pjesë e realizimit të një objektivit specifik.

Kushti - kjo pjesë e objektivit ka të bëjë me kushtin e realizimit të tij. Edhe kjo pjesë nuk është e detyrueshme gjithmonë. Si kushte të realizimit të objektivit mund të jenë p.sh.: brenda orës së mësimit, për 15 minuta, duke u bazuar në tabelën e kërkesës dhe ofertës, duke marrë pjesë në një lojë me role etj.

Deri tek përmbushja e objektivit të përgjithshëm, gjatë mësimdhënies, çdo objektivi i programit degëzohet edhe në objektiva të ndërmjetëm ose nënobjektiva, të cilat përshkruajnë arritjet hap pas hapi të nxënësve.

Më poshtë po japim disa shembuj formulimesh të objektivave specifike, bazuar në objektivat e programit.

Shembulli 1.

Linja: Ekonomia e tregut

Nënlinja: Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut.

Objektivi: Në përfundim të klasës së 12-të nxënësi/sja:

Të përcaktojë çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë, kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt.

Objektivat specifikë:

Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ Të përkufizojë çmimin ekuilibër
- ❖ Të përkufizojë sasinë ekuilibër
- ❖ Të gjejë çmimin ekuilibër të një produkti bazuar në tabelën e kërkesës dhe ofertës për këtë produkt
- ❖ Të gjejë çmimin ekuilibër për një produkt të dhënë bazuar në grafikun e kërkesës dhe ofertës për këtë produkt.

Shembulli 2.

Linja: Ekonomia e tregut

Nënlinja: Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut.

Objektivi: Në përfundim të klasës së 12-të nxënësi/sja:

Të interpretojë lakoren e kërkesës dhe ofertës.

Objektivat specifikë:

Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ Të ndërtojë lakoren e kërkesës bazuar në tabelën e kërkesës për këtë produkt, brenda 10 minutash
- ❖ Të ndërtojë lakoren e ofertës bazuar në tabelën e kërkesës për këtë produkt, brenda 10 minutash

- ❖ Të shpjegojë pse grafiku i kërkesës ka pjerrësi negative (rënëse), bazuar në ligjin e kërkesës
- ❖ Të shpjegojë pse grafiku i ofertës ka pjerrësi pozitive (rritëse), bazuar në ligjin e ofertës.

Shembulli 3.

Linja: Ekonomia e tregut

Nënlinja: Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut.

Objektivi: Në përfundim të klasës së 12-të nxënësi/sja:

Të shpjegojë se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe/ose ofertë.

Objektivat specifikë:

Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ Të listojë faktorët që ndikojnë në ndryshimet në kërkesë
- ❖ Të listojë faktorët që ndikojnë në ndryshimet në ofertë
- ❖ Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në kërkesë ose ofertë
- ❖ Të identifikojë 4 produkte që janë bërë më të shtrenjtë, ose më të lirë (për çdo rast) krahasuar me produkte të tjera, si rezultat i ndryshimeve në kërkesë ose ofertë
- ❖ Të shpjegojë grafikisht ndryshimet e çmimit të tregut për një mall të caktuar kur kërkesa rritet dhe oferta ulet. (*Këtu ka dhe raste të tjera: kërkesa rritet oferta rritet, kërkesa ulet oferta rritet etj.*)

Shënim: Objektivat e mësipërm realizohen për më shumë se një orë mësimi. Orët e mësimi përcaktohen nga mësuesi në bazë të ecurisë së nxënësve dhe nivelit të klasës ku jep mësim.

Shembulli 4.

Linja: Ekonomia kombëtare

Nënlinja : Treguesit kryesorë makroekonomikë

Objektivi: Në përfundim të klasës së 12-të nxënësi/sja:

Të dallojë format kryesore të papunësisë

Objektivat specifikë

Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ të listojë format kryesore të papunësisë
- ❖ të shpjegojë çdo formë papunësie
- ❖ të japë nga dy shembuj praktik për çdo tip papunësie, bazuar në përkufizimin e saj.

Shembulli 5.

Linja: Ekonomia kombëtare

Nënlinja : Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomikë

Objekti: Në përfundim të klasës së 12-të nxënësi/sja:

Të shpjegojë efektet direkte dhe indirekte të politikës fiskale në papunësi, inflacion dhe rritjen e ekonomisë.

Objektivat specifikë

Në fund të orës së mësimi nxënësi të jetë i aftë:

- ❖ Të identifikojë shembuj historik të politikave fiskale të qeverisë shqiptare
- ❖ Të shpjegojë bazuar në shembuj praktik nëse politikat fiskale të zbatuara nga qeveria shqiptare kanë influencë në nivelin e *outputit*, punësisë, nivel çmimesh apo në të tria.
- ❖ Të paraqesë (prezantojë) politika fiskale që duhen rekomanduar për të rregulluar
 - rritjen e papunësisë
 - rritjen e inflacionit
- ❖ të shpjegojë secilin rekomandim
- ❖ të luajë një lojë me role si anëtar i qeverisë dhe duke u bazuar në titujt e artikujve të mëposhtëm, të rekomandojë një politikë ekspansioniste apo jo ekspansioniste dhe nëse qeveria duhet të blejë apo të shesë obligacione shtetërore

Kryetitujt e gazetave:

- a. Norma e papunësisë rritet me shpejtësi.
- b. CPI rritet për 3 muaj rresht

Shënim: Objektivat e mësipërm realizohen për më shumë se një

orë mësimi. Orët e mësimi përcaktohen nga mësuesi në bazë të ecurisë së nxënësve dhe nivelit të klasës ku jep mësim.

2. METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË EKONOMISË

Metodat që duhet të përdoren për realizimin e objektivave në lëndën e ekonomisë duhet të jenë të shumta dhe të larmishme. Është shumë e rëndësishme që të përdoren metoda, teknika, strategji mësimore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse që kanë të bëjnë me bashkëveprimin dinamik, fleksibël dhe të hapur midis mësuesit si dhe vetë nxënësve. Gjatë përdorimit të këtyre metodave dhe strategjive gjithëpërfshirëse duhet të kihen parasysh që të zbatohen momentet e mëposhtme.

- Mësuesi dhe nxënësi të jenë *bashkautorë* të orës së mësimi
- Mësuesi të luajë rolin e *drejtuesit dhe të organizuesit të orës së mësimi* ndërsa nxënësit të *gjithë përfshihen* gjatë tërë procesit mësimor. Kjo kërkon planifikimin dhe organizimin e veprimtarive të larmishme që të përfshijnë të gjithë nivelet e formimit të nxënësve.
- Mësimdhënia dhe të nxënit duhet të jenë *procese të lidhura dhe të ndërvarura* nga njëra-tjetra.
- Mësimdhënia duhet drejtuar në krijimin e njohurive e të *vlerave intelektuale, të shkathtësive, qëndrimeve dhe reflektimit* individual dhe në grup.

Vërtet që këto metoda, teknika duhet të jenë të larmishme dhe të shumëllojshme, por kërkohet që këto metoda:

- të transmetojnë njohuri
- të zhvillojnë aftësi
- të kultivojnë vlera dhe qëndrime tek nxënësit

Ndër metodat që mund të përdoren gjerësisht dhe shpesh mund të jenë:

A. Metoda e punës në grup:

- në grup të madh –(klasa) si diskutimi, debati. p.sh nxënësit mund të diskutojnë për rrugët e përdorimit të parave që kursejnë,

- në grup të vogël –(dyshe ose 3-4 nxënës). Në këto raste duhet: të jepet detyra, të diskutohet dhe mendimet të shkruhen në flete, të prezantohet dhe të diskutohen në grup të madh - në klasë. P.sh nxënësve të ndarë në grupe të vogla mund t'i jepet si detyrë të hulumtojnë tregun e mallrave /punës dhe të shpjegojnë arsyet e ndryshimeve dhe prirjet e tyre,
 - lojë me role ose simulimi, gjatë të cilave nxënësit simulojnë situata reale të jetës së tyre të përditshme. P.sh nxënësit mund te vihen ne rolin e punëdhënësit ose te punëmarrësit gjatë intervistave për pune.
- B. Metodatat e hulumtimit,** të cilat u japin mundësi nxënësve të praktikojnë aftësitë e tyre, të nxjerrin përfundime dhe t'i zbatojnë ato në situata të reja dhe/ose të japin opsione të ndryshme zgjidhjesh mbi probleme të caktuara të jetës.

Teknika të metodave të hulumtimit mund të jenë:

- Studimi i rastit – studiohet një rast ose situatë e veçantë që është komplekse mbi bazën e të cilit nxënësit bëjnë përgjithësime. Kjo metodë i ndihmon që të kuptojnë më mirë çështjet e vështira.
 - Puna me projekte, që mund të jetë një veprimtari individuale ose në grup që kërkon hulumtimin dhe zgjidhjen e një problemi të caktuar që bëhet brenda një kohe të caktuar. Në këto raste nxënësit duhet të punojnë nën udhëheqjen e mësuesit.
 - Vizitat në biznese të ndryshme, qendra pune për të njohur problemet, proceset, dukuritë në jetën e tyre reale.
 - Vrojtimi kërkon që nxënësi të vëzhgojë një proces, një dukuri të caktuar, një element të caktuar për të regjistruar çdo gjë që ndodh me këtë dukuri dhe pastaj të përpunojë dhe të publikojë përfundimet.
 - Zgjidhja e problemit, nga vetë emri kjo teknikë synon zgjidhjen e një problemi ose një çështje të caktuar, problem i cili mund t'i jepet nga mësues ose mund të identifikohet nga nxënësi.
- Meqenëse në lëndën e ekonomisë metoda e punës me projekte mund të përdoret gjerësisht atëherë po ofrojmë metodikën e punës me projekte, e cila paraqitet si më poshtë:

Hapi i parë

Përgatitja paraprake për projektin:

- Paraqitet projekti që do të ndërmerret.
- Caktohet koha e realizimit të projektit.
- Formulohen objektivat e projektit.
- Përcaktohen partnerët e projektit (mësues, nxënës, prindër, anëtarë komuniteti etj).
- Përcaktohen aktivitetet e projektit.
- Përcaktohen produktet e projektit.

Hapi i dytë

Puna rreth projektit:

- Zbatohen detyrat e përcaktuara nga mësuesi për të realizuar detyra të caktuara.
- Formulohen pyetësor që do të shërbejnë për të mbledhur informacion.
- Plotësohen pyetësorët dhe nxirren të dhënat.
- Zhvillohen intervista të paracaktuara duke nxjerrë konkluzione përkatëse.
- Ruhen vrojtimitet e bëra nga nxënësit.
- Grumbullohen të gjithë materialet që kanë të bëjnë me pyetësorët, intervistat, vrojtimitet dhe nxirren përfundime mbi bazën e tyre.
- Sistemohen të dhënat dhe nxirren përfundimet përkatëse prej tyre.

Hapi i tretë

Raportimi rreth projektit:

- Nxënësit përgatisin raportin përfundimtar të rezultateve të projektit me mjete të ndryshme.

➤ **Më poshtë po ofrojmë një model mësimi**

MESIMI 1

TEMA: PSE NJERËZIT TREGËTOJNË?

HYRJE

Tregtia sipas shkencës ekonomike është shkëmbimi i vullnetshëm i të mirave dhe shërbimeve. Shumica e tregtisë ndërkombëtare është këmbim vullnetar i mallrave dhe shërbimeve midis individëve dhe bizneseve të lokalizuara në vende të ndryshme. Kombet nuk tregtojnë. Në të vërtetë, janë individët përfaqësues të kombeve, individët përfaqësues të bizneseve dhe individët që përfaqësojnë veten e tyre, që marrin vendime për të tregtuar. Tregtia e vullnetshme bëhet kur të dyja palët presin të fitojnë prej tregtisë. Një tregti e tillë mund të vazhdojë në të ardhmen, nëqoftëse të dyja palët janë të kënaqur me këmbimin. Nëse rrjedhojat e tregtisë nuk janë të kënaqshme, atëherë palët nuk do të vazhdojnë tregtinë e tyre të bazuar në vullnetin e lirë.

Njerëzit vlerësojnë kënaqësinë e tyre nga tregtia duke peshuar kostot dhe përfitimet që ata marrin prej saj. Sa e vlerësojnë atë nga e cila ata heqin dorë? Sa e vlerësojnë atë që marrin? Njerëzit tregtojnë kur përfitimet e pritura vlerësohen me shumë se kostot e pritura. Njerëzit nuk tregtojnë kur kostot e pritura vlerësohen më shumë se përfitimet e pritura.

KONCEPTET

Tregtia

Këmbimi vullnetar

Kostot

Përfitimet

PËRMBAJTJA E STANDARTEVE

Këmbimi vullnetar ndodh vetëm kur të gjitha palët pjesëmarrëse, presin të fitojnë. Kjo gjë është e vërtetë për tregtinë midis individëve ose organizmave brenda një kombi dhe midis individëve dhe organizmave në kombe të ndryshme.

Këmbimi është tregtia e mallrave dhe shërbimeve me mallra dhe

shërbime të tjera ose me para.

Forma më vjetër e këmbimit është tregtia direkte e mallrave dhe shërbimeve.

Kur njerëzit blejnë diçka ata e vlerësojnë atë më shumë se kostoja e tyre; kur njerëzit shesin diçka ata e vlerësojnë atë më pak se pagesa që ata marrin.

OBJEKTIVAT

- Identifiko kostot e pritura në tregtinë vullnetare.
- Identifiko përfitimet e pritura në tregtinë vullnetare.
- Dallo tregtinë vullnetare nga ajo jo vullnetare.
- Shpjego se si krijohet vlera dhe si rritet kënaqësia, kur njerëzit tregtojnë.

PËRSHKRIMI I MËSIMIT

Nxënësit marrin pjesë në një aktivitet tregtar. Në sesionin përmbledhës ata diskutojnë veprimet e tyre dhe krahasojnë sjelljet e tyre me sjelljet tregtare që ndodhin në një ekonomi.

KOHA E KËRKUAR

Një orë mësimore

MATERIALET

- Transparente Visual 1, 2 dhe 3 (shih më poshtë).
- Lapsa dhe letra për nxënësit.
- Një çantë e vogël letre për çdo nxënë, që përmban një ose më shumë artikuj të tregtushëm, të tilla si fruta të thara, kuti të vogla me rrush të thatë, lapsa, ngjitëse, shampo, sapun etj. Përgatisni çanta me asortimente të ndryshme nga njëra tjetra. Për shembull, përgatisni disa çanta që përmbajnë artikuj jo të njohur, vetëm me një artikull, shumë nga i njëjti artikull, artikuj më të njohur për djemtë, artikuj më të njohur për vajzat.

PROCEDURAT

1. Vendosni nxënësit nëpër grupe me nga 3 vetë dhe thuajti atyre të nxjerrin një laps dhe një letër.
2. Shpjegojuni nxënësve se do të investigojnë sjelljet tregtare, duke marrë pjesë në një aktivitet tregtar dhe duke përdorur përvojën, të përpiqen të mësojnë më shumë rreth tregtisë ndërkombëtare.
3. Shfaqni Vizual 1: Pse njerëzit tregtojnë? Pasi i keni pyetur nxënësit, shkruani përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë. Trajtoni këto si përgjigje hipotetike, që do të testohen përkundrejt fakteve të zhvilluara në pjesën e mbetur të aktivitetit.
4. Shpërndani çantat që përmbajnë artikuj të tregtushëm për nxënësit. Thuaj që fillimisht të mos shikojnë në to, derisa t'u jepet leja për ta bërë këtë.
5. Thuaj të shikojnë në çantat e tyre pa ua treguar nxënësve të tjerë përmbajtjen dhe të klasifikojnë objektet në shkallën 1-5. (1 është më e ulët dhe 5 më e lartë). Kërko të shkruajnë klasifikimin e tyre në flete.
6. Lëri që t'i nxjerrin artikujt nga çanta dhe t'ua tregojnë ato anëtarëve të tjerë të grupit, nëse ata zgjedhin për ta bërë këtë.
7. Lejo që për dy minuta të tregtojnë artikujt brenda grupit të tyre prej 3 vetash, nëse ata mund të bien dakord mbi tregtinë. Askujt nuk i kërkohet të bëjë tregti.
8. Pas dy minutash sesi tregtie, kërkojuni të ngrenë dorën ata nxënës që bënë tregti. Shkruaj në tabelë numrin total të veprimeve tregtare. Pastaj kërkonit të japin shembuj të tregtive që ata bënë dhe tregtive për të cilat nuk ranë dakord për të bërë, në mënyrë që nxënësit e tjerë të kenë një ide se çfarë artikujsh të tregtueshëm janë të vlefshëm në gjithë tregtinë e kryer në klasë.
9. Kërkonit të klasifikojnë artikujt që tani ata kanë, në shkallën nga një deri në pesë. Vini re sa nxënës raportojnë shkallën më të lartë pas tregtisë, sa raportojnë të njëjtën shkallë dhe sa (nëse ka) në shkallën më të ulët. (Njerëzit që tregtuan ka të ngjarë që t'i japin artikullit një shkallë më të lartë. Disa syresh, që nuk tregtuan, mundet gjithashtu të ndryshojnë klasifikimin e tyre, tani që ata kuptojnë se çfarë artikujsh janë më të vlefshëm. Është e rëndësishme të vërehet që personi i cili tregtoi një artikulli mund t'i ketë dhënë atij tre, ndërsa një tjetër, i cili e mori mund t'i ketë dhënë dy. Kjo nuk do

te thotë që tregtia nuk ishte me përfitim. E rëndësishme është që njerëzit, të cilët morën një artikull i dhanë atij një pikëzim më të lartë se pikëzimi i atij artikulli që ata dhanë (tregtuan).

10. Njoftoni nxënësit se do të kenë edhe një sesion tjetër tregtie. Këtë herë ata mund të tregtojnë me çdonjërin në klase. Tani ata kanë 5 minuta kohë në dispozicion, për të kryer çdo veprim tregtie, që ata dëshirojnë. Përsëri askujt nuk i kërkohet të tregtojë.
11. Në fund të 5 minutave të sesionit të dytë të tregtisë, u thoni nxënësve të kthehen në pozicionet e tyre. Kërkoni të shfaqin në bankën e tyre artikujt që tani ata zotërojnë. Kërkoni atyre të klasifikojnë artikujt nga 1-5.

Drejto diskutimin përmbledhës me nxënësit, duke përdorur pyetjet e mëposhtme:

- A. Sa prej nxënësve bënë tregti? *(të ngrenë dorën lartë)*
- B. Çfarë sendesh tregtuan? *(Merrni disa përgjigje)*
- C. Sa nga ata tregtuan në Raundin e parë?, po në Raundin e dytë? *(duart e ngritura përgjithësisht tregojnë se në Raundin e dytë u tregtua më shumë se në Raundin e parë.)*
- D. Pse u tregtua më shumë në Raundin e dytë sesa në Raundin e parë? *(pati më shumë kohë për të tregtuar, ekziston një informacion më i mire mbi tregtinë, si rezultat i përvojës që përfituan në Raundin e parë, kishte më shume artikuj alternativë, të vlefshëm për t'u tregtuar. Thekso idenë që tregtia në Raundin e parë ka një analogji me tregtinë brenda një vendi, ndërsa tregtia në Raundin e dytë ka një analogji me tregtinë ndërkombëtare. Vini re që burimet e fitimeve prej tregtisë janë ekzaktësisht të njëjta në të dyja Raundet, pra, si në tregtinë brenda vendit dhe në atë ndërkombëtare. Në të dyja raundet nxënësit tregtuan gjëra, kur ata vlerësuan më shumë atë që morën, nga ajo që ata dhanë.)*
- E. Cilat prej sendeve ishin më shumë të njohura dhe më pak të njohura?
- F. A tregtoi ndonjëri prej jush më shumë se një herë? *(Disa prej pjesëmarrësve do të kenë bërë disa herë tregtimin e sendeve)*
- G. Përse tregtuat? *(Njerëzit përgjithësisht janë të prirur të heqin dorë prej sendeve të cilat i vlerësojnë më pak, për të siguruar sende që i*

vlerësojnë më shumë)

H. Çfarë kosto dhe përfitimi patët nga tregtia që bëtë. *(Ajo që u tregtua tek të tjerët përbën koston e tregtisë. Ajo që u mor nga të tjerët përbën përfitimin?)*

I. Sa nxënës e klasifikuan artikullin që ata tregtuan më lartë se ai që kishin? *(Pothuajse çdo njeri që tregtoi e klasifikoi artikullin e ri më lartë.)*

J. A bëri ndonjëri gabim, pra bëri një tregti të keqe? A dështoi ndonjëri në bërjen e një veprimi, që tani do të donte të bënte? *(Shpesh, dikush do të bëjë gabim. Jo të gjitha tregtitë u realizuan siç priteshin dhe jo çdo mundësi tregtie u kap.)*

K. Nëse nxënësit thonë se bënë gabime, pyeti nëse ata do të mund ta bënin të njëjtin gabim herën tjetër. *(Ndoshta jo. Njerëzit tentojnë të mësojnë prej gabimeve dhe tregtitë e këqija shpesh i çojnë njerëzit të ndalojnë së bëri tregti ose të ndalojnë tregtinë me njerëz apo kompani të caktuara.)*

L. Cilët kishin më shumë vështirësi për të tregtuar me të tjerët? *(nxënësit me artikuj jo të njohur. Për të bërë tregti, ju duhet të keni ose të prodhoni artikuj që njerëzit e tjerë duan.)*

M. Pse disa nxënës zgjodhën për të mos tregtuar? *(Njerëzit të cilët preferuan artikujt që ata kishin përkundrejt artikujve që atyre u ofruan, nuk kishin nevojë për të tregtuar.)*

N. A jeni të kënaqur me tregtinë që bëtë?

(Ndoshta JO. Pjesëmarrësit të cilët kishin pak për të tregtuar ndoshta nuk kanë mbetur të kënaqur. Pjesëmarrësit të cilët kishin sende të tjera nuk duan ta ndjejnë veten si të “lënë pas dore”. Pjesëmarrësit të cilët nuk gjetën atë që kërkonin ndoshta janë të pakënaqur. Pjesëmarrësit të cilët bënë dhe më pas kuptuan se mund të kishin bërë një tregti tjetër më të mirë, mund të jenë të mërzhitur. Së fundi, pjesëmarrësit të cilët nënvlerësuan kostot e tregtimit ose mbivlerësuan kostot e tregtimit ose mbivlerësuan përfitimin e saj (ose që i bënë të dyja këto veprime) mund të jenë të mërzhitur. Tregtia nuk garanton sukses. Ekonomistët deklarojnë vetëm atë, që tregtia do të vazhdojë në rast se njerëzit do të mendojnë se ajo ka sjellë një përmirësim, i cili nuk do të vinte në rast se tregtia nuk do të ishte bërë)

O. Nëse nesër do të mund të bëhet një seancë tjetër tregtie, kush do të dëshironte të merrte pjesë? *(Nxënësit të cilët besojnë se përfitimet e*

tregtisë do të jenë më të mëdha se kostot e saj, do të pranojnë. Njerëzit të cilët besojnë për të kundërtën, nuk do të jenë më të interesuar për të marrë pjesë)

P. Në çfarë momentesh ka ngjashmëri midis seancës së tregtimit dhe tregtisë në realitet? Krahasoni veprimet tregtare që kryet në këtë seancë p.sh me një adoleshent që furnizon makinën me karburant dhe për disa litra naftë paguan 1000 lekë, dhe nxirrni ngjashmëritë. Disa ndryshime janë të dukshme. Gjatë këmbimit të sendeve në seancën e tregtisë nuk janë përdorur paratë dhe pjesëmarrësit nuk u është dashur të punojnë për të pasur sendet që ata tregtuan.

Vizualet:

VISUAL 1

PSE NJERËZIT TREGTOJNË?

VISUAL 2

TREGETIA ËSHTË KËMBIM VULLNETAR I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE MIDIS INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE.

VISUAL 3

MOTIVE PËR TË TREGËTUAR: NJERËZIT PRESIN TË FITOJNË DUKE TREGETUAR ME NJERËZ TË TJERË. ATA SHPRESOJNË TË MARRIN NJË MALL OSE SHËRBIM QË ËSHTË MË I VLEFSHËM SE ÇDO GJË TJETËR QË ATA TREGËTOJNË.

MOTIVE PËR TË MOS TREGËTUAR:

NJERËZIT NUK TREGTOJNË KUR MALLI OSE SHËRBIMI QË I OFROHET ËSHTË MË PAK I VLEFSHËM SE MALLI OSE SHËRBIMI QË ATYRE U KËRKOHET TË KËMBEJNË.

Shfaq Vizualin 2. Shpjego se ata duhet të nxjerrin disa përfundime rreth tregtisë në përgjithësi. Shiko nëse ata bien dakord me përcaktimin e tregtisë prezantuar në Vizualin 2. Thekso natyrën *vullnetare* të tregtisë.

Shfaq vizualin 3. Kërko që nxënësit, nëse ata bien dakord me këto

deklarata rreth motiveve për tregti. Kërko shembuj të motiveve të tyre gjatë aktivitetit tregtar, i cili përputhet me këto deklarata.

Krahaso këto shpjegime të nxënësve që tregtuan me deklaratat fillestare të nxënësve të Vizualit 1. Rishiko deklaratat fillestare në mënyrë që ato të përputhen me faktet nga aktivitetit dhe deklaratat në Vizualin 3.

Përmblihdh pikat kryesore të mësimit:

- A. Tregtia është këmbim vullnetar i mallrave dhe shërbimeve.
- B. Njerëzit tregtojnë sepse ata presin të fitojnë prej tregtisë.

Informacion:

Për të krijuar një kuptim të drejtë mbi tregtinë që kryhet edhe jashtë vendit, parashtroni informacionin si më poshtë, dhe kërko t'i përgjigjen pyetjes.

Në 1994, bizneset dhe individët kanadezë shitën në SHBA \$195.8 bilion mallra dhe shërbime, ndërsa bizneset dhe individët amerikane shitën në Kanada \$229.7 bilion mallra dhe shërbime. Përse këta individë dhe biznese tregtuan me njeri- tjetrin, kur ata jetojnë në vende të ndryshme?

(Përgjigja e sugjeruar: Ata tregtuan sepse ata llogaritën se do të fitonin prej këtyre këmbimeve, përndryshe ata nuk do të kishin bërë tregti. Qytetaria kombëtare është kusht për zhvillimin e një kombi, por kjo nuk i pengon, kur është fjala për të marrë vendime në fushën e tregtisë.)

Mbyllja

Ndani me nxënësit përfundimin e mëposhtëm: Ky aktivitet shërben për t'u aftësuar në disa kompetenca bazë në të bërit e tregtisë si dhe për të kuptuar shtrirjen e tregtisë edhe jashtë një vendi. Nëpërmjet këtij mësimi krijohet një analogji edhe me tregtinë botërore. Kujtoni konceptet e kostos, përfitimit dhe tregtisë botërore. Ideja që mësuat sot, do t'iu ndihmojë për të kuptuar rregullat e përbashkëta për tregtinë që zhvillohet në mbarë botën.

3. VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënës/it-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it-ses nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si: qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Programi i ekonomisë ofron shumë mundësi për të vlerësuar përparimin e nxënësve në mënyrë të tillë që ky vlerësim të shprehë ose të matë rritjen e nivelit të dijeve dhe zhvillimin e personalitetit të nxënësit, të nxisë dëshirat e tyre për arsimin të mëtejshëm apo për karrierë si dhe të sigurojë dhënien e mendimeve nga ana e nxënësve tek mësuesi lidhur me atë se çfarë duhet përmirësuar.

Vlerësimi mund të jetë formues, diagnostikues, përmbledhës (i përgjithshëm)

Vlerësimi diagnostikues përdoret për të vlerësuar njohuritë, shprehitë, qëndrimet e nxënësve në fillim të vitit apo para çdo kapitulli.

Vlerësimi formues zhvillohet gjatë procesit të zhvillimit të lëndës. Kështu mund të përdoren ushtrime të ndryshme për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në zbatimin e parimeve ekonomike, në analizën dhe vlerësimin e informacionit në marrjen e vendimeve apo në argumentimin e opinionëve.

Ka edhe forma të tjera që përdoren për vlerësimin formues dhe diagnostikues që janë:

- Puna në grupe, pjesëmarrje në diskutime.
- Prezantimi i çështjeve apo problemeve të ndryshme ekonomike në formë referati.
- Detyra me karakter kërkimor apo projekte të ndryshme
- Kontrolli i detyrave të shtëpisë

- Materiale vlerësuese të përgatitura nga nxënësit

Vlerësimi i përgjithshëm përdoret për të matur arritjet e nxënësve në fund të një kapitulli apo në fund të vitit shkollor dhe shërben edhe për të vlerësuar efektivitetin e programit. Objektivat e përcaktuar qartë janë element kyç për një vlerësim të përgjithshëm, të suksesshëm. Mësuesit duhet t’ua parashtrojnë objektivat nxënësve, që ata të dinë se për çfarë do të vlerësohen.

Llojet e vlerësimeve

1. Para-test
2. Vlerësimi objektiv
3. Vlerësimi subjektiv
4. Vetëvlerësim
5. Teste praktike
6. Pjesëmarrja
7. Lloje të tjera vlerësimi

1. Para testi. Mund ta përdorni për t’ju ndihmuar të zbuloni nëse nxënësit i arrijnë njohuritë bazë dhe nivelin e kërkuar të aftësive për të mësuar materialet e programit. Ju mund të bëni parateste përpara çdo linje, moduli, jave apo çështje.

2. Vlerësimi objektiv. Ky lloj testimi zakonisht realizohet me pyetje me alternativë; e vërtetë apo e gabuar; me pyetje që kërkojnë përgjigje të shkurtra. Këto lloj testesh duan përgjigje të prera të sakta dhe nuk krijojnë hapësira për përgjigje të tjera. Testet objektive përmbledhin përgjigjet e vërteta dhe të gjithë nxënësit duhet të mësojnë të njëjtat gjëra.

3. Vlerësimi subjektiv. Në këtë lloj vlerësimi është gjykimi i mësuesit, i cili përcakton notën për nxënësin. Këto tipa testesh përfshinë teste në formë e eseve.

Këto teste – ese kërkojnë nga nxënësi më shumë kohë për t’u përgjigjur. Këto lloj testesh janë të fokusuara në koncepte komplekse dhe në vlerësimin e detajuar të tyre.

4. Vetëvlerësimi.

Ky lloj testimi:

- është refleksion i nxënësit për të mësuarit
- ndihmon nxënësit të kuptojnë nëse e kanë kuptuar çështjen

- i jep mundësi nxënësit që të masë vetë procesin e të mësuarit
- zakonisht përdoren vullnetarisht, mbi bazën e motivimit
- informon nxënësit, por jo mësuesin
- mund të bëhet nëse performanca e një aktiviteti është e lidhur me feedback-un rreth asaj performance.

Shembuj të testeve vetëvlerësues që mund të përdoren janë: pyetësorët, lojra, simulime, detyra me shkrim etj.

5- Provime praktike

Ushtrime praktike dhe detyra shtëpie janë të shpeshta për nxënësit. Nxënësit që i bëjnë detyrat praktike zakonisht ndeshin pak problem gjatë provimeve me shkrim të kapitullit apo përfundimtare. Këta nxënës kapërcejnë problemet teknike dhe dinë çfarë të presin nga tipat e pyetjeve të provimeve përfundimtare.

Është e rëndësishme që nxënësit të dinë se pyetjet praktike do të jenë të njëjta me ato që ato ndeshin në provimet e tyre.

6. *Pjesëmarrja* aktive në mësim është një metodë alternative e vlerësimit të nxënësve. Një mënyrë e mirë për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve në klasë stimulon përgjigjet e pyetjeve reflektuese. Kjo realizohet duke marrë pjesë në diskutimet javore në klasë, duke ofruar teknika, këndvështrime të ndryshme, opinione dhe rrugëzgjdhje alternative.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Nxënës/i-ja vlerësohet me notë ndërsa paraqet arritjet e tij/saj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara gjatë orëve të mësimin dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë

elektronike.

Mësues/i-ja vlerëson nxënës/in-en me notë për parashtrimet me shkrim, në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënës. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disa minutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënës, tek ato një orëshe; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni për prindërit mbi progresin e nxënësit është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi/ja rekomandon.

Model flete vlerësimi

Fletë vlerësimi

Nxënësi _____

Vlerësohet _____
(përshtatet me fjale vlerësimi për momentet e mëposhtme)

Diskutim _____

Argumentin _____

Punë në grup _____

Të tjera _____

Realizoi objektivin _____

Rezultati përfundimtar _____

